

PLANI ZHVILLIMOR
KOMUNAL
RAHOVEC 2018-2026
- DRAFT -

PERMBAJTJA

1	HYRJE	5
1.1	Lista e kontribuesve, stafi komunal, konsulentët	5
1.2	Prezantimi i përmbajtjes	5
1.2.1	Tabela e përmbajtjes	5
1.2.2	Lista e akronimeve dhe shkurtesave	5
1.2.3	Lista e tabelave	5
1.2.4	Lista e grafikëve	5
1.2.5	Lista e hartave	5
1.2.6	Lista e fotografive	5
1.2.7	Lista e referencave	5
1.3	Vendimet e Kuvendit të Komunës në lidhje me PZHK_në	5
1.3.1	Vendimi I Kuvendit të Komunës për hartimin e PZHK_së	5
1.3.2	Vendimi I Kuvendit të Komunës për miratimin dhe zbatimin e PZHK_së	5
2	PROFILI KOMUNAL	5
2.1	Historiku i zhvillimit	5
2.2	Organizimi Administrativ dhe qeverisja e Komunës së Rahovecit	6
3	VLERËSIMI I GJENDJES	9
3.1	Konstatimet gjeografike dhe mjedisore	9
3.2	Trendet dhe prognozat demografike	Error! Bookmark not defined.
3.3	Dendësia e popullsisë	18
3.4	Shtimi natyrorë i popullsisë	19
3.5	Strukturat e popullsisë	19
3.6	Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë	19
3.6.1	Struktura etnike e popullsisë	21
4	FUSHAT TEMATIKE	22
4.1	Ekonomike	22
4.1.1	Vlerësimi i ekonomive lokale dhe familjare	22
4.1.2	Punësimi dhe papunësia	23
4.1.3	Varfëria në Rahovec	25
4.1.4	Sektorët ekonomik dhe strukturat e tyre	27
4.1.5	Bizneset dhe ekonomitë bujqësore	27
4.1.6	Blegtoria dhe shpeztaria	32
4.1.7	Zhvillimi i industrisë dhe bizneseve	Error! Bookmark not defined.
4.1.8	Resurset minerale	34
4.2	Gjendja ekzistuese e resurseve dhe shërbimeve turistike	35
5	INFRASTRUKTURA TEKNIKE	37
5.1.1	Instalimet hidrologjike	37
5.1.2	Ndotja e ujit	39
5.1.3	Furnizimi me ujë	41
5.1.4	Sistemi i kanalizimit	45
5.1.5	Ujitja e sipërfaqeve bujqësore	48
5.1.6	Drenazhimi (kullimi)	52
5.2	Instalimet eketroteknike dhe telekomunikimit	52
5.2.1	Rrjeti elektroenergjetik	52
5.2.2	Permirësimi i energjise elektrike	55
5.2.3	Ndriçimi Publik	55
5.3	Telekomunikacioni	55
5.3.1	Telefonia Fikse	55
5.3.2	Telefonia mobile	56
5.3.3	Shërbimet Postare	56

5.3.4	Shërbimet e Internetit	56
5.3.5	Radiotelevizioni	58
5.3.6	Foltore publike	58
5.4	Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave	58
5.4.1	Operatori i menaxhimit të mbeturinave	59
5.4.2	Menaxhimi i Mbeturinave	60
5.4.3	Mbeturinat Ndërtimore/demolimet:	62
5.4.4	Mbeturinat nga Mbetjet Shtazore:	62
5.4.5	Strategjia dhe Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave	62
5.4.6	Planifikimi i Menaxhimit të Mbeturinave	63
5.4.7	Fazat e zbatimit të planit 2016-2021	64
5.4.8	Zonat e shërbimit	65
5.4.9	Zonimi i territorit	67
5.4.10	Zonimi i KK Rahovec i bazuar në kriteret për vlerësimin e zonës në sektorin e menaxhimit të mbetjeve	67
5.4.11	Shpërndarja e ekonomive familjare të bazuar në zonat e përcaktuara dhe kompanitë ofruese të shërbimeve të MM	69
6	INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI	72
6.1	Shtrirja dhe gjendja e rrugëve ekzistuese	72
6.1.1	Rrugë magjistrale M9.1	73
6.1.2	Rrugë regjionale	73
6.1.3	Rrugë urbane	74
6.1.4	Rrugë lokale	74
6.1.5	Rrugë të pa kategorizuara	74
6.2	Rrjeti hekurudhor	76
6.3	Urat	76
6.3.1	Urat në komunikacionin rrugor	76
6.3.2	Urat në komunikacionin hekurudhor	77
6.4	Tunelet	77
6.5	Siguria në Trafik	77
6.6	Shtrirja dhe kategoria e rrugëve të planifikuara nga niveli qendror	80
6.7	Vlerësimi i intensitetit dhe kapacitetit të kryqëzimeve dhe korsive kryesore	82
6.8	Modelet e qarkullimit të trafikut	83
6.8.1	Ri-orientimi i qarkullimit në qytet	83
6.9	Linja transportuese ndërkomunale brenda komunes , urbane dhe rurale	85
6.9.1	Transporti kolektiv (publiko - privat)	85
6.10	Shfrytëzimi i rrugëve nga makinat, këmbësorët, bicikletat dhe metodat tjera të transportit	86
6.10.1	Trafiku për këmbësorë	86
6.10.2	Trafiku për cikliste	86
6.10.3	Lëvizja e personave me nevojë të veçantë	86
6.11	Vlerësimi i hapësirave ekzistuese për parkim	87
6.12	Vlerësimin e nevojave në të ardhmen për një infrastrukturë transportuese	87
6.12.1	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal si nevojë në të ardhmen	87
6.13	Vlerësimi financiar dhe teknik të Komunës për të realizuar infrastrukturën e nevojshme të transportit	88
6.13.1	Struktura e Buxhetit Komunal	88
7	INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE	91
7.1	Gjendja ekzistuese e infrastruktures publike dhe sociale	91
7.2	Banesat Sociale Kolektive	Error! Bookmark not defined.
7.3	Qendra për të moshuar	Error! Bookmark not defined.
7.4	Shtëpia integruese	Error! Bookmark not defined.
7.5	Shtëpia Edukuese	Error! Bookmark not defined.
7.6	Inventari i ndërtimeve dhe hapësirave për veprimtari publike ekzistuese siç janë ato mjekësore, arsimore, të postës, të administratës publike dhe shërbimeve të tjera të ngjashme	97
7.6.1	Arsimi	97
7.7	Shëndetësia	100
8	MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI	102

8.1	Gjendja ekzistuese e mjedisit në komunë, duke evidentuar ndotjet, shtrirjen hapësinore të ndotjeve dhe degradimeve	102
8.1.1	Ndotja e ajrit.....	102
8.1.2	Ndotja e ujit.....	103
8.1.3	Ndotja e tokës ,katastrofat teknikoteknologjike	104
8.1.4	Përmbytjet.....	106
8.1.5	Variantet e mundshme të katastrofave nga vërshimet e mundshme	Error! Bookmark not defined.
8.1.6	Masat preventive nga vërshimet	109
8.1.7	Fatkeqësitë në penda hidroakumuluese	109
8.1.8	Erozioni dhe sedimentimi	110
8.1.9	Rrëshqitjet e tokës	110
8.1.10	Orteqet dhe shpatet e pjerrëta	111
8.1.11	Tërmetet.....	111
8.1.12	Sipërfaqe të rrezikuara nga zjarri.....	114
8.1.13	Vlerësimi i rrezikmërisë nga zjarret në objekte banimi dhe zjarre fushore.....	116
9	ASETET E TRASHËGËMISË NATYRORE, KULTURORE DHE TURISTIKE.....	119
9.1	Gjendja ekzistuese e pasurive natyrore, kulturore dhe turistike	119
9.1.1	Monumentet natyrore	121
9.1.2	Parqet kombëtare, sipërfaqet e mbrojtura dhe zonat e vecanta të mbrojtura brenda territorit të komunës	124
10	VENDBANIMET	125
10.1	Gjendja ekzistuese dhe shtrirja hapësinore e vendbanimeve.....	125
10.1.1	Shtrirja hapësinore e vendbanimeve sipas madhësisë	128
10.1.2	Karakteri urban/rural	129
10.2	Tipi i grumbulluar i vendbanimeve.....	130
10.2.1	Numri i banorëve	131
10.2.2	Funksionaliteti dhe rrjeti ndërlidhës.....	133
10.2.3	Vendbanimet me qendrën rurale	134
10.2.4	Lloji dhe lartësitë mbidetare	134
11	BANIMI	138
11.1	Gjendja ekzistuese e banimit dhe modelet e banimit	138
11.1.1	Numri i njësive të banimit.....	138
11.1.2	Analizë e kushteve të banimit, rekomandimet si dhe përmirësimin e kushteve banimit	138
12	VENDBANIMET JOFORMALE	139
12.1	Gjendja ekzistuese dhe shtrirja hapësinore e vendbanimeve joformale	139
13	SHFRYTËZIMI I TOKËS	142
13.1	Gjendja ekzistuese e shfrytëzimit të tokës	142
14	KARAKTERISTIKAT PEDOLOGJIKE DHE BONITETI	144
14.1	Karakteristikat pedologjike	144
14.2	Boniteti	149

1 HYRJE

1.1 Lista e kontribuesve, stafi komunal, konsulentët

1.2 Prezantimi i përmbajtjes

1.2.1 Tabela e përmbajtjes

1.2.2 Lista e akronimeve dhe shkurtesave

- MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
- DPSF – Departamenti i Politikave Sociale dhe i Familjes
- KOMUNA – Komuna e Rahovecit
- DSHMS – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- QPS – Qendra për Punë Sociale
- QSHM – Qendra e Shëndetit Mendor
- QKMF – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
- OJQ – Ofruesit jo qeveritar të licencuar të shërbimeve sociale.

1.2.3 Lista e tabelave

1.2.4 Lista e grafikëve

1.2.5 Lista e hartave

1.2.6 Lista e fotografive

1.2.7 Lista e referencave

1.3 Vendimet e Kuvendit të Komunës në lidhje me PZHK_në

1.3.1 Vendimi I Kuvendit të Komunës për hartimin e PZHK_së

1.3.2 Vendimi I Kuvendit të Komunës për miratimin dhe zbatimin e PZHK_së

2 PROFILI KOMUNAL

2.1 Historiku i zhvillimit

Pas përfundimit të Luftës në qershor të vitit 1999 Kosova ka hyr nën administrimin ndërkombëtar të Kombëve të Bashkuara. UNMIK-u shtriu ndikimin e vet edhe në qeverisjen lokale, ku sipas Nenit 3 të rregullores së vet Nr. 2000/45, komunave ju ndanë rolet dhe përgjegjësit, si dhe rolin në ofrimin e kushteve themelore bazike për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Procesi i decentralizimit në Kosovë qartësojë edhe kompetencat për vetëqeverisje lokale. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale Nr. 03/L-040 në Kreu III Kompetencat komunale, Neni 15 Parimi i subsidiaritetit – Komunitet ushtrojnë kompetencat e tyre sipas parimit të subsidiaritetit dhe, Neni 16 –Komuna ushtron kompetenca vetjake, të deleguara dhe të zgjeruara në përputhje me ligjin. Organet komunale janë: Kuvendi që është organi më i lartë në komunë dhe, Kryetari që kryen udhëheqjen komunale të ekzekutivit.



Skema 2. Struktura organizative e komunës së Rahovecit



2.2 Organizimi Administrativ dhe qeverisja e Komunës së Rahovecit

Komuna e Rahovecit ka një sipërfaqe prej 275.89 km², në të cilin territor shtrihen 34 fshatra me 2 vendbanime dhe me vetëm një qendër urbane.

Territori i komunës së Rahovecit ndahet në 34 zona kadastrale, dhe të gjitha vendbanimet(fshatrat) janë me nga një zonë kadastrale, me përjashtim të 3 zonave: Retije që në vete përfshinë dy vendbanime (Rejië dhe Retijë e ulët) ,zona kadastrale Çifllak që përfshinë edhe vendbanimin e Saroshit si dhe zona kadastrale Denjë që ne vete përfshin edhe vendbanimin e Babocit.

Tabela 1. Zonat kadastrale në komunën e Rahovecit

Nr.	Zona Kadastrale	nr.	Vendbanim	Nr	Zona Kadastrale	nr	Vendbanim
01	Bellacerkë	01	Bellacerkë	18	Nushpal	20	Nushpal
02	Bërnjak	02	Bërnjak	19	Opterushë	21	Opterushë
03	Bratotin	03	Bratotin	20	Pastaselë	22	Pastaselë
04	Brestovc	04	Brestovc	21	Pataçan i Epërm	23	Pataçan i Epërm
05	Celinë	05	Celinë	22	Pataçan i Ulët	24	Pataçan i Ulët
06	Çifllak	06	Çifllak	23	Petkoviç	25	Petkoviç
		07	Sarosh	24	Polluzhë	26	Polluzhë
07	Dabidol	08	Dabidol	25	Radostë	27	Radostë
08	Dejnë	09	Dejnë	26	Rahovec	28	Rahovec
		10	Baboc	27	Ratkoc	29	Ratkoc
09	Drenoc	11	Drenoc	28	Retijë	30	Retijë
10	Gexhë	12	Gexhë			31	Reti e Ulët
11	Hoçë e Madhe	13	Hoçë e Madhe	29	Sapniç	32	Sapniç
12	Hoçë e Vogël	14	Hoçë e Vogël	30	Senoc	33	Senoc
13	Kaznik	15	Kaznik	31	Vrajakë	34	Vrajakë
14	Kramovik	16	Kramovik	32	Xërxë	35	Xërxë
15	Krushë e Madhe	17	Krushë e Madhe	33	Zatriq	36	Zatriq
16	Mrasor	18	Mrasor	34	Zoçishtë	37	Zoçishtë
17	Nagavc	19	Nagavc				

Ndërsa për sa i përket organizimit administrativ të komunës së Rahovecit, ai është i organizuar në një qendër komunale si dhe me 7 qendra të tjera lokale.

01	Rahovec	Rahovec, Bërnjak
02	Çifllak	Çifllak, Dabidol, Mrasor, Kramovik, Petkoviq, Polluzhë, Sarosh
03	Ratkoc	Ratkoc, Radostë, Dejnë, Baboc, Vrajakë, Bratotin,
04	Drenoc	Drenoc, Zatriq, Kaznik, Pastaselë, Senoc, Nushpal, Pataçan i Epërm
05	Xërxë	Xërxë, Gexhë, Bellacerkë, Sapniq, Pataçan i Ulët
06	Krushë e Madhe	Krushë e Madhe, Celinë, Nagavc
07	Hoçë e Vogël	Hoçë e Vogël, Hoçë e Madhe, Brestovc
08	Opterushë	Opterushë, Zoçishtë, Retijë, Retijë e Ulët


3 VLERËSIMI I GJENDJES

3.1 Konstatimet gjeografike dhe mjedisore¹

Territori i komunës së Rahovecit zë një sipërfaqe prej 275.89 km², që shtrihet në regionin e Gjakovës dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Në Veri kufizohet me Komunën e Klinës me distancë rreth 45 km, në V-L me Komunën e Malishevës rreth 16 km, në J-L me komunën e Suharekës rreth 17 km dhe atë të Mamushës, në J me Komunën e Prizrenit 25 km, dhe në P me komunën e Gjakovës 28 km dhe në largësi nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina) rreth 60 km.

Ekziston lidhje të mira komunikative në mes komunave dhe në Lindje të komunës kalon magjistralja Prizren – Pejë dhe hekurudha Prizren –Pejë.

Territori i komunës shtrihet në hemisferën në mesë shkallës 42⁰ e 30' dhe 42⁰ e 50' të gjerësia gjeografike veriore dhe ndërmjet 20⁰ e 21' dhe 20⁰ e 55' të gjatësisë gjeografike lindore. Vendbanimet në komunën e Rahovecit shtrihen në lartësitë mbidetare prej 310 m Krusha e Madhe deri në 920 m. lartësi mbidetare Zatriqi



Harta 2_Pozita gjeografike e Komunës

¹ Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020

DRAFT

Për kah lartësia mbidetare këto vendbanime ndahen në luginore-rrafshorë, kodrinore dhe malore. Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lugina ose rrafshina janë këto: (310 – 350 m.)

Xërxa, Fortesa, Gexha, Malësia e Vogël, Ratkoci, Denji, Dabidoli, Çifllaku, Nagaci, Hoça e Vogël dhe Retia.

Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lartësitë mbidetare prej 350 – 600 m. që i takojnë kategorisë së vendbanimeve kodrinore janë: Rahoveci, Drenoci, Senovci, Pastaselli, Palluzhë, Kramoviku, Mrasori, Hoça e Madhe, Apterushë, Zaçishti, Patoçani i Ulët, Patoçani i Epërm, Nashpalla, Bratotini, Baboc, Vranjaka, Celina dhe Krusha e Madhe (edhe pse disa pjesë të reja të vendbanimeve të këtyre fshatrave u takojnë pjesës së kategorisë së luginave ose rrafshinave.)

Vendbanimet malore shtrihen në lartësitë mbidetare prej 600 – 1.000 m. e këto janë: Zatriqi, Kazniku dhe Drenoc.



PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL RAHOVEC (2017-2025)



Legjenda:

- Kufi i Komunes
- Kufi i Komunave fqinje
- Tunel
- Ura
- Rruga Magjistrale
- Rruga Rejionale
- Rruga Lokale
- Hekurudha
- Lumvegjet kryesore
- Drejtuesi i lumit
- Prirje
- Vendbanimet
- Isola

Topografia



GJENDJA EKZISTUESE


1 : 50 000

Topografia

03

Harta 4 _Topologjia e Komunës

3.2 Pronat shoqërore – komunale



Harta 5_Pronat shoqërore

Per sa i perket pronave shoqerore ne Komunen e Rahovecit të evidentuara si prona shoqerore komunale, si dhe prona shoqeror të menagjuara nga ekonomija pyjore rezulton ne nje numer jo te vogel te ketyre pronave.

3.3 Trendet dhe prognozat demografike²

Bazuar në regjistrimin e fundit të vitit 2011, Komuna e Rahovecit ka gjithsej 56.208 banorë. Shtrirja e popullatës në komunë është më shumë në zonë rurale sesa urbane, me 15.892 banorë në zonën urbane (28.7%) dhe 40.316 (71.3%) në zonat rurale.

Tabela 1: Numri i popullsisë dhe shkalla e rritjes

Viti	Total	Urbane	Rurale
2011	56,208	15,892	40,316
2012	56,854	16,075	40,780
2013	57,508	16,260	41,249
2014	58,170	16,447	41,723
2015	58,839	16,636	42,203
2016	59,515	16,827	42,688
2017	60,200	17,021	43,179
2018	60,892	17,216	43,676
2019	61,592	17,414	44,178
2020	62,300	17,615	44,686
2021	63,010	17,821	45,194

Burimi: ASK, 2011

Nga tabela mund të shihet trendi i rritjes së popullsisë ne Komunën e Rahovecit, ky trend nuk pritet të shenoj rritje të madhe në pesë vitet e ardhshme.

Në bazë të vlerësimeve të bëra, në Komunën e Rahovecit dominon mosha e re, dhe atë si në zonën urbane njashtu dhe atë rurale. Ndërsa grupmosha dominante e popullsisë janë kategoria 19-44 vjeçe.

Nëse bëhet nje analize me e thellë e strukturës së popullsisë në komunën e Rahovecit mund të vërehet se popullësia është e shtrirë po thuajse në mënyrë të barabartë në të gjitha zonat. Mund të shifet një numër më i madh i shtrirjes së banorëve (71.6%) në pjesën rurale të Komunës gjegjësisht në distancat nga 3-9 km. Shpjegimi rreth shtrirjes është dhënë edhe në tabelën e mëposhtme.

² Plan i pesë-vjeçar i miratimit të mbeturinave për komunën e Rahovecit 2016 – 2021

Tabela 2: Numri i popullsisë sipas grupeve:


Popullata	0-3 km	3-6 km	6-9 km	9-12 km	12-40 km	Total	Ne %
Urbane	15,892	-	-	-	-	15,892	28.3%
Para Urbane	-	4,205	-	-	-	4,205	7.5%
Rurale	-	-	7,023	14,647	-	21,670	38.6%
Rurale e Thell	-	-	-	-	14,441	14,441	25.7%
Total	15,892	4,205	7,023	14,647	14,441	56,208	100.0%

Nëse bëjme një krahasim të lëvizjes së numrit të popullsisë nëpër vite të regjistrimit kemi kë rezultate.

³Në vitin 1948 Rahoveci kishte 20287 banorë, ndërsa të dhënat e fundit tregojn se numri i banorëve në Komunë sillet rreth 56208 banorë, që do të thotë se për këtë periudhë kohore (62 vjeçare) numri i popullsisë është rritur për më shumë se tri herë.

Tabela 3. Numri i popullsisë

Vitet	Numri i popullsisë
Regjistrimi 1948	20350
Regjistrimi 1953	22687
Regjistrimi 1961	26839
Regjistrimi 1971	35215
Regjistrimi 1981	46459
Vlerësimi i 1991 (vlerësim i bërë nga Komuna)	59877
Regjistrimi i fundit 2011	56208



Grafiku 1. Numri i popullsisë së Komunës sipas regjistrimeve


Sipas të dhënave nga tabela dhe grafiku vërehet se deri në vitet e 60-ta komuna e Rahovecit ka shënuar rritje demografike, por shkallët e kësaj rritje kanë qenë më e vogla nga fakti se kishte shkallë të larta të natalitetit dhe mortalitetit ku si pasoj kishte shtim të ulët natyror.

³ Agjencia e Statistikave të Kosovës

Pas viteve të 60-ta gjegjësisht viteve të 70-ta kemi një rritje më të theksuar të popullsisë si pasojë e zvogëlimit të shkallëve të mortalitetit dhe në anën tjetër shkalla e natalitetit mbetet ende e lartë ku si pasojë kemi shkallë më të lartë të shtimit natyror.

Popullsia e komunës së Rahovecit jeton në gjithsej 37 vendbanime, prej tyre 36 janë fshatra dhe vetë qyteti i Rahovecit. Këto vendbanime kanë dallime të theksuara sa i përket numrit të popullsisë. Në qytetin e Rahovecit jetojnë rreth 15892 banorë që do të thotë se rreth 29 % e popullsisë së tërësishme jeton në këtë qytet, ndërsa në të gjitha vendbanimet tjera jetojnë rreth 40316 banor apo rreth 71 %.

Nr.	Vendbanimi	Nr. Banoreve	Nr.	Vendbanimi	Nr. Banoreve
1	Rahovec	15892	19	Nushpal	220
2	Bellacerkë	2270	20	Opterushë	1911
3	Bërnjak	40	21	Pastasellë	1011
4	Bratotin	396	22	Pataqan I Eperm	533
5	Brestovc	1288	23	Pataqan I poshtem	1077
6	Celinë	1903	24	Petkoviç	731
7	Çifllak	1292	25	Polluzhë	808
8	Dobidol	799	26	Radostë	2346
9	Dejnë + Baboc	1757	27	Ratkoc	3791
10	Drenoc	1587	28	Retijë e Ulet	234
11	Gexhë	660	29	Retijë	771
12	Hoqe e Madhe	124	30	Sapniç	996
13	Hoqe e Vogel	1166	31	Sarosh	6
14	Kaznik	164	32	Senoc	687
15	Kramovik	1125	33	Vrajakë	838
16	Krushe e Madhe	4473	34	Xërxë	3184
17	Mrasor	191	35	Zatriq	535
18	Nagavc	743	36	Zoqishtë	659
			TOTALI		56208



Grafiku 3. Numri i popullsisë sipas vendbanimeve

Pjesa më e madhe e vendbanimeve të komunës së Rahovecit kanë më tepër se 1000 banorë. Numër më të madh të popullsisë ka vet qyteti i Rahovecit (15892 b). Sa i përket vendbanimeve rurale, numër më të madh të banorëve kanë vendbanimet: Krushë e Madhe (4473 b), Ratkoc (3791 b), Xërxë (3184 b), Radost (2346 b), Bellacerka (2270 b), Opterush (1911 b). Ndërsa vendbanimet që kanë numër më të vogël të popullsisë janë: Bërnjak (40 b), Kaznik (164 b), Mrasor (191 b), Nashpall (220 b).

3.4 Dendësia e popullsisë

Dendësia e popullsisë në komunën e Rahovecit është rreth 204 banorë në 1 km², ku rreth 56208 banorë jetojnë në 275.9 km².

Brenda territorit të komunës së Rahovecit ekzistojnë dallime për sa i përket dendësisë së popullsisë.⁴ Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë dhe e kundërta në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël.

Kjo është në raport edhe me hapësirën e vendbanimit, ku disa vendbanime që kanë hapësirë më të vogël (zona kadastrale e vendbanimit është e vogël), dendësia e popullsisë është më e madhe.

Nr.	Zona	Nr. Ban.	Siper. ne km ²	Banor ne 1 km ²	Nr.	Zona	Nr. Ban.	Siper. ne km ²	Banor ne 1 km ²
1	Rahovec	15892	48.49	328	19	Nushpal	220	0.64	344
2	Bellacerkë	2270	10.96	207	20	Opterushë	1911	9.01	212
3	Bërnjak	40	4.51	9	21	Pastasellë	1011	5.40	187
4	Bratotin	396	3.11	127	22	Pataqan I Eperm	533	2.33	229
5	Brestovc	1288	5.80	222	23	Pataqan I poshtem	1077	5.53	195
6	Celinë	1903	5.72	333	24	Petkoviq	731	10.02	73
7	Çifllak	1292	4.76	271	25	Polluzhë	808	5.66	143
8	Dobídol	799	3.46	231	26	Radostë	2346	10.33	227
9	Dejnë + Baboc	1757	6.43	273	27	Ratkoc	3791	11.82	321
10	Drenoc	1587	8.19	194	28	Retijë e Ulet	234	0	0
11	Gexhë	660	3.23	204	29	Retijë	771	9.84	78
12	Hoqe e Madhe	124	13.52	9	30	Sapniq	996	4.95	201
13	Hoqe e Vogel	1166	7.05	165	31	Sarosh	6	4.95	1
14	Kaznik	164	8.34	19	32	Senoc	687	4.36	158
15	Kramovik	1125	10.31	109	33	Vrajakë	838	4.94	170
16	Krushe e Madhe	4473	10.00	447	34	Xërxë	3184	10.09	316
17	Mrasor	191	3.17	60	35	Zatriq	535	15.15	35
18	Nagavc	743	3.09	240	36	Zoqishtë	659	5.21	127

Dendësia më e lartë e popullsisë paraqitet në vendbanimin Krush e Madhe me 447 banor në km², kjo për shkak se ky vendbanim ka një sipërfaqe prej 10 km².

Vendbanimet tjera me dendësi po aq të madhe janë Nushpal ku mesatarisht jetojnë rreth 344 banorë në një km², Rahoveci me 328 b/km², Celina me 333 b/km² etj.

Vendbanimet me shkallë më të vogël të dendësisë së popullsisë janë: Sarosh (1 b/km²), Hoqa e Madhe (9 b/km²), Bërnjak (9 b/km²).


⁴ Numri i banoreve per cdo vendbanim marr nga PLMM 2016-2021

3.5 Shtimi natyrorë i popullsisë⁵

Veçori themelore e popullsisë së Komunës së Rahovecit është se shtimi natyror në tërë periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore ishte faktor primar i rritjes së përgjithshme të numrit të popullsisë. Në periudhën e pasluftës, krahas shkallës së lartë të natalitetit, edhe mortaliteti ishte mjaft i lartë për shkak të mortalitetit të lartë infantil, si rezultat i nivelit të ulët të zhvillimit social e mjekësor.

Gjatë periudhës 1971 – 1981, krahas rënies së natalitetit, bie dukshëm edhe mortaliteti e me këtë zvogëlohet edhe shtimi natyror i popullsisë.

Gjatë vitit 2009 në komunën e Rahovecit janë shënuar 1255 lindje 2 dhe 205 vdekje 3 . Bazuar në këto të dhëna është llogaritur shkalla e natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror në promilë dhe në përqindje për komunën e Rahovecit.



Grafiku 4. Shtimi natyror i popullsisë

Siç shihet edhe nga grafiku, shkalla e natalitetit në komunën e Rahovecit është 17.5 promil apo 1.75 %. Shkalla e mortalitetit është 2.3 promil apo 0.29 %. Në bazë të këtyre shkalleve të natalitetit dhe mortalitetit del se shtimi natyror i popullsisë në komunë është 14.6 promilë apo 1.46 %.

3.6 Strukturat e popullsisë

Struktura e popullsisë është e lidhur ngushtë me lëvizjen natyrore dhe mekanike të popullsisë. Kjo strukturë mund të shqyrtohet nga aspekti biologjik, ekonomik, social, nacional, fetar etj.

3.7 Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë⁶


Komuna e Rahovecit në aspektin e zhvillimit demografik ka veçorit e sajë edhe në përbërjen e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë. Në këto struktura kanë ndikuar shumë faktor demografik dhe socio-ekonomik dhe janë krijuar shumë karakteristika dhe efekte të tjera sasiore dhe cilësore në zhvillimin demografik. Komuna e Rahovecit ka popullsi kryesisht të re dhe me bazë

⁵ Programi komunal tre vjeçar për banim 2014-2016

⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

të zgjeruar të piramidës sipas moshës, edhe pse periudhat e fundit kohore vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grup-moshave të reja.


Deri në vitet e 90-ta në komunën e Rahovecit ka dominuar plotësisht tipi progresiv i popullsisë, ku shkalla e lartë e natalitetit dhe rëniet e vazhdueshme të mortalitetit kanë ndikuar drejtpërdrejtë në krijimin e këtij tipi të popullsisë. Ndryshimi i rrethanave socio-ekonomike dhe politike pas viteve të 90-ta kanë ndikuar në zhvillimin e përgjithshëm demografik të komunës, njëherit edhe me ndryshime në strukturën e popullsisë sipas moshës. Pothuaj gjatë gjithë pjesës së dytë të shekullit të kaluar, piramida e popullsisë së komunës së Rahovecit kishte bazë të zgjeruar me dominimin e grup-moshave 0 deri 4 vjeç. Gjatë analizës së të dhënave demografike, vërehen ndryshime në strukturën e popullsisë. Këto ndryshime mund ti dallojmë më çart përmes piramidës së popullsisë.



Grafiku 5. Piramida e popullsisë për komunën e Rahovecit

Të dhënat për grup-moshën janë marr nga vlerësimi i komunës për vitin 2003 dhe gjithashtu janë analizuar edhe numri i lindjeve në periudhën e fundit ku vërehet një rënie e tyre në krahasim me vitet e më parshme. Forma e piramidës ndryshon duke u ngushtuar baza e sajë dhe kjo si pasojë dy faktorëve: migrimeve dhe të tendencave të zvogëlimit të natalitetit. Nga piramida e popullsisë vërehet se grup-moshat e reja 0 deri 4 vjeç kanë pjesëmarrje më të vogël në popullsinë e përgjithshme në krahasim me grup-moshën 5 deri 9 vjeç dhe 10 deri 14 vjeç.


Në përgjithësi grup-moshat e reja të popullsisë (0 deri 19 vjeç) dominojnë dukshëm në popullatën e përgjithshme të komunës, dhe kjo është një indikator mjaft i rëndësishëm që tregon se në të ardhmen do të ketë natalitet të lartë, nga fakti se këto grup-mosha në të ardhmen japin një përqindje të konsiderueshme të popullsisë fertile që konsiderohet si burim i lindshmërisë.



Grafiku 6. Tri grup-moshat e popullsisë në komunës e Rahovecit

Mbi 40 % të popullsisë së përgjithshme në Komunë janë me moshë të re 0 deri 19 vjeç, ndërsa grup-moshat mbi 65 vjeç kanë pjesëmarrje më të vogël me 8.8 % të popullsisë së përgjithshme.

Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Rahovecit ka karakteristikat e veta me dominim jo të madh të gjinisë mashkullore. Koeficienti i maskulinitetit është rreth 1051, që do të thotë se mesatarisht ekzistojë 1051 meshkuj në çdo 1000 femra.




Grafiku 7. Përqindja e popullsisë sipas gjinisë në komunën e Rahovecit

Siç shihet edhe nga grafiku, ekziston një deballans i vogël gjinor në popullsinë e komunës së Rahovecit, ku popullsia mashkullore dominon me 51% në krahasim me popullsinë femërore që ka 49 % të popullsisë së gjithmbarshme.

3.7.1 Struktura etnike e popullsisë⁷

Në aspektin etnik komuna e Rahovecit ka një ka një popullsi mjaft homogjene ku mbi 95 % e popullsisë janë shqiptar

⁷ Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020



Grafiku 8. Pjesëmarrja e etniteteve në komunë

Sipas vlerësimit të vitit 2003, që është realizuar nga Komuna e Rahovecit, popullsia shqiptare dominon me 96.68 % ndërsa etnitetet tjera kanë pjesëmarrje shumë të vogël, Serbet me 2.72 % dhe Romët me 0.5 %

4 FUSHAT TEMATIKE

4.1 Ekonomike⁸

Fillimi i shekullit XX e gjen Kosovën me mbeturina të bollshme në shumë segmente të jetës familjare dhe prodhuese.

Gjendje të njëjtë kishte edhe komuna e Rahovecit, dhe kjo gjendje nuk ndryshoi as pas Luftës së Dytë botërore, sa që kjo periudhë krahasohej me gjendjen e fillimit të shekullit.

Një zhvillim inicial fillon pas viteve të 60-ta, por deri në përfundim të shekullit XX zhvillimi ekonomik dhe shoqëror në komunën e Rahovecit sikurse edhe në tërë Kosovën karakterizohej me tri probleme të mëdha: struktura jo e volitshme e ekonomisë, aftësia e dobët akumuluese dhe papunësia.

Në vitet e 80-ta dhe të 90-ta komuna e Rahovecit sikurse edhe tërë Kosova u shëndrrua në koloni dhe zonë të okupimit klasik serb.

Krahas këtyre rrethanave të zhvillimit ekonomik, edhe struktura ekonomike në komunën e Rahovecit ka karakteristikat e veta.

4.1.1 Vlerësimi i ekonomive lokale dhe familjare⁹

Një ndër karakteristikat e veçanta të zhvillimit demografik dhe shoqëror të Kosovës janë edhe numri, madhësia mesatare dhe përbërja e ekonomive familjare, të cilat janë të kushtëzuara nga ndikimi i faktorëve ekonomikë, social, demografik etj.

Siç dihet, ekzistojnë dallime sipas komunave në Kosovë sa i përket madhësisë së familjes. Komuna e Rahovecit kryesisht karakterizohet me numër të madh të anëtareve të familjes, që është karakteristike për vise të pa zhvilluara dhe kryesisht rurale.

⁸ Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020

⁹ Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020

Në bazë të të dhënave dhe vlerësimeve për numrin e popullsisë dhe ekonomive familjare në komunën e Rahovecit, del se mesatarja e madhësisë së familjes është 7.7 anëtar.

Ekonomi familjare me 1 - 3 anëtar ka mjaft pak dhe kjo është një dëshmi se, me gjithë transformimet socio-ekonomike dhe të tjera, proceset e modernizimit të shoqërisë në komunën e Rahovecit nuk kanë qenë të fuqishme për të kushtëzuar ndryshime rrënjësore në përbërjen e ekonomive familjare përmes shthurjes së ekonomive të zgjeruara tradicionale familjare në të ashtuquajtura familje nukleare, siç ka ndodhur në vendet e tjera të zhvilluara.

4.1.2 Punësimi dhe papunësia

Papunësia është një ndër problemet me të cilën më së shumti po përballet shoqëria kosovare. Shkalla e papunësisë në Kosovë është më e larta në rajon. Kjo shkallë e lartë e papunësisë është 44.4%. Vlerësohet se 1/3 e popullsisë së Kosovës është nën moshën 16 vjeç, ndërkaq rreth 60% e popullsisë janë në moshë pune. Kjo shkallë e lartë e papunësisë prek më së shumti femrat (58.06%), pavarësisht nga shkalla shumë e lartë e jo aktivitetit për ato. Edhe pse, nuk ka të dhëna të sakta për shkallën e papunësisë, hulumtimet e ndryshme vlerësojnë se papunësia është e lartë.¹⁰

¹¹Ne komunën e Rahovecit veprojnë 1000 biznese private, dhe veprimtaria e tyre është prodhuese, industriale, shërbyese dhe tregtare. Problemi i nivelit të lartë të papunësisë në nivel të Kosovës, reflektohet edhe në Komunën e Rahovecit. Të punësuar në subjektet ekonomike janë 3.501 apo në 1.000 banorë të afte për punë rreth 110 të punësuar në ekonomi.

Nr.	Vendbanimi	Nr i biz tregtare	Nr i të punësuarve	Private	Shoqërore
1	Bellacërkë	38	67	38	
2	Bërnjak	2	280	2	
3	Bratotin	2	1	1	
4	Brestovc	4	4	4	
5	Celinë	9	9	9	
6	Çiflak	16	25	16	
7	Dabidol	3	3	3	
8	Dejnë	15	26	15	
9	Drenoc	12	11	12	
10	Gexhë	9	23	9	
11	Hoçë e madhe	-	-	-	5 punëtorë PTK
12	Hoçë e vogël	10	9	10	
13	Kaznik	-	-	-	
14	Kramovik	20	29	20	
15	Krushë e Madhe	86	150	86	5 punëtorë PTK
16	Mrasor	-	-	-	
17	Nagavc	5	5	5	
18	Nushpal	1	1	1	
19	Opterushë	11	9	11	
20	Pastaselë	2	4	2	
21	Pataçan i epërm	1	1	1	

¹⁰ Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020

¹¹ Programi komunal tre vjeçar për banim 2014-2016

22	Pataçan i ulët	4	4	4	
23	Petkoviq	3	2	3	
24	Polluzhë	6	7	6	
25	Radostë	6	8	6	
26	Rahovec	699	1398	699	70 punëtorë "Ambienti,"
27	Ratkoc	69	114	69	
28	Reti e ulët	-	-		
29	Retijë	4	4	4	
30	Sapniq	4	4	4	
31	Sarosh	-	-	-	
32	Senoc	7	13	7	
33	Vrajkë	2	2	2	
34	Xërxë	121	275	121	
35	Zatriq	1	1	1	
36	Zoçishtë	4	5	4	

Në tabelat e mëposhtme janë të paraqitura numri i bizneseve tregtare dhe numri i të punësuarve në komunën e Rahovecit përpos vetë qytetit .

Nd. industriale/ Nr i të punësuarve	Nd. Ushqimore/ Nr i të punësuarve	Nd. Ndërtimore/ Nr i të punësuarve	Drurit/ Nr i të punësuarve	Industri e metaleve dhe kimike/ Nr i të punësuarve	Degët tjera të industrisë
	1/7				
	2/20				
12/351		2/17	1/4	2/22	6
4/140	1/70	30/100	10		

¹²Numri I bizneseve të regjistruara për periudhën viti 2000 – Prillë 2018, të shprehur në numer si dhe në vendabnime paraqitet kjo gjendje:

Nr.	Pershkrimi	Shprehur në numër
01	Biznese të regjistruara : 2000 –Prill 2018	3215
02	Biznese Aktive	2966
03	Biznese Pasive	249
04	Biznese të shuara për : 2000 – 29.05.2018	384
05	Numri I punëtorëve, për Biznese Aktive:	5618
06	Numri I punëtorëve, për Biznese Pasive:	365
07	Numri I punëtorëve për bizneshe të shuara:	679

Nr.	Emri ibiznesit	Vendi	Nr.	Emri ibiznesit	Vendi
01	"Kzone" shpk	Xërxë	24	Hajrush Isma BI	Rahovec
02	"Beni-H" shpk	Kramovik	25	"Haxhimustafarchitecture" shpk	Rahovec
03	"Harley Hous" shpk	Xërxë	26	Albine Nurshaba BI	Rahovec

¹² QKB Rahovec

04	Afrim T. Gashi BI	Dobidol	27	Sabahate Mazreku BI	Retij
05	Valon Korenica BI	Rahovec	28	Kapllan Morina BI	Senoc
06	Briton Morina BI	Bellacërkë	29	Nasip Popaj BI	Bellacërkë
07	Merita GJ. Hoti BI	Ratkoc	30	Lirie Berisha BI	Denjë
08	Esma Bytyqi BI	Rahovec	31	Bekim Beqiraj	Guri Kuq
09	Luan Durguti BI	Rahovec	32	Mahmut Shala BI	Zoqishtë
10	“Globi Consulting” shpk	Ratkoc	33	Hysen Bytyqi BI	Denjë
11	Veton Jupa BI	Rahovec	34	Ruzhdi Morina BI	Senoc
12	Buad Mazreku BI	Rahovec	35	Besnik Bytyqi BI	Denjë
13	Gjelil Durguti BI	Rahovec	36	“Ermiri” shpk	Rahovec
14	“A.I.S Consulting” shpk	Rahovec	37	Bujar Morina BI	Rahovec
15	Ntsh” Xoni Petrol”	Ratkoc	38	Hajdar Hoti BI	Rahovec
16	Elisa Sokoli BI	Rahovec	39	“Morina Ėorld Travel” shpk	Rahovec
17	Arjete Haxhialiu BI	Rahovec	40	Ntp “Cali”	Rahovec
18	Emira Pista BI	Rahovec	41	Ntp “Landi”	Rahovec
19	Dafina Hasku BI	Rahovec	42	“Cenbaza Group” shpk	Rahovec
20	Bekim Salihi BI	Rahovec	43	Nuredin Ramsha BI	Rahovec
21	Muhamed Shabandula BI	Rahovec	44	“Dali Dekor” shpk	Rahovec
22	“Pria Home” shpk	Bërnjakë	45	“Stone Castle Resort” shpk	Bërnjakë
23	Sahare Gashi BI	Xërxë	46	Ntsh “Euron”	Opterushë
			47.	Dpt “Çlirimi”	Xërxë

4.1.3 Varfëria në Rahovec¹³

E shkaktuar nga një mori faktorësh, varfëria është e përhapur gjerësisht në Kosovë. Hulumtimet e ndryshme kanë treguar se mbi gjysma e popullsisë (50.3%) jetojnë në varfëri të përgjithshme, ndërsa rreth 13% e popullsisë jeton në varfëri ekstreme.

Largimet e dhunshme nga puna të popullsisë shqiptare nga pushtuesi serb, në fillim të viteve të '90-ta, shkallë e ulët e arsimimit, zhvillim i pa balancuar ekonomik, shkatërrimet e shtëpive, bizneseve dhe ndërmarrjeve nga lufta e fundit në Kosovë ('99), etj. ndikuan drejtpërsëdrejti në shkallën e lartë të varfërisë. Varfëria ka prekur të gjitha komunat e Kosovës ku më pak e ku më shumë është e theksuar.

Sipas hulumtimeve të bëra nga organizata të ndryshme përkatësisht UNDP-së, shkalla e përgjithshme e varfërisë në komunën e Rahovecit është 73.54 %. kemi këtë paraqitje të varfërisë;

¹³ Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020




Grafiku 11. Shkalla e varfërisë në Rahovec

Sipas hulumtimit të lartpërmendur 12.35% e popullsisë së kësaj komune jetojnë me një dollar në ditë për person, 69.57% e popullatës jeton me dy dollar në ditë për person, në varfëri ekstreme jetojnë 10.86% e popullsisë dhe me varfëri të përgjithshme jetojnë 72.20% e popullsisë.

Ndërsa, pas grumbullimit të dhënave nga Qendra për Punë Sociale për numrin e popullsisë me asistencë sociale, familjeve dhe kryefamiljarëve nëna me asistencë sociale dhe analizave të bëra na paraqitet shkallë e lartë e varfërisë ekstreme. Këto të dhëna, na ndihmojnë sadopak në paraqitjen e gjendjes ekzistuese të popullsisë për secilin vendbanim të komunës. Sipas të dhënave del se në komunën e Rahovecit ekzistojnë 2581 persona apo 590 familje që jetojnë me asistencë sociale, që nënkupton se kjo pjesë e popullsisë jeton në varfëri ekstreme. Ndërkaq, varfëria e përgjithshme përfshinë një përqindje më të madhe të popullsisë.

Me shkallë më të lartë të varfërisë është e prekur gjinia mashkullore me 75%, kurse me asistencë sociale 25% janë kryefamiljarë nëna. Kjo shkallë e lartë e varfërisë është e shtrirë gjerësisht në tërë territorin. Për më tepër shih grafikun;



Grafiku 12. Popullsia me asistencë sociale

Vendbanimet që kanë përqindje më të vogël të popullsisë me asistencë sociale janë:

Bellacërka, Nashpalli, Radosti, Sapniqi, Zoqishta, Palluzha, Krusha e Madhe, Kramoviku, Brestovci dhe Bratotini. Ndërsa vendbanimet me përqindje më të madhe të popullsisë me asistencë sociale janë: Kazniku, Senoci, Zatriqi, Petkoviçi dhe Dabidoli.

Në shkallën e lartë të varfërisë kanë ndikuar një mori faktorësh: dëbimi i popullsisë shqiptare nga vendet e punës nga pushtuesi serb nga fillimi deri në fund të viteve të '90-ta,

shkatërrimet e luftës, shkalla e lartë e papunësisë, niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, të ardhurat e vogla për kokë banori, arsimimi i pamjaftueshëm etj. Të gjitha këto kanë bërë që ky problem të jetë kaq madhor. Njerëzit në kategoritë e mëposhtme ka të ngjarë të jetojnë në varfëri: të papunët, ata në punë me orar të reduktuar ose punë të pasigurta, të moshuarit, të sëmurët, të paafët, si dhe anëtarët e familjeve të mëdha ose të familjeve me një prind, pensionistet, familjet me kryefamiljare nëna, etj. Papunësia e lartë e viteve të fundit pas '99 nuk duket se mund të bjerë në të ardhmen e afërt, ndërsa papunësia e tej zgjatur po i shtyn gjithnjë e më shumë familjet drejt varfërisë.

4.1.4 Sektorët ekonomik dhe strukturat e tyre

Duke marrë parasysh kushtet e favorshme topografike , klimatike dhe agro-ekologjike puna në bujqësi, vreshtari dhe verari përbën aktivitetin themelor ekonomik në Rahovec në të gjitha aspektet duke përfshirë prodhimin, burimin e të ardhurave dhe punësimin.

4.1.5 Bizneset dhe ekonomitë bujqësore

Spektori i industrisë në Komunën e Rahovecit, bazohet kryesisht në industrinë agro-industriale, përpunimin e rrushit dhe të grurit, industrinë e plastikës, ndërtimtarisë, teknologjinë përpunuese të metaleve, teknologji për ngrohje dhe ftohje, artizanate ,tregëti, shërbime etj. Pas luftës, ndërmarrjet e vogla kanë shfaqur tendencën për shfrytëzimin dhe përpunimin e gurit, rërës, zhavorit dhe argjilës, evidente me një shkatërim joselektiv të resurseve.

Duke e pasur parasysh nivelin e përgatitjes profesionale dhe shpirtin ndërmarrës, shumë individë kanë filluar me biznese individuale dhe familjare duke trasuar rrugën për një të ardhme dhe duke u bazur në ekonominë e tregut, si e vetmja perspektivë zhvillimore.

Rritja e bizneseve kërkon dhe qasje të re, si nga ana e themeluesve të tyre, sistemi bankar, institucionet të cilat duhet të merren më seriozisht lidhur me qasjen e përkrahjes, sidomos me infrastrukturë si dhe me legjislacion, i cili do të jetë i favorshëm për investuesit potencial. Ruajtja e shpirtit ndërmarrës duhet të stimulohet dhe konsiderohet si vlerë për ekonominë kosovare. Për zhvillimin e ardhshëm, duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë ruajtjes dhe zgjerimit të këtij lloji të aktiviteteve ekonomike, të cilët kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, si dhe në kualitetin e jetës urbane.

Në sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ekziston një asistencë e konsiderueshme e organizatave vendore dhe ndërkombëtare, të cilat janë përkushtuar për stabilizim dhe profesionalizim të ekonomisë.

Organizatave ofrojnë asistencë për të zhvilluar prodhime të reja, si dhe tregun për to. Përkrahja gjithashtu vjen edhe nga institucionet gjegjëse të nivelit institucional me qëllim të krijimit të një mjedisi favorizues për zhvillimin ekonomik. Kjo i referohet, sikur është përmendur më parë, arsimimit profesional, çertifikimit të standardeve profesionale, standardeve për kualitet në menaxhim, prodhimtarisë, prodhimeve, etj. Të gjitha këto aktivitete kontribuojnë në stabilizimin e NVM-ve si bazë e rëndësishme e ekonomisë së Kosovës, gjegjësisht qytetit të Prishtinës, duke sjellur sa më shumë prodhime kosovare në treg dhe duke ofruar mundësi të reja punësimi.

Bujqësia si degë e ekonomisë, është bartëse e zhvillimit ekonomik në komunën tonë dhe si e tillë duhet ti kushtohet vëmendje e posaqme si nga udhëheqësia komunale ashtu edhe ato shtetërore. Pjesa më e madhe e banorëve në komunën tonë merren me kultivimin, grumbullimin dhe përpunimin e perimeve si dhe kultivimin e kulturave lavëtarë dhe vreshtarisë.

Prioritetet që duhet me i dhënë bujqësisë

- Mbrojtja dhe prodhimi i bimëve,
- Transformimi i fermave të vogla familiare në ato të mëdha komerciale,
- Shfrytëzimi i praktikave të reja bujqësore dhe aplikimi i tyre,
- Përmirësimi i produktivitetit dhe rritjes së rendimentit përmes përdorimit të hibrideve dhe varieteteve me potencial të lartë biologjik,
- Fillimi i programeve afatgjate në ndërtimin e kapaciteteve,
- Ofrimi i mbështetjes institucionale,
- Ofrimi i shërbimeve këshillimore dhe përkrahjes teknike.

Sipas shënimeve të Entit Statistikorë Komuna jonë disponon me 13.600 hektar tokë bujqësore, Sipërfaqet e tokës bujqësore e cila gjendet përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë në lartësi mbidetare prej 310 – 350 m, është tokë aluviale me pjellori të lartë në të cilat kultivohen kulturat bujqësore intensive, si që janë perime kultura (speci, domate, patate, tranguj, shalqini, karrota e tjera) dhe kulturat lavëtarë (gruri, misri). Në tokat kodrinore në lartësi mbidetare prej 350 – 600 m. gjendet toka e tipit Smonice ku kultivohen kulturat lavëtarë pranverore dhe vjeshtore, kulturat shumëvjeqare, ku bëjnë pjesë edhe kullosat. Por duke patsë parasysh ndërtimin e objekteve të ndryshme në tokat bujqësore si që janë: objektet e banimit, objektet hoteliere, pompat e benzinës dhe objektet e ndrydhmë industriale si dhe eksploatimin e zhavorrit në tokat bujqësore ka ndikuar që sipërfaqet e tokës bujqësore të zvogëlohen gradualisht, duke u shëndruar në toke ndertimore, prandaj planifikimin e mbjelljeve vjeshtore dhe ato pranverore nuk mund ti planifikojmë në mënyrë të saktë.

Falë kushteve klimatike ku mbretëron klimë kontinentale me ndikim mesëdhetar, me verë të nxehtë dhe dimër të ashpër janë të favorshme për kultivohen kulturat vjeshtore dhe pranverore.

Si muaji më i nxehtë është Korriku me temperaturë deri në 38,5 Co dhe më i ftofti është muaji Shkurt me temperaturë -18 Co.

Mesatarja vjetore e temperaturës në bazë të dhënave shumë vjeqare të stacionit lokal meteorologjik është 11,8 Co.

Të rreshurat atmosferike vjetore janë 653 mm që kanë një shpërndarje jo të favorshme.

- Shuma e temperaturës vjetore është4.304 Co,
- Shuma e temperaturës vegjetative është.....3.520 Co,
- Temperatura mesatare ditore gjatë vitit.....11.77 Co,
- Temperatura mesatare ditore gjatë vegjetacionit.....15 Co,
- Shuma e të reshurave gjatë vitit.....653 mm,
- Shuma e të reshurave gjatë vegjetacionit.....504 mm,
- Mesatarja mujore e të reshurave gjatë vitit.....54 mm,
- Mesatarja mujore e të reshurave gjatë vegjetacionit.....72 mm.

Me kulturat lavëtarë vjeshtore mbillen rreth 2.400 hektar, ku kryesisht mbillet kultura e grurit.

Në bazë të të dhënave rendimenti mesatar i grurit është 3,5 t/ha. Kjo paraqet 30-35 % të potencialit gjenetik (prodhues) të varietetit. Për rritjen e rendimentit për sipërfaqe duhet përdorur farën e kualitetit të lartë, mbjelljen e mekanizuar dhe mbjellja të kryhet në afatin optimal agroteknik, përdorimi i plehrave minerale adekuate dhe në sasi e duhura, mbrojtjen nga sëmundjet, dëmtuesit dhe barojave të këqia.

Komuna jonë posedon 42 autokombajna të cilët janë në sektorin privat dhe rregullisht marrin pjesë në fushatën e korrje shirjeve. Këto autokombajna janë të vjetëruar dhe ka mundësi se krijojnë humbje gjatë korrjeve.

Me kulturat pranverore mbillen:

- Misër - 2.100 hektar
- Perime - 3.000 hektar

Gjithësej me kulturat pranverore mbillen rreth 5.100 hektar.

Për prodhimin e kulturës së misrit vlejnë parimet e njëjta sikurse te prodhimtaria e grurit.

Prodhimtaria e kulturave perimore kërkon një teknologji të avancuar bashkëkohore dhe zbatimi i masave adekuate dhe të nevojshme agroteknike. Për inkurajimin e prodhuesve të perimeve duhet të bëhet subvencionimi i prodhuesve me inpute dhe mekanizim, të hapen kapacitetet për grumbullimin dhe përpunimin e perimeve, organizimin e këshillimeve profesionale, trajnimin e ekspertëve bujqësor dhe vizitat në vendet me perimtare të zhvilluar.

Në komunën tonë ekziston sistemi i ujitjes me të cilin menaxhon Kompania Regjionale e Ujitjes (KRU), „Radoniqi”, me seli në Gjakovë. Në komunën tonë me këtë sistem ujiten 2.658,63 hektar tokë të punueshme bujqësore, ku kryesishtë kultivohen kulturat lavëtarë (misër, grurë) dhe perimet (speci, domate, tranguj, lakra, patate, shalqini e tjera), ndërsa sipërfaqet më të vogla me perime ujiten nga përrockat dhe pusët.

Me bimë foragjere në komunën tonë janë të mbjellë rreth 200 hektar. Mbjellja dhe prodhimi i bimëve foragjere ndikon direkt në përmirësimin e bazës ushqyese për kafshë. Prandaj duhet të rriten sipërfaqet me bimë foragjere, këto pos që shërbejnë si ushqim i kafshëve e përmirësojnë strukturën e tokës bujqësore dhe e rrisin plleshmërin e tokës duke rritur sasinë e azotit në tokë.

Në komunën tonë veprojnë edhe 3 mullinjë për grumbullimin dhe përpunimin e grurit, si që janë Sillosi në Xërxë, Mulliri në Rahovec dhe mulliri në Qifllak.

Pos këtyre në komunën tonë ekzistojnë edhe 2 qendra për grumbullimin dhe përpunimin e perimeve: - Në Krushë të Madhe, në Xërxë

Fermerët e komunës tonë janë të furnizuar mirë me mekanizëm bujqësor, por mekanizimi është i vjetëruar dhe ka nevojë për rivitalizimin e tij.

Fermerët tanë për shkak të kushteve të cilat mbretërojnë në bujqësi nuk i përdorin sasi të parashikuara të plehut mineral për plehërimin e kulturave bujqësore si dhe trajtimin e bimëve me pesticidet për eliminimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve, për këtë ekziston nevoja për kryerjen e analizave të tokës bujqësore ku kultivohen kulturat lavëtarë dhe perimet. Pas marrjes së rezultateve të analizës do të caktoheshin plehtrat adekuat dhe sasia optimale për plehërimin e kulturave bujqësore.

Për rritjen e rendimentit, përmirësimin e kualitetit të produkteve bujqësore dhe rritjen e mirëqenies së fermerëve tanë duhet që të i kushtohet rëndësi shumë e madhe sektorit të bujqësisë, duke bërë investime të nevojshme.

4.1.5.1 Prodhimi i perimeve

Në komunën e Rahovecit kultivohen perimet si: karrota, hudhra, patëllgjani, spinaqi, pjepri, etj, përderisa si kultura; misri, fasulja dhe kungulli ku arrihen rezultate të larta sidomos në sipërfaqen e cila është nën sistemin e ujitjes.

Në regionin e komunës së Rahovecit, gjithashtu kultivohen jongja, dhe soja, të cilat kanë një rëndësi të veçantë për blegtori, ngase paraqesin ushqim të pazëvendësueshëm për to.

Sipërfaqja me këto kultura është diku rreth 800 Ha.

4.1.5.2 Prodhimi i drithërave:

Prodhimi i drithërave është gjithashtu aktivitet i rëndësishëm në komunën e Rahovecit, veçanërisht e kombinuar me fabrikën për prodhimin e miellit.

Po të krahasojmë vitin 2001 me fundin e vitit 2003 vëmë re se sipërfaqja e përgjithëshme e mbjellë me kultura lavërtare është pakësuar me 1963 hektarë, nga të cilat 1179 ha i përkasin kulturës së grurit, kjo për arsye se prodhimi i kësaj kulture nuk është i leverdishmëm për fermerët privatë. Sasia e grurit prodhuar në vitin 2003 ka qënë 7673.8 ton; kostoja e prodhimit për një ton ka qënë rreth 1118 Euro/ton, çmimi në treg rreth 1046 Euro/ton si dhe; të ardhurat potenciale nga shitja kanë qënë rreth 163,257 Euro në vit. Sipërfaqet me drithër/grurë në 5 vitet e fundit janë rreth 2200 ha për çdo vit, ndërsa për miser poashtu sillen rreth 1800-2000 ha.

Fabrika e miellit dhe makaronave në Rahovec "SILLOSI-i" e blen gjithë prodhimin e grurit të fermerëve të Rahovecit dhe komunave përreth. Kjo fabrikë ka një kapacitet të madh prodhimi dhe detyrohet që 70% të grurit të importojë nga jashtë (para luftës ka importuar nga Vojvodina). Importet e drithërave janë dyfishuar nga 75,000 ton në vitin 2005 në 160,000 ton në 2006., përderisa çmimi i grurit është rritur vazhdimisht gjatë vitit 2006 për shkak të rënies së prodhimit në Amerikën Veriore, rënies në rezervat botërore dhe kërkesave të shtuara për drithëra për prodhimin e bio-karburanteve. Çmimi i grurit është rritur nga çmimet prej 12 në 15 cent për kg në 21 cent në mars 2007, dhe çmimet e misrit kanë kërcyer nga 14 cent për kg në 18 cent.

4.1.5.3 Prodhimi i rrushit dhe verës¹⁴

Sipërfaqja e përgjithshme e vreshtave në komunën e Rahovecit është 2168 Ha, me trend të rritjes së këtyre sipërfaqeve, përderisa 630 ha është sipërfaqe e vreshtave në prodhim dhe 370 Ha, jashtë prodhimit. .

Edhe pse industria e verërave përbën vetëm një pjesë të vogël të sektorit bujqësor të Kosovës, ajo gëzon potencial të madh për qasje në tregjet evropiane, në të cilat kërkesa për verëra të importuara është e madhe.

Para vitit 1999, prodhimtaria vjetore ka qënë deri në 12.5 milionë €, me kapacitet të përpunimit prej 30,000 - 40,000 tonave të rrushit dhe 10 milionë litrave verë në vit. Para vitit 1990, 80% e prodhimeve të fabrikës janë eksportuar në tregjet e Evropës, SHBA dhe Kanadë. Në vitin 2001 është arritur një marrëveshje me kompani private gjermane për eksportin e 200,000 litrave të verës për 5 vitet e ardhshme, duke filluar nga viti 2002.

¹⁴ Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020

Në vitin 2004 janë prodhuar 2.4 milion kg rrush të kuq dhe të bardhë për verë sikurse dhe të tryezës; 1.1 milion litra verë të bardhë dhe të kuqe (Cabernet Sauvignon, Merlot, Pinot Noire, Game, Kosovo Red, Chardonnay, Italian Riesling, Rhine Riesling, Semignon); pije alkoolike si rraki rrushi dhe Brandy¹⁰.



Fig. 4. Pamje nga vreshtat dhe spërkatja e tyre

Ndërmarrësit rahovecjanë të verës dhe rrushit ballafaqohen me konkurrencë poashtu nga prodhuesit tjerë regionalë të verës, nga Bullgaria, Hungaria, Greqia dhe shtetet e reja të dala nga ish Jugosllavia. Konkurentë poashtu janë dhe ndërmarrësit nga komuna e Suharekës dhe Prizrenit.

4.1.5.4 Kapacitetet për prodhim të verës¹⁵

Kapacitetet për prodhimin e verës janë 50 M litër/vjet; për ruajtjen e verës 500,000 hectolitër/vjet, përderisa prodhimi i verës në vitin 2003 ishte 4.8 million litër, 1.1 million litër në vitin 2004. Prodhimi i rrushit në vitin 2003 ishte 7.3 million kg ndërsa në 2004 ishte 2.4 million kg. Vreshtat të pronësi të furnizuesve privatë janë 2,500 Ha.



Fig.5. Llojet e verërave të Rahovecit

Kapaciteti për prodhim të verës së bardhë “Brnjaka-I” është e ndërtuar më 1975, me bodrum të kapacitetit 18M litër, 2 njësi për grumbullim të rrushit, 16 njësi për fermentim, pjesën për distilim, për zbrazje në shishe, linjën e paketimit dhe laboratorin.

¹⁵ Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020

“Brnjaka-II” e ndartuar më 1982 për verë të kuqe është e kapacitetit të bodrumit 18M litër, përfshirë dhe 5 M litër për deponim në fuqi të drurit, 4 njësi për mbledhjen e grumbullimin e rrushit, 48 njësi për fermentim, 25 vagonë/njësi.

Tregu i shitjes - është ai lokal në Kosovë përfshirë supermarketet dhe restorantet për verë të ambalazhuar dhe atij rufuz, rrush të tryezës dhe alkool. Tregu i jashtëm përfshin fillimisht verën në fuqi/rufuz në tregun gjerman përmes distributorit Amselfelder.

Historikisht tregu përfshinte Kosovën Gjermaninë, Serbinë dhe Malin e Zi, Bullgarinë dhe Hungarinë.

Konkurenca – Si pjesë e konkurrencës nga prodhuesit ndërkombëtar, poashtu dhe prej prodhuesve regionalë në Bullgari, Hungari, Greqi dhe shtete nga ish Jugosllavia.

Konkurentë lokalë përfshirë ndërmarrjet e verës dhe të rrushit janë ata nga Suhareka dhe Prizreni sikurse dhe prodhuesit e vegjël.

4.1.6 Blegtoria dhe shpeztaria¹⁶

Industria e blegtorisë konsiderohet lëmi tjetër kyçe e bujqësisë në Rahovec.

Ka karakter ekstensiv, pasi që kultivohet në numër të vogël nga fermerët. Rriten tri lloje të gjedheve, ku raca më e shpeshtë quhet Bushë e cila është më pak produktive në qumësht se të tjerat.

Prej blegtorisë kultivohen: gjedhet, delet, dhitë, kuajt, buallicat, etj. Kohëve të fundit ka tendencë të kalimit të kësaj dege të bujqësisë në blegtori intensive, me përmirësimin e racës së gjedhit, me racë simentale, montafone etj. Për mbarëvajtjen e blegtorisë në komunën e Rahovecit kujdeset stacioni i veterinarisë në Rahovec që nga viti 1960.

Nga të dhënat më të reja nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të KK Rahovec, kemi: Gjedhe të imta 7084; Gjedhe të trasha 8892 dhe shpezë 38700 sosh.

Shpeztaria është poashtu e karakterit ekstensiv dhe përveq pulës e cila kultivohet në numër më të madh, llojet tjera të shpezëve janë më pak, përderisa disa prej tyre mund të hasen në natyrë në formë të egër. Sipas kërkimeve tona jo të plota, mesatarja e pulave për familje sillet rreth 10 pula për çdo familje. Viteve të fundit ka filluar kultivimi intensiv i shpeztarise, ku janë ndërtuar disa mini-ferma të pulave, si në fshatrat Celinë, Krushë të madhe, Apterushë, Qifllak etj.

4.1.7 Sektori i Pylltarisë

Që të jetë PZHK-Rahovec e kompletuar atëherë ne si sektor i pylltarisë konsiderojmë që duhet të përfshihen edhe pyjet së bashku me tokat pyjore në territorin e komunës tone, sepse janë tri aspekte me prioritet:

- a) aspekti ekonomik
- b) aspekti social
- c) aspekti mjedisor.

PZHK duhet ta përshkruaj në mënyrë të detajuar Njësinë Menaxhuese „Koznik- Zatriq-Rahovec, Shkozë”, (vërejtje një njësi menaxhuese jo dy siq janë në draft) me sip 7.692.52ha pyje dhe tokë pyjore (jo 9866.77 ha) sepse mbi 1300ha kanë kaluar ne territorin e njësisë menaxhuese „Pyjet e Malishevës’ pasi shtrihen në territorin e kësaj komune

¹⁶ Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020

Në pjesën qendrore të NJM në Zatriq gjendet pika me e larte me lartësi mbi nivelin e detit 1013m vendi i quajtur „Gradishte” ndërsa vendi më i ulët po në NJM tek lumi „Drini i Bardhë” me lartësi mbidetare 359m.

Sipërfaqja e tërësishme pyjore e tanishme është: 7,692

Tokë Pyjore	Sip. Ha
Pyllëzime Artificiale	37.10
Pyll cungishte	4.560.90
Shkurre dhe sip jo prodhuese	3.094.00
Gjithsej	7692.00

4.1.8 Llojet e drurit (Trungjet-kategorizimi i tyre)

Shpërndarja e llojeve të drurit është e dominuar nga lloje të qarrit, bungut dhe shkozës. Llojet dominuese është lloji i shkoza me pjesëmarrje prej 44% të vëllimit të përgjithshëm, qarri 39% , bungu 10%, llojet e gjethoreve 4%, pisha e zezë 3%, e vëllimit të përgjithshëm. Duke marrë në konsideratë kushtet natyrore dhe përbërjen pedologjike të tokës këto pyje ofrojnë kushte relativisht të mira për pyjet e dushqeve.

4.1.9 Zhvillimi i industrisë dhe bizneseve¹⁷

Sektori i industrisë në Komunën e Rahovecit, bazohet kryesisht në industrinë agro-industriale, përpunimin e rrushit dhe të grurit, industrinë e plastikës, ndërtimtarisë, teknologjinë përpunuese të metaleve, teknologji për ngrohje dhe ftohje, artizanate ,tregëti, shërbime etj. Pas luftës, ndërmarrjet e vogla kanë shfaqur tendencën për shfrytëzimin dhe përpunimin e gurit, rërës, zhavorit dhe argjilës, evidente me një shkatërim joselektiv të resurseve. Duke e pasur parasysh nivelin e përgatitjes profesionale dhe shpirtin ndërmarrës, shumë individë kanë filluar me biznese individuale dhe familjare duke trasuar rrugën për një të ardhme dhe duke u bazur në ekonominë e tregut, si e vetmja perspektivë zhvillimore. Rritja e bizneseve kërkon dhe qasje të re, si nga ana e themeluesve të tyre, sistemi bankar, institucionet të cilat duhet të merren më seriozisht lidhur me qasjen e përkrahjes, sidomos me infrastrukturë si dhe me legjislacion, i cili do të jetë i favorshëm për investuesit potencial. Ruajtja e shpirtit ndërmarrës duhet të stimulohet dhe konsiderohet si vlerë për ekonominë kosovare. Për zhvillimin e ardhshëm, duhet të kushtohet kujdes i veçantë ruajtjes dhe zgjerimit të këtij lloji të aktiviteteve ekonomike, të cilët kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, si dhe në kualitetin e jetës urbane.

Në sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ekziston një asistencë e konsiderueshme e organizatave vendore dhe ndërkombëtare, të cilat janë përkushtuar për stabilizim dhe profesionalizim të ekonomisë. Organizatat ofrojnë asistencë për të zhvilluar prodhime të reja, si dhe tregun për to. Përkrahja gjithashtu vjen edhe nga institucionet gjegjëse të nivelit

¹⁷ Programi komunal tre vjeçar për banim 2014-2016

institucional me qëllim të krijimit të një mjedisi favorizues për zhvillimin ekonomik. Kjo i referohet, sikur është përmendur më parë, arsimimit profesional, çertifikimit të standardeve profesionale, standardeve për kualitet në menaxhim, prodhimtarisë, prodhimeve, etj.

Të gjitha këto aktivitete kontribuojnë në stabilizimin e NVM-ve si bazë e rëndësishme e ekonomisë së Kosovës, gjegjësisht qytetit të Prishtinës, duke sjellur sa më shumë prodhime kosovare në treg dhe duke ofruar mundësi të reja punësimi.

Gjendja ekonomike e bujqve është mjaft e rëndë. Përpos tregut të redukuar 15 , kemi të bëjmë me një import të pakontrolluar dhe joselektiv të produkteve bujqësore gjë që i bjen prodhuesit tanë të pemëve dhe perimeve në pozitë mjaft të rëndë.

4.1.10 Resurset minerale

Në territorin e Komunës së Rahovecit ka rezerva të gurit dekorativ dhe minerale si krom, azbest, nikel, kobalt, bakër dhe qymyr guri (thengjilli).

Gurët dekorativë: - gjenden në afërsi të fshatit Drenovc, në një largësi prej 5,5 km nga qyteti i Rahovecit. Rezervat mendohet të jenë rreth 207.386 m³. Shtresat e lezolitit dekorativ janë sipërfaqësorë, të mbuluar me shtresë humusi prej 0,5 m.

Gurët gëlqerorë: - gjenden në Hudhrat e Danit, një vend në veri-perëndim të qytetit të Rahovecit 8 km larg tij. Ato shtrihen në formë blloqesh me trashësi që varion nga 0,3 në 2 metra, dhe janë 1,5 metra poshtë sipërfaqes së tokës. Gurët gëlqerorë paraqiten në ato të kuq dhe murrëm. Gëlqerorët e kuq paraqesin më shumë interes ekonomik. Rezerva e gurëve gëlqerorë mendohet të ketë një volum prej 382.913 m³.

Azbesti: -Shtresat e lezolitit të azbestit janë të përqëndruara në afërsi të fshatit Rudin/Pastasel në perëndim të Rahovecit, në një largësi prej 8 km. Në bazë të hulumtimeve (janë bërë 4 shpuarje) është përcaktuar sipërfaqja e shtresës prej 100.000 m² dhe mendohet që rezerva të kapë shifrën prej 10.000.000 Ton. Kjo e dhënë është e përafërt dhe kërkon hulumtime të hollësishme gjeologjike.

Kobalti, Nikeli dhe Bakri: -Në rrethinën e Gurit të Kuq janë konstatuar shtresa e xeheroreve të Nikeli-Kobaltit. Përberja mesatare e këtij xeherori sipas hulumtimeve të bëra vite më parë për mineralin në formë të ngurtë është (Nikeli 0,18 %, Kobalti 0,13 % dhe Bakri 2,73 %). Sasia e rezervave të këtij xeherori nuk dihet.

Kromi - mendohet të gjendet përgjatë luginës së Drinit të Bardhë në një sipërfaqe rreth 60 km² dhe përkatësisht në lokalitetet Qëndresë, Gradisht, lugina e prroit Rimnik, Delja, Shipi në Zadriq, Sharnica mbi Qëndresë, Drenovci, Guri i kuq, Kanzniku, etj.

Thëngjilli- gjendet në lokalitetet e Hoçës së Madhe, Krushës, prroit të Nagacit, Drinasi, etj. Për të përcaktuar sasine e rezervave dhe cilësitë kalorifike të thëngjillit duhen bërë hulumtime të thella gjeologjike.

Së fundi, sipas Komunës ekziston mundësia që të gjenden shtresa naftëmbajtëse në territorin e Komunës së Rahovecit. Vëndodhja e tyre mendohet të jetë në fshatin Kramovik dhe përgjatë rrjetjes së Drinit të Bardhë deri në Krushën e Madhe.

4.2 Gjendja ekzistuese e resurseve dhe shërbimeve turistike¹⁸

Turizmi është më pak i zhvilluar, edhe pse Rahoveci është njëri ndër qytetet më të vjetra të Kosovës, me relikte të vendbanimeve të dikurshme antike, të cilat rrjedhin nga epoka e hershme romako-ilire



Figura 8. Shtëpi tradicionale, fillimi shek 19-të



Figura 9. Shën Xhoni, shek 14-të

Në përgjithësi zona e Dukagjinit është përplot me trashëgimi arkitekturore, shpirtërore, fetar, etnologjike etj. Poashtu resurse për një turizëm rekreativ ekzistojnë në kanjonin e Drinit të Bardhë. Turizmi kulturor kryesisht mund të jetë i bazuar në trashëgimi kulturore/arkitekturore: shtëpitë tradicionale, turizëm kulturor arkeologjik, shpella, hamame, trashëgimi arkitekturore dhe fetare në Hoçën e Madhe , e cila tashmë është edhe e mbrojtur me pakon e Ahtisarit nga e cila derivon dhe Ligji për Mbrojtjen e Zonave të Veçanta të Mbrojtura dhe në hartim e sipër përderisa flasim është Ligji për Hoçën e Madhe.

Në qendër të qytetit janë të vendosura monumentet historike të ndërtuara mbi 400 vite:

Teqja e Madhe –Helvetive, Teqja Rufai; Teqja Melami; Sahat Kulla e ngritur në vitin 1791; pesë xhamitë si dhe teqet tjera si në qytet ashtu edhe në rrethinë.

Në fshatin Hoça e Madhe, në jug të qytetit të Rahovecit, të njohur për vreshtat dhe verërat e saj, objektet e trashëgimisë kulturore dhe fetare. Në vitin 1198 Duka i madh Stevan Nemanja dhuroi prodhimet e regjionit, manastirit të Hilandarit (Mt. Athos)., përderisa kjo zonë në mesjetë u bë qendër e madhe komerciale dhe kulturore. Në të janë 12 kishat; Shën Nikolla, Shën Xhoni, Shën Stefan – shekulli i 14-të, Kisha e Dielës së Shenjtë, Shën Parasku, Shën Ana, Shën Lluka dhe Shën Pjetri – shekulli i 16-të, Shën Virgjina dhe Shën Elia. Ekskluzive për nga rraliteti, janë dhe depotë e mëdha të verës 21 , në qendër të fshatit me fuqitë e larta deri në 5 metra dhe 4 m të gjera.

¹⁸ Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020



Figura 10. Shën Lluka shek. 16-të



Figura 11. Shën Nikolla shek 14-të



Figura 12. Kanjoni atraktiv në Drinin e bardhë



Figura 13. Ura e Fshejtë




Figura 14. Trashëgimi arkitekturore në Hoçën e Madhe



Figura 15. Trashëgimi arkitekturore në qytetin e Rahovecit

Poashtu duhet për të cekur se te Ura e Fshejtë është zonë turistike me kanjonin atraktiv Eupegjenik të lumit Drini i Bardhë. Në afërsi të kanjonit janë të ngritura 5 kamp-shtëpiza si dhe restorani.

5 INFRASTRUKTURA TEKNIKE


5.1.1 Instalimet hidrologjike

Komuna e Rahovecit është e pasur me burime natyrore dhe ka rrjet hidrografik relativisht të dendur. Kjo paraqet pasurinë natyrore të komunës dhe një ndër kushtet për ekzistencën e botës bimore dhe aktiviteteve njerëzore. Rrjetin hidrografik të komunës së Rahovecit e përbëjnë disa qindra burime, puset, burime rrjedhëse dhe të qëndrueshme, si dhe prrojet. Burimet – janë format të rëndësishme hidrografike. Në territorin e komunës së Rahovecit ka disa qindra burime periodike dhe të përhershme. Numri i madh i burimeve janë ato burime që burojnë në luginat e prockave – prrojeve dhe rrëzë kodrinave. Më së shumti ka burime në luginën e Rimnikut, lumit të Hoçës, Zoqishtës, Apterushës, Vrellën në qytetin e Rahovecit, etj. Rëndësi të madhe ekonomike kanë burimet të cilat shtrihen në shpatet e luginave dhe shtratit të lumit, pastaj burimet të cilat paraqiten në kodrat terciare të neogjenit. Hulumtimet tregojnë se më së shumti ka burime karstike periodike dhe të përhershme. Burimet e këtilla gjenden në jug- perëndim, veri dhe veri-perëndim, në rrëzë të malit Shkozës, Zatriq dhe Kaznik.

Shtirja e vendbanimeve është kryesisht përgjatë ujrrjedhave si dhe burimeve ujore si: Rahoveci, Hoça e Madhe, Zaçishti, Apterusha, Zatriqi, Drenoci, Senoci, Pastasella, Kramaviku e tjerë.

Tabela 16. Vendburimet

Emërtimi	Lartësia mbidetare	Lit./sek.	Temp.
Burimi i Rahovecit	390	5 – 8	13
Burimi i Zatriqit	920	5	13
Burimi i Apterushës	400	20	13
Burimi i Zaçishtit	415	15	13
Burimi i H.Madhe	420	10	14
Burimi i Sopotit	380	6	13



Harta 6 _Trupat sipërfaqësor ujor

Lumi Drini i Bardhë, edhe pse nuk buron ne komunën e Rahovecit, të gjitha përroskat dhe

lumenjtë derdhen në të. Nëpër komunën e Rahovecit, ky lum rrjedhë me një gjatësi prej 30 km dhe në pjesën më të madhe është edhe si kufi administrativ i komunave si: Prizrenit, Gjakovës, Malishevës dhe Klinës.

Lumenjtë-përroskat të cilat derdhen në Drinin e Bardhë janë: lumi Ratkoc, Rimnik, Palluzhë, Hoçë etj.

Për shkak të konfiguracionit të terrenit lugina e Drinit në komunën e Rahovecit është e gjerë rreth 2 deri 5 km. Ndërsa gjerësia mesatare e shtratit të lumit prej 50 deri 100 m, thellësia e shtratit të lumit është 1 deri 5 m.

Hapësira nëpër të cilën kalon lumi është emruar Lumi Drini i Bardhë ka prerë masivin gëlqeror Gradishin, duke formuar Grykën (Kanonin) epigjenike atraktive në gjatësi prej 450 m. Në kanjon është ndërtuar Ura e Fshenjtë e cila është e gjatë 70 metra dhe lartësia prej harkut deri te shtrati i ujit është 30 m.

Lumi i Hoçës buron në fshatin Hoçë të Madhe, në lartësi mbidetare 420 m, dhe rrjedh nëpër fshatin Brestoc, por para fshatit Brestoc bashkohet me degën e Babindolit dhe disa burime, ndërsa dhe derdhet në Drinin e Bardhë.

Lumi Bellaja është dega e majtë e Drinit të Bardhë, me gjatësi 3 km, prej fshatit Fortesë deri te fshati Rogovë. Lumi Duhllo buron në Rahovec dhe është i formuar nga tri burime (Duhllo, Vrellë dhe Sopot) dhe bashkohet me lumin e Rimnikut. Në harta topografike ky lum është i shënuar me emrin Gjegoja që do të thotë për popullin e kësaj ane është i pa njohur.

Lumi Rimnik buron në rrëzë të malit Gërgavicë dhe në rrjedhjen e saj i merr disa burime të tjera. Ky lum ka rëndësi të madhe ekonomike për këtë anë. Lumi Rimnik gjatë rrjedhjes së vetë bashkohet me rrjedhën Duhllo dhe në fshatin Fortesë bashkohet me lumin e Sopniqit duke formuar kështu lumin Bellaja. Lumi Sopniq burimin e ka në rrëzë të malit të Drenocit dhe kalon nëpër fshatin Nushpall, Sopniq. Ky lum gjatë stinës së verës thahe dhe mund të quhet si lumi i Thatë. Duhet cekur se janë edhe disa lumenj- procka si: Ratkocit, Kramovikut, Palluzhës e tjera.

Prrocka që buron në fshatin Opterushë shkarkohet në lumin Toplluha.

5.1.2 Ndotja e ujit

Ndotja e ujërave sipërfaqësore në lumenjtë e Kosovës, sikurse edhe në Komunën e Rahovecit, është si pasojë e shkarkimit të ujërave të zeza dhe atyre industriale të pa trajtuara paraprakisht si dhe hedhja e mbeturinave të amvisërisë në ambientet ujore. Këto dukuri negative janë të shprehura sidomos në viset e ulëta fushore aty edh ku ka shtrirje aktiviteti njerëzor.

Shkarkimi i ujërave të zeza të qytetit Rahovec në lumin Duhllo



Shkarkimi i ujërave të zeza të fshatit Nushpall në prrenjë **foto te reja te vendosen**

Në shkallën e parë që, nuk ka ndotje kimike dhe biologjike, janë lumenjtë që shtrihen nga burimet deri në vendbanime.

Shkallës IIa të ndotjes i takojnë të gjithë lumenjtë dhe prroskat e komunës së Rahovecit dhe shkallës IIb i takon Drini i Bardhë.

Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak rritë shkallën e ndotjes së lumit. Mesatarisht çdo banor shkarkon $16.46 \text{ m}^3/\text{vit}$ ujëra të zeza.

Në bazë të statistikave demografike numri i banorëve në Komunë është 56208 banorë, atëherë $56208 \times 16.46 = 925183 \text{ m}^3/\text{vit}$ ujëra të zeza ose 49 litër/sek pa llogaritur objektet industriale.

Vendbanimet nuk kanë të rregulluar kanalizimin, përveç 9 prej tyre, por fatkeqësisht edhe ato vendbanime pa trajtim paraprak ujërat e zeza i shkarkojnë në mjedise të pastra.

Lumenjtë janë pjesa më e atakuar nga ndotja ngase dominon logjika se lumi me masën e vet ujore bartë dhe largon gjithçka.

Përveç ndotjes kimike të ujërave, ku ndotësit hynë si përbërës i ujit, është ndotja fizike nga mbeturinat që nuk treten dhe përhapen në shtratin e lumit, e disa transportohen. Mbeturinat e ngurta që janë organike, ndikojnë në ndotjen biologjike, që pas dekompozimit të tyre krijohen kushte të përshtatshme për jetesën e mikroorganizmave të ndryshëm, si dhe parazitëve që janë të dëmshëm për jetën e njeriut, florën dhe faunën që shtrihet përgjatë shtratin të lumit. Të gjitha këto lloje të ndotjeve i zvogëlojnë kushtet për botën e gjallë natyrore të ujërave.

Shkarkimi i mbeturinave të ngurta është dukuri tjetër negative e lumenjve të Kosovës, por edhe të vendbanimeve të komunës. Kjo dukuri është e shprehur sidomos në ato vendbanime ku nuk është e organizuar mbledhja e mbeturinave.

5.1.3 Furnizimi me ujë

Duke u bazuar në nevojat elementare të jetës së njeriut dhe ekzistencës së tij është sigurimi i ujit të pastër për pije dhe për nevojat tjera në sasi të mjaftueshme.

Bazuar në rëndësinë e infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit, për kualitetin e jetës, mirëqenien e popullatës dhe për zhvillimin ekonomik dhe social të komunës, rrjedhimisht planet zhvillimore dhe urbanistike duhet të harmonizohen me planet e investimeve kapitale për rehabilitimin dhe zgjerimin infrastrukturës në territorin administrativ të komunës. Padyshim që edhe Komuna e Rahovecit ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kësaj infrastrukture. Kjo para së gjithash nënkupton interesin dhe përgjegjësinë e Komunës për ofrimin e shërbimeve cilësore për pjesën e përfshirë të popullatës me këto shërbime, po ashtu dhe për zgjerimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve për përfshirjen e zonave aktualisht të pambuluara me këto shërbime. Qytetarët e komunës së Rahovecit furnizohen me ujë të pijshëm në tri forma:

- Sistemi qendror i furnizimit-ujësjellësi i KRU Gjakova
- Sistemet e vogla -ujësjellësit lokal (sistem të pompimit)
- Puset individuale

Furnizimi i banorëve të komunës së Rahovecit me ujë të pijshëm, momentalisht përcillet me probleme të mëdha. Me probleme përcillen edhe fshatrat që kanë sistemin e ujësjellësit e sidomos gjatë periudhës së nxehtë kur në shumë raste uji pijës keqpërdoret edhe për ujitjen e tokave.

Mënyra e furnizimit me ujë në komunën e Rahovecit				
Nr	Venbanimi	Nr.banoreve	Sistemi	Menaxhimi
1	Rahovec	15892	Publik	KRU Gjakova
2	Bellacerkë	2270	Publik	KRU Gjakova
3	Bërnjak	40	Publik	KRU Gjakova
4	Bratotin	396	Publik	KRU Gjakova
5	Brestovc	1288	Publik	KRU Gjakova
6	Celinë	1903	Publik	KRU Gjakova
7	Çifllak	1292	Publik	KRU Gjakova
8	Dobidol	799	Publik	KRU Gjakova
9	Dejnë	1757	Publik	KRU Gjakova
10	Drenoc	1587	Pompim-Pusi	KRU Gjakova
11	Gexhë	660	Publik	KRU Gjakova
12	Hoqe e Madhe	124	Publik	KRU Gjakova
13	Hoqe e Vogel	1166	Publik	KRU Gjakova
14	Kaznik	164	Individual	
15	Kramovik	1125	Publik	KRU Gjakova
16	Krushe e Madhe	4473	Publik	KRU Gjakova
17	Mrasor	191	Individual	KRU Gjakova
18	Nagavc	743	Publik	KRU Gjakova
19	Nushpal	220	Publik	KRU Gjakova


20	Opterushë	1911	Natyror	Nga burimi i fshatit sistem të pompimit autonom
21	Pastasellë	1011	Publik	KRU Gjakova
22	Pataqan I Eperm	533	Publik	KRU Gjakova
23	Pataqan I poshtem	1077	Publik	KRU Gjakova
24	Petkoviq/Guri I kuq	731	Publik	KRU Gjakova
25	Polluzhë	808	Publik	KRU Gjakova
26	Radostë	2346	Publik	KRU Gjakova
27	Ratkoc	3791	Publik	KRU Gjakova
28	Retijë e Ulet	234	Publik	KRU Gjakova
29	Retijë	771	Publik	KRU Gjakova
30	Sapniq	996	Publik	KRU Gjakova
31	Sarosh	6	Publik	KRU Gjakova
32	Senoc	687	Natyror-Pusi	KRU Gjakova
33	Vrajakë	838	Publik	KRU Gjakova
34	Xërxë	3184	Publik	KRU Gjakova
35	Zatriq	535	Burime vetanak	Nga burimi I fshatit me kaptazh dhe sistem pompash
36	Zoqishtë	659	Burime vetanak	Nga burimi i fshatit sistem të pompimit autonom
Totali		56208		
1	Me ujësjellës	45528	81 %	
2	Pa ujësjellës	8993	16 %	
3	Sistem të pompimit	1687	3 %	
Totali				

Komuna e Rahovecit nuk ka rrjetë shumë të zhvilluar të furnizimit me ujë të pijes, i cili ka shtrirje në 29 vendbanime kanë ujësjelles kolektiv.

Nga tabela mund të shihet se 81 % e popullatës së Rahovecit kanë qasje në sistemin e ujësjellësit kolektiv, derisa vetëm 19% e popullatës nuk kanë qasje në këto sisteme.

Aktualisht sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit (të ujërave të zeza dhe ujërave të shiut) në Komunën e Rahovecit menaxhohet nga KRU Gjakova .

Furnizimi i komunës së Rahovecit me ujësjellës bëhet nga KRU Gjakova .



Sistemi i ujësjellësit të Radoniqit e furnizon me ujë qytetin e Rahovecit dhe vendbanimet Ratkoc, Radostë, Gexhë, Xerxë, Bellacerkë, Bërnjakë, Krushë e Madhe, Celinë, Brestovc, Hoqë e Vogël, Hoqë e Madhe, Dejnë, Nushpalë, Sopniq, Potočan e Epërm, Potočan i Poshtëm, Reti e Ulët, Vrajak dhe Nagavc dhe tash se fundi fshatrat Dabidol, Çifllak, Kramovik, Polluzhe dhe Pastaselë. Në këtë sistem kanë qasje 56208 banorë ose 87 % të popullatës të përgjithshme në komunë.

Nga ky sistem, në bazë të sasive të ujit, që momentalisht janë në dispozicion, konsumimi mesatar ditor për banor vlerësohet të jetë përafërsisht 200-250 litra në ditë. Krahasuar me nivelet e BE-së, konsumimi i ujit për kokë banori është i mirë. Përkundër këtij kapaciteti të madh të ujit nga KRU Gjakova, gjatë muajve të verës shfaqen probleme në furnizim me ujë sidomos në pikat kritike të sistemit (zonat e larta dhe pikat e largëta). Arsyet kryesore për probleme të tilla konsistojnë me faktin se humbjet e ujit në sistemin distributiv janë në një shkallë mjaftë të lartë-rreth 57%. Problem në veti paraqesin edhe keqpërdorimi i ujit të pijes, të cilin e shfrytëzojnë për ujitje, Faktorët tjerë që ndikojnë në këtë shkallë të lartë vlerësohet të jenë: kyçje ilegale, mosmatja e saktë e ujit etj. Këto humbje paraqesin ndryshimin ndërmjet sasisë së prodhuar dhe sasisë së faturuar të ujit. Inkasimi për vitin 2010 vlerësohet të jetë 65-70%. Trajtimi i ujit të pijes bëhet me sistemin e dezinfektimit/klorizimit. Aktualisht klorizimi bëhet me klor të gazët. Cilësia e ujit për pije nga ujësjellësi i Rahovecit kontrollohet nga IRSHP-Prizren. Frekuenca dhe numri i pikave të testimit përcaktohet në përputhshmëri me standardet e parapara me IA 2/99. Shpërndarja e ujit bëhet përmes rrjedhjes së lirë me gravitacion.


Furnizimi në vendbanimet tjera rurale - Pjesa e tjetër e popullatës, e cila nuk është e kyçur në ujësjellësin e KRU Gjakova, furnizohen me ujë nga puseët e cektë dhe të pambrojtur (7-8m thellësi dhe shtyllë ujore 2-3m). Këta puseë të pambrojtur nuk janë të ndërtuar sipas standardeve për pusein higjienik. Kjo flet se uji në puseë është sipërfaqësor me mundësi të madhe të ndotjes dhe me keqësimin e cilësisë së ujit për pije. Nga aspekti shëndetësor këto puse janë faktor rreziku permanent dhe e rëndon situatën epidemiologjike.

5.1.4 Sistemi i kanalizimit

Në komunën e Rahovecit, shumica e vendbanimeve kanë qasje në kanalizim të ujërave të zeza, ndërsa trajtimi mungon l ujërave të zeza.

Tab. Vendbanimet e komunes e Rahovecit që kanë qasje në kanalizim.

Nr	Vendbanimi	Nr.banoreve	Kanalizim
1	Rahovec	15892	PO
2	Bellacerkë	2270	PO-pjesrisht
3	Bërnjak	40	PO
4	Bratotin	396	PO
5	Brestovc	1288	PO
6	Celinë	1903	PO
7	Çifllak	1292	PO
8	Dobidol	799	PO
9	Dejnë	1757	PO
10	Drenoc	1587	PO
11	Gexhë	660	PO
12	Hoqe e Madhe	124	PO
13	Hoqe e Vogel	1166	PO
14	Kaznik	164	JO
15	Kramovik	1125	PO-pjesrisht
16	Krushe e Madhe	4473	PO
17	Mrasor	191	PO-pjesrisht
18	Nagavc	743	PO
19	Nushpal	220	PO
20	Opterushë	1911	PO
21	Pastasellë	1011	PO
22	Pataqan I Eperm	533	PO
23	Pataqan I poshtem	1077	PO
24	Petkoviq	731	PO
25	Polluzhë	808	PO
26	Radostë	2346	PO
27	Ratkoc	3791	PO
28	Retijë e Ulet	234	PO
29	Retijë	771	PO
30	Sapniq	996	PO
31	Sarosh	6	PO
32	Senoc	687	PO
33	Vrajakë	838	PO
34	Xërxë	3184	PO
35	Zatriq	535	PO
36	Zoqishtë	659	PO
Totali		56208	
1	Me Kanalizim	52458	89 %
2	Pjesërisht	3586	8 %
2	Pa Kanalizim	164	3 %



Nga tabela e mësipërme shihet se 50025 banorë kanë qasje në kanalizim ose 89 % e popullsisë së komunës së Rahovecit, me kanalizim pjesërisht të vendosur janë 6019 ose 8 % dhe pa kanalizim janë 164 banorë ose 3%

Nga shifet se një përqindje e madhe e vendbanimeve kanë qasje në kanalizim, por shkarkimi i këtyre kanalizimeve është kryesisht pa trajtim adekuat por janë të derdhura në menyra të egra në lumenjë ose përrocka.

Sistemi i kanalizimit të ujërave të ndotura, gjendja e rrjetit të kanalizimit dhe mungesa totale e trajtimit të ujërave të ndotura në Komunë, çon në ndotje të lumenjve, tokës dhe sigurisht edhe ujit nëntokësor. Një ndotje e tillë paraqet kërcënim serioz për shëndetin e popullatës ashtu edhe për mjedisin në tërësi.

Të gjitha kanalizimet ekzistuese pikë shkarkimin e tyre e kanë në lumenjt ose në përrockat pa asnjë trajtim paraprak.

Në vazhdimi do të paraqiten disa pikëshkarkime të kanalizimeve në disa fshatra.



Pikëshkarkimi Pataqan i poshtem



Pikëshkarkimi Nushpall



Pikëshkarkimi Rahovec



Pikëshkarkimi Drenoc

Me ndërtimin e kolektorëve rreth lumenjeve dhe prrockave do të eliminohen ndotja e ambientit dhe të gjitha rreziqet që shkaktohen nga ujërat fekaletë kanalizimeve. Per shkak të konfiguracionit të terrenit nuk mund të përfshihen të gjitha vendbanimet me një kolektor dhe të trajtohen në një impiant por duhet të parashihen 3 kolektor dhe 3 impiante për trajtimin e ujërave fekal që shkarkohen në lumin Drini i Bardh dhe lumenjtë tjerë.

5.1.5 Bujqesia

Zhvillimi i sektorit të Bujqësisë në komunë kishte një kalim të popullsisë bujqësore në veprimtari jobujqësore ku kjo vazhdimisht rritej, gjë që është ligjësi e përgjithshme në kuadër të zhvillimit

ekonomik. Transferi i popullsisë nga bujqësia dhe të shumtën e kohës nga fshati në veprimtari jobujqësore dhe në qytet zhvillohej në mënyrë të drejtperdrejtë, pa përgatitje profesionale dhe arsimore, në një anë, dhe në mënyrë indirekte, përmes shkollimit të gjeneratës së re dhe të ndryshimit të pozitës socio-ekonomike të popullsisë, në anë tjetër.

Është karakteristik e përgjithshme se bujqësinë e braktis popullsia e re, vitale dhe e arsimuar. Por është e vështirë të konstatohet numri i saktë i kalimit të popullsisë agrare në veprimtari joagrarë.

Ndryshimet në strukturën profesionale dhe në atë të moshave të popullsisë ndikojnë në rritjen e pjesëmarrjes së popullsisë së afte për punë, që paraqet ofertën disponuese të fuqisë punuese.

Numri i popullsisë aktive është 32.000 e prej tyre 16.744 janë meshkuj dhe 16.304 femra.

Në këto kushte të pamjaftueshme në zhvillimin ekonomik ndikon në rritjen e fuqisë së afte punuese duke shkaktuar vështirësi të shfrytëzimit racional të fuqisë aktive punuese.

Mundësitë e rritjes së popullsisë aktive në Komunën e Rahovecit është privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore si dhe gjetja e tregut për plasimin e prodhimeve bujqësore si që janë: prodhimet e rrushit (raki; verat etj), peme dhe perimet dhe ngritja e një objekti për përpunimin e perimeve që kultivohen në komunën e Rahovecit. Komuna e Rahovecit ka potencial bujqësor për kultivimin e prodhimeve sepse ka edhe sistemin e ujitjes (3.500 ha.).

Komuna e Rahovecit edhe sot e kësaj dite ka dominim të popullsisë agrare. pjesa më e

madhe e popullsisë në komune merret me veprimtari agrare dhe atë me rreth 50 %.

5.1.6 Ujitja e sipërfaqeve bujqësore

Mënyrat e ujitjes

Një ndër elementët më të rëndësishëm, pas përcaktimit të tokës dhe kultivimit të një kulture bujqësore është mënyra e ujitjes. Ujitja është faktor bazë në dy-trefishimin e prodhimit bujqësor; përmirësimin e cilësinë së prodhimit; shtimin e të ardhurave; pakësimin e shpenzimeve; uljen e kostove dhe rritjen e fitimit. Ujitja duhet të sigurojë jetesë normale e të rrisë në terma sasiorë dhe cilësorë prodhimin dhe me kosto të ulët. Ajo kryhet kur toka dhe bimët kanë nevojë për ujë. Për këtë merren masa paraprake që uji të mos mungojë në momentet më të rëndësishme bio-fiziologjike të bimës së kultivuar dhe të plotësojë kërkesat e saj, në fazat kritike të rritjes dhe të zhvillimit. Mënyrat e ujitjes së bimëve janë të ndryshme dhe falë përmirësimeve të sistemeve të ndryshme, që shfrytëzohen për shpërndarjen e ujit dhe kërkesave specifike të mënyrave të ndryshme të prodhimit ato kanë evoluar.

Në praktikën bujqësore sistemet e ujitjes që përdoren më shumë janë:

- sistemi i ujitjes me rrjedhje të lirë,
- sistemi i ujitjes në formë shiu dhe
- sistemi i ujitjes së lokalizuar.

Kushtet më të volitshme për bime, ku lageshtia mundëson tretjen e materialeve ushqyese, kurse toka gjithashtu ajroset (përmirësohet me nitratë dhe oksigjen) përveç kësaj ndikon në temperaturën e tokës dhe në mikroklimën.

Sipas kohës vadtja bëhet në Pranverë, Verë, dhe në Vjeshtë.

Sipas zhvillimit të bimëve vadtja mund të bëhet në periudhën e vegjetacionit dhe në periudhën para vegjetacionit.

Sipas punimeve, vadtja mund të bëhet para mbjelljes, para lavimit dhe në kohën e paraqitjes.


Ujitja e një toke me kultura varet nga klima dhe regjionet, vetit të tokës, lloji i bimëve që mbjelljen dhe lartësia e rendimentit që dëshirojme. Ujet për vadtje dote shfrytëzohen në masë të nevojshme sipas sasinave që disponojmë dhe në kushtet tjera agroteknike, faktorët klimatik që ndikojnë në vadtje: reshjet, temperatura, era, avullimi, shkëlqimi i diellit-ndriqimi. Bujqësia ende nuk ka arritur nivelin e zhvillimit. Bujqësia edhe më tutje është në ndikimin e faktorëve klimatologjik, e të cilët dukshëm janë shkaktar të variabilitetit të prodhimtarisë.

Ujitja e vendbanimeve të komunes së Rahovecit bëhet kryesisht nga Hidrosistemi Radoniqi gjegjësisht nga Rezervuari “Rezine”, gjithashtu ujitja është bërë edhe nga burimet e vendbanimeve si burimi i Opterushes që ujiten fshatrat: Opterush, Zogisht dhe Retije mirëpo këto vendbanime nuk janë në funksion.

Në vazhdim do të paraqitet tabela me vendbanime që kanë sistemin e ujitjes

Nr	Vendbanimi	Nr. banorëve	Sistemi i ujitjes
1	Rahovec	15892	
2	Bellacerkë	2270	PO
3	Bërnjak	40	PO

4	Bratotin	396	Pjesërisht
5	Brestovc	1288	
6	Celinë	1903	PO
7	Çifllak	1292	PO
8	Dobidol	799	PO
9	Dejnë	1757	PO
10	Drenoc	1587	
11	Gexhë	660	PO
12	Hoqe e Madhe	124	
13	Hoqe e Vogel	1166	
14	Kaznik	164	
15	Kramovik	1125	PO
16	Krushe e Madhe	4473	PO
17	Mrasor	191	
18	Nagavc	743	Pjesërisht
19	Nushpal	220	
20	Opterushë	1911	
21	Pastasellë	1011	
22	Pataqan I Eperm	533	
23	Pataqan I poshtem	1077	
24	Petkoviq	731	
25	Polluzhë	808	
26	Radostë	2346	PO
27	Ratkoc	3791	PO
28	Retijë e Ulet	234	
29	Retijë	771	
30	Sapniq	996	PO
31	Sarosh	6	PO
32	Senoc	687	
33	Vrajakë	838	
34	Xërxë	3184	PO
35	Zatriq	535	
36	Zoqishtë	659	
Totali		56208	
1	Me Ujitje	21922	39%
2	Pa Ujitje	34286	61%



Nga tabela e mësipërme shihet se 21922 banorë kanë sistemin e ujitjes ose 39% e popullsisë se komunës së Rahovecit dhe 34286 nuk kanë sistem të ujitjes 61% .

Në disa vendbanime është punuar projekti për të bërë edhe ndertimi dhe të rritet përqindja e vendbanimeve me sistem të ujitjes.

Në disa vendbanime është punuar projekti i ujitjes

DRAFT

PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL RAHOVEC (2017-2025)




- Legjenda:**
- Kufiri i Komunes
 - Kufiri i Komunave fqellore
 - Rruges Magjistrale
 - Rruges Regionale
 - Rruges Lokale
 - Hidrovendosje
 - Tuneli
 - Ujë
 - Lumenjtë të rregulluar
 - Deget e kullit
 - Proshkë
 - Sipërfaqja e Ndërtuar
 - Qendrat Komunale
 - Ferhat
 - Rrjetet e Kanalizimit
 - Kanalizimi
 - Ka kanalizin
 - Ka kanalizin të përmirësuar

GJENDJA EKZISTUESE

Rrjetet e Kanalizimit

1:50 000

20



Harta 8_Qasje në rrjetin e kanalizimit

5.1.7 Drenazhimi (kullimi)

Vendbanimet e komunes së Rahovecit përveq ujitjes kanë edhe sistemin e drenazhimit të sipërfaqeve bujqësore.

Për të marrë maksimumin e prodhimit nga një bimë duhet që asaj ti krijojmë kushte të favorshme rritje që një nga këto është dhe ujitja e saj. Por duke duke e ujitur më shumë sec duhet bimën ose uji që vjen nga shiu etj, krijon në tokë një sasi më të madhe lagështire nga ç'kërkohej nga bima, për të larguar këtë lagështi, dhe për ti krijuar bimës zonën e tokës së përjruar aty ku rrënjët e bimës marrin ajër, ne bëjmë kullimin e tokave që nuk është gjë tjetër, veçse largimi i ujrave sipërfaqësor të krijuara nga shiu dhe i ujrave nëntokësorë kur ka me anën e një sistemi kanalesh kullues. Këto kanale ndahen ndahen në të tretë, të dytë, dhe të parë.

Vendosja e këtyre kanaleve në fushë bëhet duke pasur parasysh që kanalet e tretë vendosen në kuota më të larta dhe më pas vendosen kanalet e dytë dhe në kuotat më të ulëta të fushës vendosen kanalet e parë kullues.


Vendbanimet që kanë vazhdimisht probleme me vërshime: Kramovik, Qifllak, Dobidol, Denjë, Ratkoc, Malsie e Vogël, Gexhe, Xërxë, Fortesë, Celinë, Krushë e Madhe.

5.2 Instalimet eketroteknike dhe telekomunikimit

5.2.1 Rrjeti elektroenergjetik.

Rrjeti elektroenergjetik në Komunën e Rahovecit është permirsuar pas perfundimit të projektit për ndërtimin e **TS 110/35/10(20)kV** i cili ndodhet në dalje të Rahovecit në drejtimin e Xërxes, dhe linja **110kV** nga Theranda ne Rahovec

Ne Fig 1 është paraqitur linja e re 110 kV nga Theranda deri në Rahovec



Linja kablllovice 35kV fillon nga TS 110/35/10(20)kV – Rahovec dhe furnizon trafostacionet ekzistuese: **TS 35/10(20)kV – Rahovec** dhe **TS 35/10(20)kV – Xërxë**.


Gjithashtu edhe linjat kablllovice te reja nga **TS I RI 110/35/10(20)kV** deri te **35/10(20)kV** kanë ndihmuar në përmirsimin e situates elektroenergjetike.

- Situata elektroenergjetike në komunën e Rahovecit është mjaft e mirë sa l përket furnizimit me energji elektrike. Në disa zona të caktuara rrjeti duhet të përmirsohet dhe të shtohen kapacitete energjetike duke shtuar numrin e transformatorve 10(20)/0.4kV.

Pra rrjeti i energjise elektrike te tensionit te larte dhe te mesem ne komunen e Rahovecit është mjaft mire e mbuluar, shikuar nga aspekti i furnizimit me energji elektrike, edhe pse ne disa pjese te caktuara te komunes nevojitet shtimi i kapaciteteve, pra transformatorë të ri në menyër të përmirësimit të metejmë të rrjetit elektrik ne komune. Nga gjithsejtë 36 km, sa ka gjatësi rrjeti energjetik i tensionit të lartë 34.3 km e rrjetës energjetike gjendet në zonën kopshteve. Në përgjithësi kërkohet që kapaciteti i rrjetës energjetike ne të gjitha drejtimet të ketë rritje, përkatësisht duhet të vazhdohet rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik nga 10 kv në 20 kv.

Rrjeti i tensionit te mesem 10(20) kV elektroenergjetik ne Komunen e Rahovecit, kapacitetet ne kV , trafot individuale dhe kolektive, duken si ne tabelen e meposhtme

Drejtimi i rrjetit energjetik	Kapaciteti ne kV	Trafot	Individuale	Kolektive	Nr. konsumatorve
Drejtimi i Qytetit 1	10 kV	4		4	1197
Drejtimi i Qytetit 2	10 kV	5		5	1422
Drejtimi i Nëntori 2	10 kV	1	1		1
Drejtimi i Nëntori 3	10 kV	2	2		2
Drejtimi i Komunes	10 kV	4		4	941
Drejtimi Hidrosistemi	10 kV	20	20		34
Drejtimi Shkolla e mesme	10 kV	2		2	623
Drejtimi i Shkozës	10 kV	14	11	3	200
Drejtimi i Opterushe	10 kV	26	4	22	1539
Drejtimi i Potaçanit	10 kV	24		24	1077
Drejtimi i Stone Castle	10 kV	1	1		6
Drejtimi i Bodrumit	10 kV	4	3	1	42
Drejtimi i Forteses	10 kV	8		8	985
Drejtimi i Ratkocit	10 kV	19	3	16	1035
Drejtimi i Dejniti	10 kV	34	6	28	985
Drejtimi i 18 Nëntorit	10 kV	2	2		2
Drejtimi i Silosi 1	10 kV	1	1		1
Drejtimi i Silosi 2	10 kV	1	1		1
Drejtimi i Xërxës	10 kV	18	13	5	450
Drejtimi i Matresit	10 kV	3	2	1	23
TOTALI	1	193	70	123	9942



Harta 9_Rrjeti elektroenergjetik

5.2.2 Permirësimi i energjise elektrike

Keto kapacitete supozohet se në një të ardhme të afërt nuk do të jenë të mjaftueshme, prandaj propozohet shtimi i kapaciteteve elektroenergjetike.

Propozimi i shtimit të kapaciteteve elektroenergjetike në të ardhmen të bëhen sipas supozimeve në tabelën e mëposhtme.

Tabela . Rrjeti i energjise elektrike, sipas kapaciteteve të propozuara

Drjtimi i rrjetit energjetik	Kapaciteti i propozuar në kV	Numri i traostacioneve të propozuar	Statusi Fizik
Drejtiumi i Qytetit I	20 kV	2	Permirsim Solid
Drejtimi i qytetit II	20 kV	1	Permirsim Solid
Drejtimi i Komunes	20 kV	1	Permirsim Solid
Drejtimi Shkolla e Mesme	20 kV	1	Permirsim Solid
Drejtimi i Opterushes	20 kV		Permirsim selektiv
Drejtimi i Potaqanit	20 kV		Permirsim selektiv
Drejtimi i Bellacerkes-Forteses	20 kV		Permirsim Solid
Drejtimi i Shkozez	20 kV		Permirsim Solid
Drejtimi i Ratkocit	20 kV	2	Permirsim selektiv
Drejtimi i Denjit	20 kV		Permirsim selektiv
Drejtimi i Xërxës	20 kV		Permirsim selektiv
TOTALI		7	

Përveq shtimit të transformatorve nevojitet edhe përmirësimi i rrjetës elektrike të tensionit 10(20)kV si dhe 0.4kV. Në zonat rurale duhet të bëhet ndërrimi i shtyllave elektrike të drurit me ato të betonit, kurse në zonën e qytetit një pjesë e rrjetit është e përmirësuar me vendosjen e kanaleve nëntokësore të kabllave 10(20) kV që lidhë nënstationin elektrik 35kV me nënstationet 10/0.4 kV.

Zëvendësimi i perqesve të zhveshur me kabllat ajrore në zonat rurale dhe me kabllat nëntokësore në zonat urbane gjithashtu duhet të kryhet brenda një periudhe sa më të shkurtër.

Rrjeti primar dhe sekondar i energjisë elektrike në Komunën e Rahovecit është paraqitur në hartën e mëposhtme.

5.2.3 Ndriçimi Publik

Është e evident vetëm në zonën urbane si dhe në vendbanimet Krushe e Madhe si dhe në disa vendbanime kanë pjesërisht ndriçim publik: Celina, Operusha, Fortesa, Retija e Ulët, Rrjeti i sistemit të ndriçimit është i përberë prej shtyllave të drurit dhe disa prej tyre janë shtylla të betonit me lartësi deri në 8.5 m, distanca në mes të shtyllave është 35 metra.

Është e nevojshme që rrjeti i ndriçimit publik të bëhet në vendbanimet e mëdha dhe të dendura me numër të popullsisë si dhe në qendrat Sekondare (Ratkoc, Xërxë, Bellacërke, Radoste, Celine, Drenoc, Denjë, Cifllak dhe në Krushe të Madhe në pjesët e pa mbuluara).

5.3 Telekomunikacioni

5.3.1 Telefonia Fikse

Lidhjet kryesore të telekomunikacionit për Komunën e Rahovecit me qytetet tjara dhe jashtë komunës janë kabllot optike PTK dhe të operatorëve privat të telekomunikimeve. Rrjeti i kabllave optike dhe telekomunikimeve të PTK, menaxhohet nga njësi e PTK-së, në Rahovec e

cila ka vetëm një objekt postar dhe ka centralin e lidhur me fiber optik. Kapaciteti total i centralit të postës në Rahovecit është gjithsej 6000 qifte²⁴, prej të cilave 250 shfrytezohen, ndërsa pjesa tjetër është e pa shfrytëzuar.

Nga gjithsej 36 vendbanime sa ka komuna administrative e Rahovecit, vetëm 5 vendbanime kanë qasje direkt në rrjetin e telefonise fikse.

Kapaciteti momental është i mjaftueshëm edhe për periudhën e ardhme 10 vjeçare, mirëpo është e rëndësishme që të bëhet shtrirja e rrjetit në aspektin fizik në vendbanimet e tjera të cilat janë më të mëdha për nga numri i popullsisë. Shtrirja e rrjetit të telefonise fikse ekzistuese mundeson qasje të mbi 47.5% të popullsisë në rrjetin e telefonise fikse.

Tabela 27. Pjesëmarrja e popullsisë në rrjetin e telefonise fikse

Total banorë komuna e rahovecit	56208 (100%)
Pop. Me qasje në tel. fikse	33957 banorë
& e pop. me qasje në tel. fikse	(47.5%)

Nga tabela mund të shohim se rrjeti i telefonise fikse në komunën e Rahovecit është i shtrirë në 13.9% të vendbanimeve me gjithsej 47.5% të popullsisë. Nga kjo mund të konstatohet se pjesëmarrja e popullsisë në nivel të komunes nuk është e kënaqshme dhe se ky rrjet mbulon një pjesë të vogël të vendbanimeve, por kryesisht me nr. të madh të popullsisë.

5.3.2 Telefonia mobile

Mbulueshmëria me rrjet të telefonive mobile në Rahovec është mjaft mirë e shtrirë dhe mund të thuhet se të gjitha vendbanimet e Rahovecit kanë qasje në shërbimet e telefonise mobile, të cilat ofrohen nga dy operatorët e licencuar nga ART-ja. Të dy operatorët mobil i kanë të shpërndara antenat individuale në lokacione të ndryshme të komunes. Numri i antenave të vendosura nga operatorët mobil sipas vendbanimeve dhe operatorëve në tërë territorin e komunes është 12.


5.3.3 Shërbimet Postare

Mbulohen nga Posta që është pjesë e PTK dhe gjithashtu nga kompanit private të cilat kryejnë shërbime si posta të shpejta dhe ngjajshëm.

5.3.4 Shërbimet e Internetit

Ekzistojnë disa operator të cilët bëjnë shpërndarjen e shërbimeve të internetit në komunën e Rahovecit. Territori i komunes nuk është i mbuluar plotësisht me shërbime të internetit, kryesisht nuk janë të mbuluara viset malore dhe disa pjesë të vendbanimeve rurale. Kryesisht interneti në zonat rurale është i shpërndarë në nivel të internet kafe-ve, të cilat ofrojnë shërbime në vendbanime të ndryshme, si dhe kanë qellime komerciale. Operatorët me ndikim më të madh, që ofrojnë shërbime të internetit në komunën e Rahovecit janë:

1. PTK - Darda NET, nëpërmjet të telefonise fikse
2. IPKO – ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave (individuale) dhe
3. KUJTESA - ofron shërbime të internetit nëpërmjet të antenave (individuale)



Harta 10_Rrjeti i telefonisë mobile

5.3.5 Radiotelevizioni

Rrjeta e Radiotelevizionit në komunën e Rahovecit është e shpërndare pothuajse në tërë territorin e komunës. Në këtë komunë ekzistojnë disa forma të shfrytëzimit të vleve radio-televizive të ndara në dy grupe:

1. Radio-televizionet Nacionale – RTK, RTV21 dhe KTV
2. Radio - lokale –radio Aktiv
3. Radio-televizionet nepermjet antenave Satelitore.
4. Radio-televizionet nepermjet sistemeve kablllore.

5.3.6 Foltore publike

Në funksion të ofrimit të shërbimeve të telefonisë fikse do të jetë edhe rritja e numrit të foltoreve publike në zonën urbane dhe në vendbanimet e propozuara si vendbanime sekondare dhe qendrat e bashkësive lokale. Gjithashtu propozohet që të vendosen foltore publike në të gjitha vendbanimet ku ka rrjet të telefonisë fikse, Numri i foltoreve publike në dy qendra sekondare (Ratkoc dhe Krushe e Madhe) duhet të jetë minimum dy për qendër sekondare.

5.4 Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave¹⁹

Bazuar në regjistrimin e fundit të vitit 2011, Komuna e Rahovecit ka gjithsej 56.208 banorë. Shtrirja e popullatës në komunë është më shumë në zonë rurale sesa urbane, me 15.892 banorë në zonën urbane (28.7%) dhe 40.316 (71.3%) në zonat rurale.

Tabela 1: Numri i popullsisë dhe shkalla e rritjes

Viti	Total	Urbane	Rurale
2011	56,208	15,892	40,316
2012	56,854	16,075	40,780
2013	57,508	16,260	41,249
2014	58,170	16,447	41,723
2015	58,839	16,636	42,203
2016	59,515	16,827	42,688
2017	60,200	17,021	43,179
2018	60,892	17,216	43,676
2019	61,592	17,414	44,178
2020	62,300	17,615	44,686
2021	63,010	17,821	45,194

Burimi: ASK, 2011

¹⁹ Plan i përgjithshëm i menaxhimit të mbeturinave për komunën e Rahovecit, 2016 – 2021

Nga tabela 1 mund të shihet trendi i rritjes së popullsisë në Komunën e Rahovecit, ky trend nuk pritet të shenojë rritje të madhe në pesë vitet e ardhshme.

Në bazë të vlerësimeve të bëra, në Komunën e Rahovecit dominon mosha e re, dhe atë si në zonën urbane njashtu dhe atë rurale. Ndërsa grupmosha dominante e popullsisë janë kategoria 19-44 vjece.

Nëse bëhet një analizë më e thellë e strukturës së popullsisë në komunën e Rahovecit mund të vërehet se popullsia është e shtrirë pothuajse në mënyrë të barabartë në të gjitha zonat. Mund të shifet një numër më i madh i shtrirjes së banorëve (71.6%) në pjesën rurale të Komunës gjegjësisht në distancat nga 3-9 km. Shpjegimi rreth shtrirjes është dhënë edhe në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2: Numri i popullsisë sipas grupeve:

Popullata	0-3 km	3-6 km	6-9 km	9-12 km	12-40 km	Total	Ne %
Urbane	15,892	-	-	-	-	15,892	28.3%
Para Urbane	-	4,205	-	-	-	4,205	7.5%
Rurale	-	-	7,023	14,647	-	21,670	38.6%
Rurale e Thell	-	-	-	-	14,441	14,441	25.7%
TOTALI	15,892	4,205	7,023	14,647	14,441	56,208	100.0%

5.4.1 Operatori i menaxhimit të mbeturinave

Operatorët e autorizuar nga komuna e Rahovecit respektivisht nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë janë Ndermarrja Publike “Ekoregjioni”²⁰ me njësinë e saj “Ambienti” mbulon territorin e Rahovecit. Pjesëmarrja e komunës së Rahovecit në këtë ndërmarrje është 8%, ndërsa përveç “Ekoregjionit” në Rahovec operon edhe kompania private “Ekodrinia” e cila po ashtu një pjesë të territorit të komunës. Veprimtaria primare e operatorëve është grumbullimi dhe transporti i mbeturinave komunale, si dhe shërbime dytësore si: menaxhimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike, pastrimin e rrugëve, pastrimin e borës, si dhe mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta publike.

Kompania shërben tri kategori të konsumatorëve respektivisht konsumatorët shtëpiak, bizneset dhe institucionet. Konsumatorët shtëpiak ndahen sipas mënyrës se si e pranojnë shërbimin, në konsumatorë shtëpiak të cilët pranojnë shërbimin derë më derë dhe konsumatorë të pajisur me kontejnerë. Bizneset ndahen në biznese të vogla dhe të mesme të cilat pranojnë shërbimin pa kontrata dhe bizneset të mëdha me kontrata të veçanta të shërbimit. Bizneset të vogla dhe të mesme një pjesë e tyre shërbehet me shërbimin derë më derë dhe pjesa tjetër është e pajisur me kontejnerë të veçantë. Bizneset me kontrata janë të pajisura me kontejnerë të veçantë. Institucionet janë kategori e tretë e konsumatorëve dhe hiq ndonjë zyre të vogël të OJQs, avokatie apo të ngjashme zakonisht janë me kontrata të veçantë dhe të shërbyer me kontejnerë të veçantë.

Periudha kohore e grumbullimit të mbeturinave zakonisht zhvillohet nga ora 07:00 – 14:00.

Për procedurën dhe metodologjinë e caktimit të tarifave, kompania ka aplikuar tarifat që kanë qenë sipas modelit të ZRRUM-it (2006), të ndryshuara dhe aprovuara nga Bordi i Drejtorëve në Qershor të vitit 2012, të cilat ende janë në fuqi. Mekanizmi i inkasimit për momentin në amvisëri dhe biznese të vogla bëhet përmes Inkasantëve dhe arkës ndihmëse,

²⁰ E cila operon në: Prizren, Rahovec, Suharekë, Malishevë dhe Dragash

por ka raste që bëhet edhe nëpërmjet llogarisë rrjedhëse nga konsumatori. Kurse tek bizneset e mëdha dhe institucionet, inkasimi bëhet përmes arkës dhe llogarive rrjedhëse.

Numri total i klientëve të kompanisë "Ekoregjioni"-NJP "Ambienti" dhe "Ekodrinia" për vitin 2015 dhe përditësimet e fundit në Shtator të vitit 2016, ka qenë rreth 9130 dhe kjo ka ndryshuar nga muaji në muaj sipas arkëtimeve:

Shtrirja zonale e amvisërive dhe bizneseve (klient) të cilat janë të përfshira në shërbimin e menaxhimit të mbeturinave sipas kompanisë "Ekoregjioni" dhe "Ekodrinia" janë:

- Zona Urbane: e cila i takon vetëm Rahovecit si qytezë – 3072 klient
- Zona Rurale : zonat e mbetura të rrethinës – 6064 klient

NJP "Ambienti" ka të punësuar gjithsej 41 punonjës. Kompania tjetër "Ekodrinia" ka 9 punëtor.

Mbeturinat e mbledhura nga konsumatorët dërgohen për deponim final në deponinë sanitare në Landovicë që menaxhohet nga Kompania për Menaxhimin e Mbeturinave të Kosovës (KMDK) – Prishtinë. Paga për deponimin permanent bëhet tek Deponia Sanitare në Landovicë, ku edhe bëhet matja përkatëse.

Kapaciteti ruajtës i mbeturinave me kontejnerët ekzistues është rreth 25 ton. NJP "Ambienti" posedon 5 kamion kompaktorë, 1 kamion me cisternë, 1 kamion me rimorkio, 3 traktorë.

"Ekodrinia" posedon 3 kamiona 12, 11 dhe 6 tonesh, një kamionetë dhe një cisternë 15000 L.

5.4.2 Menaxhimi i Mbeturinave

Sasia e mbeturinave e cila grumbullohet brenda një dite sillet 20-30 ton, kurse sipas raporteve të dy kompanive që operojnë në Komunën e Rahovecit, shërbimi i grumbullimit të mbeturinave zhvillohet në të gjitha vendbanimet e komunës, megjithatë një pjesë e amvisërive nuk pranon të bëjë marrëveshje me operatorët. Pavarësisht mbulueshmërisë prej 100%, prap se prap haset në deponi ilegale si dhe hudhje e mbeturinave në mënyrë të pa kontrolluar, po ashtu janë të evidentuara edhe "hot-spotet" (pikat e ndjeshme) të ndikimeve mjedisore në këtë komunë me theks të veçantë në sektorin e mbeturinave, sipas raportit për mbeturinat i botuar më 2014, i cili është përgatitë nga Agjencioni për Mbrojtje të Mjedisit i Kosovës (AMMK), Komuna e Rahovecit cilësohet të ketë ndikim prej 3-5ha të hapësirës komunale të mbuluar me deponi ilegale.

Arsyet kryesore për grumbullimin jo të plotë të mbeturinave janë të ndryshme, si:

- Niveli i ulët i vetëdijes në mesin e banorëve;
- Kapacitetet e kufizuara të Ndërmarrjes Publike për menaxhimin e mbeturinave;
- Mospagesa e një pjesë të përfituesve të shërbimit;
- Mos zgjidhja e çështjes së mbeturinave ndërtimore (demolimeve);
- Problemi i pazgjidhur i menaxhimit të mbeturinave nga mbetjet shtazore;
- Shkalla e ulët dhe informale e ndarjes dhe riciklimit.

Aktualisht operatori më i madh është NJP "Ambienti" e cila sipas shënimeve ofron shërbim primar të grumbullimit të mbeturinave për 66% të popullatës së përgjithshme, dhe atë 100% të zonën urbane dhe rreth 27% në zonat rurale. Kurse operatori tjetër "Ekodrinia", shërben kryesisht në pjesën rurale dhe rurale të thellë me përqindje të përgjithshme prej 34%.

Me gjithë përparimet e shënuara, disa kategori të mbeturinave paraqesin një sfidë jo të lehtë për komunën, në veçanti mbeturinat ndërtimore/demolimet, mbeturinat shtazore, etj.

5.4.3 Mbeturinat Ndërtimore/demolimet:

Si rezultat i mosekzistimit të deponisë adekuate për këto kategori të mbeturinave, mbetjet nga materialet ndërtimore dhe demolimet për shkak të hidhen gjithandej duke renduar aspektet mjedisore dhe estetike. Shpesh hedhja e pakontrolluar e këtyre mjeteve shkakton krijimin e deponive të egra dhe hudhjen e mbeturinave të ndryshme nga ana e banoreve dhe bizneseve. Përpos kësaj nuk ekziston lidhja në mes të dhënies së lejeve ndërtimore dhe sistemit të monitorimit të hudhjes së mbeturinave. Sa i përket deponisë së inerteve Komuna është në procesin e përzgjedhjes së lokacionit të duhur. Projekti i ndërtimit të deponisë së inerteve është i përfshirë në listën e projekteve që parashihen të realizohen në Planin e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave ku parashihet bashkëfinancimi 40% donatori; 30% Buxheti i Kosovës; dhe 30% Komuna e Rahovecit.

5.4.4 Mbeturinat nga Mbetjet Shtazore:

Menaxhimi i mbetjeve shtazore në Komunën e Rahovecit nuk është në harmoni me dispozitat respektive, në rendë të parë për shkak të mungesës së impiantit të trajtimit të mbetjeve shtazore. Në Komunë ekzistojnë 8 subjekte që merren me prodhimin, përpunimin dhe konservimin e mishit prej tyre 3 mishtore dhe 5 thertore. Me disa prej tyre operatori aktual ka kontrata të shërbimit dhe i grumbullon mbeturinat, ndërsa një pjesë e subjekteve i hedh këto mbeturina në formë ilegale. Për më shumë, edhe mbeturinat me prejardhje shtazore që grumbullohen nga ana operatorit të licencuar nuk është e qartë si trajtohen meqë deponia regionale nuk pranon që ky lloj mbeturinave të deponohet në këto lokacione të veçanta.

5.4.5 Strategjia dhe Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave

parashohin financimin e ndërtimit të impiantit të mbetjeve shtazore, i cili do të parashihte rregullimin e menaxhimit të mbetjeve të kësaj natyre në nivel të Kosovës përfshi këtu edhe Komunën e Rahovecit.

Realizimi i këtyre projekteve që parashihet të realizohet në periudhën projektuese do të kontribuonte në menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave komunale.

Vlenë të theksohet se një deponi e tillë është duke u ndërtuar dhe financuar nga zyra e BE-së në Kosovë, ku do të ketë për qëllim, grumbullimin e të gjitha mbetjeve të kafshëve nga i gjithë territori i Kosovës.

Me ndërtimin e kësaj deponie, do të përfitoj edhe Komuna e Rahovecit, ku do ti obligoj banorët/aktivitetet të cilat merren me këtë aktivitet të deponojnë këto mbetje në deponinë adekuate dhe jo në deponi të egra.

Sa i përket mbetjeve të rrezikshme, në Komunën e Rahovecit nuk ka ndonjë aktivitet që do të kontribuonte substancialisht në ngritjen e ndikimit në mjedis nga këto mbetje. Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme përfshi këtu mbeturinat kimike-industriale dhe ato medicinale do të kontribonte në përmirësimin e mjedisit dhe minimizimin e mundësisë së kontaminimit të mbeturinave komunale tokës dhe burimeve ujore nëntokësore. Largimi efektiv i mbeturinave ndërtimore dhe mbetjeve shtazore do të rezultonte në lirin e ngarkesës për operatorët që grumbullojnë dhe bartin mbeturinat komunale. Poashtu menaxhimi i tyre i duhur, do evitonte shkakun për hapjen e deponive të egra siq po ndodhë në periudhën e tanishme.

5.4.6 Planifikimi i Menaxhimit të Mbeturinave

Plani Lokal për Menaxhim të Mbeturinave paraqet dokument me të cilin organizohet procesi i menaxhimit të mbeturinave në nivel të Komunës. Në të cilin do të definohen drejtimit dhe prioritetet, si dhe dinamika dhe mënyra e zgjidhjes së problemeve në harmoni me legjislaturën pozitive kombëtare dhe të BE-së në aspektin e menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtjes së mjedisit në tërësi. PLMM përveç se është detyrim ligjor, ka për cak gjetjen dhe zbatimin alternativave më të mira për menaxhim të mbeturinave.

Caku i punimit të Planit është vendosja e sistemit të qëndrueshëm afatgjatë në menaxhimin e mbeturinave në nivel të Komunës, në mënyrë që të përmirësoj cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor. Shfrytëzimit racional të burimeve dhe respektimin e parimeve moderne në menaxhimin e mbeturinave, me pjesëmarrje të koordinuar të gjitha akteve të menaxhimit të mbeturinave.

Në kuadër të PLMM do të bëhet analiza e kapaciteteve ekzistuese për trajtimin e mbeturinave, po ashtu do të bëhet analiza e kapaciteteve ekzistuese të menaxhimit të mbeturinave, në bazë të cilave do të shqyrtohet nevoja për zhvillime të mëtutjeshme. Synim tjetër i rëndësishëm i PLMM është që të adresoj shumë ceshtje të hapura të cilat determinojnë vendosjen e një sistemi tërësisht të ri në menaxhim të mbeturinave, i cili bazohet sipas sygjërimeve që jep Strategjia Kombëtare për Menaxhim të Mbeturinave të Republikës së Kosovës, Ligji për Mbeturina, Standardet Europiane dhe masat ligjore që prekin këtë fushë.

Synimet e përgjithshme me PLMM

PLMM paraqet dokumentin bazë me të cilin organizohet procesi i menaxhimit të mbeturinave në nivel të Komunës. Komuna e Rahovecit është e përcaktuar që të përmirësoj gjendjen e menaxhimit të mbeturinave dhe në këtë drejtim ka parashtruar objektiva specifike që janë pjesë integrale e këtij plani. Ato përfshijnë shtrirjen e shërbimeve, parandalimin, minimizimin dhe riciklimin e mbeturinave si dhe eliminimin e hudhjes së mbeturinave në hotspote apo deponi ilegale, por në vendin e përcaktuar. Objektivat janë të ndarë në dy etapa respektivisht në periudhën 2016-2018 dhe 2018-2021.

Komuna synon që përmes planit të menaxhimit të mbeturinave të arrijë:

- Vendbanime të pastra, mjedise të shëndetshme për banorët,
- Promovimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të trajtimit të mbeturinave,
- Përfshirja me shërbim të tërë zonës përmes tarifës së përballueshme si dhe rritje të inkasimit,
- Të definohen caqet e menaxhimit të mbeturinave në nivel komunal në harmoni me legjislaturën kombëtare,
- Të definohet sistemi optimal i menaxhimit të mbeturinave,
- Të definohen investimet e përgjithshme financiare dhe investimet në pjesët prioritare të planit të cilat duhet menjëherë të zbatohen.

Objektivat

1. *Vendosja e sistemit institucional për menaxhim me mbeturina,*
2. *Krijimi i sistemit financiar për MM-në*
3. *Krijimi i procesit të kontraktimit për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave*
4. *Promovimi i minimizimit të mbeturinave përfshirë mbylljen e deponive ilegale*
5. *Përkrahje për ri-organizimin e komunitetit*

6. Zhvillimin e pilot projekteve me qëllim të realizimit të 3R-konceptit (Reciklim, Reduktim dhe Ripërdorim)

Caqet

Plani synon të menaxhojë me mbeturinat nga ekonomitë familjare (amvisërit dhe nga bizneset afariste), dhe mbeturinat komunale.

- Shkalla e mbuluesmërisë së shërbimit të grumbullimit do të thotë shkalla e popullsisë së shërbyer me popullsinë e përgjithshme.
- Shkalla e grumbullimit do të thotë shkalla e sasisë së mbeturinave të grumbulluara me sasinë e përgjithshme të gjeneruar.
- Shkalla e hedhjes ilegale do të thotë shkalla e mbeturinave të hedhura ilegalisht duke përfshirë hedhjen jo të duhur brenda zonës pa shërbim me sasinë e përgjithshme të mbeturinave të gjeneruara.
- Shkalla e deponimit final do të thotë shkalla e mbeturinave të deponuara në deponitë e licencuara dhe ato të palicencuara (hudhja ilegale) me sasinë e përgjithshme të mbeturinave të gjeneruara.
- Shkalla e reciklimit do të thotë sasia e mbeturinave të recikluara me sasinë e përgjithshme të gjeneruar.

Duhet theksuar se të dhënat e paraqitura në tabelen e mesipërme janë hartuar duke u bazuar në të dhënat e grupit punues, si dhe përmes modelit kompjuterik, që shërben që të bëhen supozime për periudhat e ndryshme duke matur trendet paraprake.

5.4.7 Fazat e zbatimit të planit 2016-2021

Vizioni i lartpërmendur do të arrihet hap pas hapi. Viti i synuar i Planit për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Rahovecit, është prej 2016 deri 2021. Kjo periudhë ndahet në dy faza, si më poshtë.

Implementimi i planit për menaxhimin e mbeturinave 2016-2021 është i bazuar në dy faza :


- Faza e 1 të : 2016 – 2018 - Krijimi i një sistemi të shëndoshë të menaxhimit të mbeturinave, që nënkupton se brenda kësaj periudhe kohore do të krijohet sektori i menaxhimit të mbeturinave, në mënyrë që të krijohet data baza e të dhënave, e cila do të shërbente për një menaxhim efikas rreth mbeturinave dhe po ashtu mundësia që të realizohet inkasimi për mbeturina në Komunë.
- Faza e 2 të : 2018 – 2021 - Krijimi i sistemit të ri të grumbullimit, që nënkupton se gjatë kësaj periudhe synohet të arrihet sistemi i ri i grumbullimit të mbeturinave duke analizuar dhe vlerësuar gjendjen aktuale të resurseve humane dhe pajisjeve për arsye se do të rritet niveli i shërbimit në mënyrë që të rritet edhe niveli i inkasimit.

Duke u bazuar në synimet e ndara në këto dy faza , plani pesë vjeçar i MM mund të modifikohet deri në fund të vitit 2018, bazuar në progresin e performancës aktuale në fazën e parë.

Realizimi i planit në periudhën e planifikuar do të modifikohet, monitorohet e të përshtatet në fund të vitit 2018 bazuar në arritjet e rezultateve të përcaktuara në fazën e parë.

5.4.8 Zonat e shërbimit

Fig 1. Ndarja zonale e komunes së Rahovecit



Zonimi i territorit të Komunës së Rahovecit për qëllime të menaxhimit të mbeturinave
Për qëllime të organizimit të menaxhimit të mbeturinave është krijuar sistemi i zonimit të territorit.

Zonimi i territorit është bazuar në kriteret :

- Shpërndarja proporcionale e zonave të drejtimeve dhe linjave të operimit të ne menaxhimit të mbeturinave
- Shpërndarja në bazë të numrit të banorëve
- Shpërndarja në bazë të numrit të amvisërive
- Shpërndarja në bazë të numrit të objekteve

Zona e synuar për Planin Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave është e gjithë zona administrative e Komunës së Rahovecit. Zona që synohet të arrihet me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në kuadër të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave janë disa familje të fshatrave të zonës së 2 (ngjyra e hapur) ku synohet të futen në sistem edhe 533 ekonomi familjare shtesë ku deri tash në një mënyrë apo tjetrën nuk kanë qenë pjesë e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, detajet e fshatrave dhe gjenerimit të mbeturinave mund të shihen në tabelën e mëposhtme së bashku me synimin për mbulueshmëri gjatë implementimit të këtij plani :

Tabela 3: Lokalitetet të cilat nuk marrin shërbim të plotë të MM

Lokalitetit	Zona	Distanca KM	Rangu Km.	Ekonomi Famil.	Ekonomi Famil./Te Mbulura	Ekonomi Famil./Pa Mbulura	Gjen.Mbet.ne Vit-Ton	Mbet. Jo-te. Menaxh.
Nushpal	Zona 2	7	6-9	32	22	10	40	13
Senoc	Zona 2	7	6-9	101	69	32	125	39
Polluzhë	Zona 2	11	9-12	162	60	102	147	93
Gexhë	Zona 2	12	9-12	165	68	97	120	71
Kaznik	Zona 2	13	12-40	24	8	16	24	16
Bratotin	Zona 2	21	12-40	58	24	34	58	34
Dabidol	Zona 2	21	12-40	138	36	102	117	86
Sarosh	Zona 2	23	12-40	2	1	1	1	0
Petkoviç	Zona 2	28	12-40	183	56	127	107	74
Mrasor	Zona 2	32	12-40	28	15	13	28	13
Total				892	359	533		439

Pra synohet që të rritet mbulueshmëria për fshatrat e kësaj zonë dhe të futen në sistem të menaxhimit të mbeturinave edhe 439 ton mbeturina vjetore, sic edhe mund të shifet nga tabela e mëposhtme.

Tabela 4: Implementimi i MM -Kategorit kryesore per periudhen 2016-2021

Kategoria	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Total
Ekonomit Familare	-	393	140	-	-	-	533
Nr.Lokalitetet	-	8	2	-	-	-	10
Numri i banoreve	-	2,116	140	-	-	-	2,256
Mbeturinat e Gjeneruara(Ne TON)	-	352	87	-	-	-	439

Tabela 5: Iplemetimi I MM -Ekonomite Familiare

Zona	Viti/Implemetim	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Total
Nushpal	2017		10					10
Senoc	2017		32					32
Polluzhë	2017		102					102
Gexhë	2017		97					97
Kaznik	2017		16					16
Bratotin	2017		34					34
Dabidol	2017		102					102
Sarosh	2017		1					1
Petkoviç	2018			127				127
Mrasor	2018			13				13
Total		-	393	140	-	-		533
Lokalitetet		-	8	2	-	-		10

5.4.9 Zonimi i territorit

Tabela përmbledhëse e veçorive të zonës –KK Rahovec

Kategoria	Numri
Numri i banorëve	56208
Numri i ekonomive familjare	8676
Sipërfaqja në km ²	276
Gjenerimi i mbeturinave (e perlogaritur)	10611

Mbulimi me shërbime të MM	Numri	Në %
Mbulimi me shërbime të MM (ekonomi familjare)	8143	93.9%
Mos mbulimi me shërbime të MM (ekonomi familjare)	533	6.1%

Kategoria -Zonimi	Zona 1	Zona 2	Total
Numri i Lokalitetit	14	22	36
Mesatarja në km	7.90	15.64	24
Sipërfaqja në km ²	144	132	276
Numri i ekonomive lokale	6282	2394	8676
Nr. e ekon. fam. /ofrohen sher. MM	6282	1861	8143
Shkalla e mbulimit me sherb. MM	100%	77.7%	93.9%
Numri i Popullates	34658	21550	56208
Numri i popullates në %	61.7%	38.3%	100%
Gjen. mbetu. në vit	7099	3512	10611
Gjen. mbetu. në vit në %	66.9%	33.1%	100%

Kategoria	Popullata	%	Sip. km ²	%	Mbeturinat	%
Urbane	15892	28.3%	49	17.8%	3596	33.9%
Para Urbane	4205	7.5%	39	14.0%	952	9.0%
Rurale	21670	38.6%	102	37.0%	3955	37.3%
Rurale e Thellë	14441	25.7%	86	31.2%	2108	19.9%
Totali	56208	100%	276	100%	10611	100%

Zona	Nr. lokalit	Mesa. km	Sip. km ²	Nr.ekon. Fam.	Nr. i popullatës	Gjen. i mbet. në vit
Urbane	14	7.90	144	6282	34658	7099
Para Urbane	22	15.64	132	2394	21550	3512
Totali	36		276	8676	56208	10611

5.4.10 Zonimi i KK Rahovec i bazuar në kriteret për vlerësimin e zonës në sektorin e menaxhimit të mbetjeve

**Zonat e përcaktuara për Menaxhimin e Mbeturinave –KK
Rahovec**

Zona 1	Zona 2	Total
Nr.Lokalitetet 14 38.9%	Nr.Lokalitetet 22 61.1%	Nr.Lokalitetet 36 100.0%
Popullata 34,658 61.7%	Popullata 21,550 38.3%	Popullata 56,208 100.0%
Sipërfaqja km² 144 52.2%	Sipërfaqja km² 132 47.8%	Sipërfaqja km² 276 100.0%
Ekon.Familjare 6,282 72.4%	Ekon.Familjare 2,394 27.6%	Ekon.Familjare 8,676 100.0%
Ofrohen sher.MM- Ekon.Familjare 6,282 77.1%	Ofrohen sher.MM- Ekon.Familjare 1,861 22.9%	Ofrohen sher.MM- Ekon.Familjare 8,143 100.0%
Mbulimit me Sher.MM 100.0%	Mbulimit me Sher.MM 77.7%	Mbulimit me Sher.MM 93.9%

Zonat përcaktuar e MM e bazuar ne km²

Kategoria	Zona 1	Zona 2	Total	Ne %
Urbane	49	-	49	17.8%
Para Urbane	31	8	39	14.0%
Rurale	55	47	102	37.0%
Rurale e Thell	10	76	86	31.2%
Total	144	132	276	100.0%
Ne %	52.2%	47.8%	100.0%	

Zonat përcaktuar e MM e bazuar gjenerimin e përllogaritur te mbeturinave

Kategoria	Zona 1	Zona 2	Total	Ne %
Urbane	3,596	-	3,596	33.9%
Para Urbane	592	359	952	9.0%
Rurale	2,764	1,191	3,955	37.3%
Rurale e Thell	147	1,962	2,108	19.9%
Total	7,099	3,512	10,611	100.0%
Ne %	66.9%	33.1%	100.0%	

5.4.11 Shpërndarja e ekonomive familjare e bazuar ne zonat e përcaktuara dhe kompanitë ofruese te shërbimeve te MM

Opertori	Zona 1	Zona 2	Total	Ne %
Ekodrinia	540	1,861	2,401	29.5%
NJP "Ambienti	5,742	-	5,742	70.5%
Total	6,282	1,861	8,143	100.0%

Zona 1- e bazuar ne kriteret e përcaktuara te zoonimit

Nr.	Zona	Rurale Urban	Zona	Distanca KM	Rangu Km.	Nr. Banoreve	Nr. i ekono. fam. në komunë	Gjenerimi I MM
1	Rahovec	Urbane	Zona 1	1.0	0-3	15,892	3,072	3,596
2	Krushë e Madhe	Rurale	Zona 1	10.0	9-12	4,473	779	816
3	Xërxë	Rurale	Zona 1	9.3	9-12	3,184	288	581
4	Bellacrkë	Rurale	Zona 1	7.0	6-9	2,270	252	414
5	Opterushë	Rurale	Zona 1	8.1	6-9	1,911	332	349
6	Celinë	Rurale	Zona 1	11.8	9-12	1,903	357	347
7	Brestovc	Para Urbane	Zona 1	4.3	3-6	1,288	265	291
8	Hoçë e Vogël	Para Urbane	Zona 1	5.5	3-6	1,166	224	264
9	Retijë	Rurale e Thell	Zona 1	12.9	12-40	771	124	113
10	Nagavc	Rurale	Zona 1	7.5	6-9	743	158	136
11	Zoçishtë	Rurale	Zona 1	7.1	6-9	659	165	120
12	Reti e Ulët	Rurale e Thell	Zona 1	16.4	12-40	234	124	34
13	Hoçë e Madhe	Para Urbane	Zona 1	4.8	3-6	124	60	28
14	Bërnjak	Para Urbane	Zona 1	4.9	3-6	40	-	9
Total						34,658	6,200	7,099


Zona 2- e bazuar ne kriteret e përcaktuara te zoonimit

Nr.	Zona	Rurale Urban	Zona	Distanca KM	Rangu Km.	Nr. Banoreve	Numri i ekono. familjare në komunë	Gjenerimi I MM
1	Drenoc	Para Urbane	Zona 2	5.7	3-6	1,587	161	359
2	Pataçan i Ulët	Rurale	Zona 2	11.0	9-12	1,077	103	197
3	Pastasellë	Rurale	Zona 2	9.2	9-12	1,011	83	185
4	Sapniq	Rurale	Zona 2	9.7	9-12	996	90	182
5	Polluzhë	Rurale	Zona 2	11.2	9-12	808	162	147
6	Senoc	Rurale	Zona 2	7.2	6-9	687	101	125
7	Gexhë	Rurale	Zona 2	11.6	9-12	660	165	120
8	Zatriq	Rurale	Zona 2	10.3	9-12	535	42	98
9	Pataçan i Epërm	Rurale	Zona 2	6.2	6-9	533	52	97
10	Nushpal	Rurale	Zona 2	7.0	6-9	220	32	40
11	Ratkoc	Rurale e Thell	Zona 2	17.0	12-40	3,791	380	553
12	Radostë	Rurale e Thell	Zona 2	12.3	12-40	2,346	206	343
13	Dejnë + Baboc	Rurale e Thell	Zona 2	19.0	12-40	1,757	116	257
14	Çifllak	Rurale e Thell	Zona 2	23.0	12-40	1,292	104	189
15	Kramovik	Rurale e Thell	Zona 2	25.5	12-40	1,125	93	164

16	Vrajakë	Rurale e Thell	Zona 2	20.0	12-40	838	72	122
17	Dabidol	Rurale e Thell	Zona 2	20.9	12-40	799	138	117
18	Petkoviq	Rurale e Thell	Zona 2	28.3	12-40	731	183	107
19	Bratotin	Rurale e Thell	Zona 2	20.7	12-40	396	58	58
20	Mrasor	Rurale e Thell	Zona 2	32.0	12-40	191	28	28
21	Kaznik	Rurale e Thell	Zona 2	13.0	12-40	164	24	24
22	Sarosh	Rurale e Thell	Zona 2	23.3	12-40	6	2	1
Total				15.6		21,550	2,394	3,512

Zonat te bazuara ne kriteret e përcaktuara te zonimit

Zona	Nr. Banoreve	Numri i ekono. familjare në komunë	Gjenerimi I MM
Zona 1	34,658	6,282	7,099
Zona2	21,550	2,394	3,512
Total	56,208	8,676	10,611



Harta 12_Numri i ekonomive familjare

6 INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI²¹

6.1 Shtrirja dhe gjendja e rrugëve ekzistuese

Komuna e Rahovecit shtrihet ne mesin rrugëve magjistrale Gjakove – Prishtine dhe Gjakove – Prizren, si dhe atyre rajonale Malisheve – Gjakove, dhe Rahovec – Suhareke.

Territori i komunës është relativisht i madh i cili ka një rrjet rrugorë prej 297 km rruge te te gjitha kategorive. Rrugët magjistrale dhe rajonale janë te asfaltuara dhe ne gjendje te mire ka edhe prej atyre brenda qytetit qe janë pa asfaltuara.

Gjendja e trafiku është relativisht ne nivel te kënaqshëm ne rrugët periferike te komunës ndërsa sa i përket atyre brenda qytetit ka pak vështirësi ne zhvillimin normal te qarkullimit te mjeteve, kjo behet edhe me vështire kur kemi parasysh praninë e madhe te moto kultivatorëve. Konfiguracioni i terrenit është kodrinore ku karakterizohet me dendësi shumë te madhe vendbanimeve në disa lagje të qytetit, si rezultat i kësaj i kemi edhe rrugët shumë te ngushta te cilat përdoren nga te gjithë pjesëmarrësit ne trafik.

Shumica e këtyre rrugëve janë te asfaltuara mirëpo nuk kane trotuare për lëvizjen e këmbësoreve. Për nga aspekti i mobilitetit rrugët ne këto lagje mund te cilësohen si te rrezikshme duke mos i ofruar siguri te mjaftueshme te gjithë pjesëmarrësve në trafik.

Komuna përveç trafikut rrugore ka edhe atë hekurudhore e cila e lidhe Prizrenin – Fushe Kosovën, mirëpo aktualisht kjo linje është jashtë funksionit.

Në komunën e Rahovecit ekziston niveli i katër kategorive të rrugëve (të klasifikuara në Kosovë), duke filluar prej rrugëve magjistrale e deri tek ato të pa kategorizuara.


Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovecit përbehet nga:

- Rrugët magjistrale – M9.1 (Gjakovë - Prishtinë)
- Rrugë regjionale - (R107 Prizren-Gjakovë, R117 Rahovec-Suharekë, R111 Xerxë
- Ratkoc-Kramovik, R204 Rahovec- Krushë e Madhe, R110 Malishevë- Rahovec – Xerxë
- Rrugë lokale (rrugët të cilat i lidhin 34 komuna kadastrale me gjithsej 36 vendbanime, duke përfshire edhe rrugët që lidhin lagjet më të rëndësishme të vendbanimeve)
- Rrugë të pa kategorizuara (të cilat lidhin lagjet e fshatit si dhe i lidhin të gjitha hapësirat në të cilat zhvillohen aktivitete socio-ekonomike).

Tabela 21. Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovecit

Nr.	Përshkrimi	Gjatësia në km	%
01	Rrugë magjistrale	6.51	1%
02	Rruge regjionale	64.37	20%
03	Rruge urbane	67.37	12%
04	Rruge lokale	109.47	19%
05	Rruge të pa kategorizuara	315.24	56%
TOTALI		562.96	100%

²¹ Plani I mobiliteti Urban per komunën e Rahovecit 2016-2020



Grafiku 20. gjatësia e rrugëve në km sipas kategorive në komunën e Rahovecit

Nga totali i përgjithshëm i rrugëve 562.96 km, sa janë në komunën e Rahovecit sipas gjatësisë, rrugë magjistrale janë 6.51 km (1.0%), Rrugë regjionale 64.37 km (20.0%), Rrugë lokale 109.47 km (19.0%), Rrugë urbane 67.37 km (12.0%) dhe Rrugë të pa kategorizuara janë gjithsej 315.24 km (56.0%).

6.1.1 Rrugë magjistrale M9.1

Nëpër territorin e komunës së Rahovecit kalon rruga e rëndësishme në nivel nacional e cila i lidhë Prishtinën-Gjakovën dhe me Shqipërinë e Veriut (Nëpërmjet qafës së Morinës) e cila cilësohet si rrugë magjistrale. Kjo rrugë në komunën e Rahovecit ka një gjatësi prej 4.5 km, si dhe kalon në dy komuna kadastrale.

Komunat kadastrale (vendbanimet) në të cilat kalon rruga magjistrale M9.1 janë: Kramovik, Mrasor.

Pozita e mirë gjeografike i ka mundësuar kësaj komune lidhje shumë të mira të komunikacionit rrugor dhe hekurudhorë. Gjithashtu e karakterizon atë me komunikacion mjaft të dendur, si në transportin e mallrave po ashtu edhe atë të udhëtarëve.

Rruga magjistrale e cila shtrihet në territorin e komunës është e asfaltuara dhe menaxhohet nga MTPT. Sipërfaqja e tokës e cila shfrytëzohet nga aktivitetet e rrugës magjistrale janë gjithsej 4.5 ha. Gjendja e rrugës magjistrale në komunën e Rahovecit, në përgjithësi është e mirë.

Karakteristikë e kësaj rrugë është shtrirja e urave (mbikalime) në raport me hekurudhën dhe me rrugë që e lidh Gjakovën me Klinën.

6.1.2 Rrugë regjionale

Rrugët e kësaj kategorie i mundësojnë komunës së Rahovecit lidhje shumë të mira në nivel regional dhe kanë shtrirje në pesë drejtime me gjatësi prej 64.37 km. Gjithashtu këto rrugë janë të asfaltuara dhe menaxhohen nga MTPT:

- Rruga R-107 , Prizren-Xërxë- Gjakovë – me një gjatësi prej 11 km
- Rruga R-110, Malishevë – Rahovec-Xërxë me një gjatësi prej 16.3 km
- Rruga R111 , Xërxë –Ratkoc-Kramovik me gjatësi prej 17 km
- Rruga R117 , Rahovec-Opterushë – deri në kufirin e KK të Suharekë me gjatësi prej 7.6 km
- Rruga R204, Rahovec – Krushë e Madhe me gjatësi prej 12.4 km

- Rruga regjionale R-107, Prizren-Xërxë- Gjakovë i mundëson komunës së Rahovecit lidhje të mirë me komunën e Prizrenit dhe te Gjakovës dhe rrugët regjionale R111 qe lidhet me komunën e Klinës. Kjo rrugë i lidhë vendbanimet mjaft të rëndësishme si (Krushë e Madhe, Celinë, kalon në komunën kadastrale të fshatit Bellacerkë dhe Xërxë). Kjo rrugë ka gjatësi 11 km në territorin e komunës së Rahovecit.
- Rruga regjionale R110, – krijon lidhje të mira në mes të komunë se Rahovecit dhe Malishevës dhe pastaj nëpërmjet kësaj rrugë lidhet edhe me Prishtinën (Rahovec- Malishevë – Prishtinë)– kalon në pjesën qendrore të komunës së Rahovecit e deri të kufiri komunal i Malishevës. Kjo rrugë ka gjatësi prej 16.3 km, dhe i prekë komunat kadastrave të: Xërxë, Bellacerkë, Bërnjak,dhe komunën kadastrale të qytetit të Rahovecit).
- Rruga regjionale R111, Xërxë –Ratkoc -Kramovik - shtrihet kryesisht në pjesën perëndimore të komunës me gjatësi prej 17 km. Nëpërmjet kësaj rruge komuna e Rahovecit ka qasje ne magjistralen Gjakovë- Prishtinë dhe me komunën e Klinës.

6.1.3 Rrugë urbane


Konsiderohen rrugët të cilat i lidhin lagjet e qytetit të Rahovecit, gjithsej rrugë urbane në qytetin e Rahovecit kemi 67.37 km ose 12.0% nga totali i përgjithshëm I rrugëve.

6.1.4 Rrugë lokale

Konsiderohen rrugët të cilat i lidhin të gjitha vendbanimet e komunës duke u nisur nga qendra e vendbanimit dhe rrugët e tjera të rëndësishme të cilat mundësojnë lidhje të mira me to. Gjithsejtë rrugë lokale në komunën e Rahovecit janë 109.47 km ose 19.0% nga totali i përgjithshëm i rrugëve.

6.1.5 Rrugë të pa kategorizuara

Konsiderohen të gjitha sipërfaqet të cilat shfrytëzohen për realizimin e aktiviteteve bujqësore, socio-ekonomike dhe të tjera si në brendësi të vendbanimeve, po ashtu edhe në sipërfaqet e tjera të komunave kadastrale. Gjithsej rrugë të kësaj kategorie në tërë territorin e komunës së Rahovecit janë 315.24 km ose 56 %, e totalit të rrugëve. Kjo kategori e rrugëve nuk është e asfaltuar, mirëpo rrugët të cilat shfrytëzohen për lidhjen hapësirave në brendësi të vendbanimeve, si dhe ato të cilat i lidhin vendbanimeve në thellësi të komunës, përkatësisht të viseve malore janë të shtruara me rërë dhe zhavorr. Ndërsa rrugët e tjera të kësaj kategorie janë rrugë të cilat shfrytëzohen për aktivitete bujqësore.



Harta 13_Rrjeti i rrugëve

6.2 Rrjeti hekurudhor

Rrjeti hekurudhor në komunën e Rahovecit është i karakterit regional dhe ka shtrirje në pjesën perëndimore të komunës së Rahovecit, përkatësisht i takon kategorisë së komunikacionit regional i cili i lidhë Prizren- kalon ne territorin e komunës së Rahovecit dhe e lidhë Klinen-Fushë Kosovë). Kjo linjë hekurudhore është një binarësh me gjatësi prej 10.4 km. Komunitat kadastrale të cilat preken nga rrjeti hekurudhorë, përkatësisht kanë qasje direkt ne këtë rrjet janë gjithsejtë 12, duke filluar nga (Mrasor,Kramovik, Çifllak, Dabidol,Dejnë, Ratkoc, Radostë, Gexhë, Xërxë, në komunën kadastralet të Bellacerkës,Celinë dhe Krushë e Madhe).

Duke u nisur nga ky fakt mund të konstatojmë se rrjeti hekurudhorë i cili është mjaft I hershem në këtë komunë është edhe si indikator për zhvillimin e vendbanimeve më të rëndësishme të komunës. Rrjeti hekurudhor është i një rëndësie të veçantë, jo vetëm për komunën e Rahovecit por edhe tjerat sepse ndihmon në transportimin e mallrave dhe udhëtarëve. Linja hekurudhore për momentin nuk është ne funksion dhe si rrjedhojë nuk ka qarkullim të udhëtarëve dhe mallrave përmes sajë.

6.3 Urat

Të gjitha urat, e identifikuar në tërë territorin e komunës së Rahovecit, i takojnë dy kategorive të komunikacionit:

- Komunikacionit rrugor, dhe
- Komunikacionit hekurudhor.

6.3.1 Urat në komunikacionin rrugor

Nga 16 ura të cilat janë të ndërtuara në rrjetin rrugor të komunës, 3 prej tyre shtrihen në rrugë magjistrale dhe 7 në rrugë regionale.

Urat e tjera shtrihen në rrugë lokale dhe ato të pa kategorizuara të cilat kanë gjatësi prej 5 deri 20 m. Në përgjithësi janë në gjendje t të mirë. Disa prej tyre kanë qene të demtuara gjate luftes se vitit 1999 mirepo, janë rindërtuar pas luftës.

6.3.1.1 Urat mbi magjistrat

Konfiguracioni i terrenit ka imponuar që në gjithsej 6.2 km rrugë magjistrale në komunën e Rahovecit të ndërtohen 3 ura mjaft të rëndësishme për komunikacionin e rrugës magjistrale (Kramovik 2 , Mrasor 1). Urat kryesore dhe më të rëndësishme mbi këtë kategori të rrugëve janë ato në fshatin Kramovik, njëra prej tyre mbi lumin Drin i Bardhë me gjatësi prej 131 m, e tjetra mbi hekurudhe me gjatësi 100 m.



Urat e tjera kryesisht konsiderohen të vogla me gjatësi prej 1 deri 10m, dhe shtrihen në rrugët lokale dhe të pa kategorizuara. Në përgjithësi janë në gjendje mesatarisht të mirë me përjashtim të disa urave të cilat karakterizohen me gjerësi të vogël dhe të pa mjaftueshme.

6.3.1.2 Urat mbi rrugë regjionale

Janë të vendosura në të dy drejtimet e rrugëve regjionale, 1 është e vendosur në rrugën regjionale Rahovec-Xërxë – Gjakovë (përkatësisht në komunën kadastrale të Xërxës me gjatësi prej 65 m, mbi lumin Drin i Bardhë (Ura e fshejtë) tjerat në komunën kadastrale të Ratkocit me 20 metra, dhe tjetra 15 m, dhe në komunën kadastrale të Qifllakut me gjatësi 18 metra në rrugën regjionale Xërxë-Ratkoc- Kramovik).

6.3.2 Urat në komunikacionin hekurudhor

Në rrjetin hekurudhor të komunës së Rahovecit janë të ndërtuara gjithsejtë 4 ura prej të cilave 1 në komunën kadastrale të Mrasorit, 1 në Çifllakë, 1 në Ratkoc, 1 në komunën kadastrale të Bellacerkës,

6.4 Tunelet

Karakteristikë e komunikacionit hekurudhor është tuneli në mes të vendbanimit Gexhë dhe Xërxë (tuneli në komunën kadastrale të Gexhës dhe të Xërxës me gjatësi prej 730 m të ndërtuara në rrjetin hekurudhor).

6.5 Siguria ne Trafik.

Siguria ne komunën e Rahovecit përkatësisht ne zonën urbane sipas konceptit te mobilitetit mund te llogaritet e nivelit të ulët. Kjo për faktin se ka një infrastrukturë rrugore adekuate për automjete ndërsa jo ne nivel te duhur për lëvizje te mjeteve te pa motorizuara si për këmbësore ashtu edhe për çiklistë. Zona urbane karakterizohet me mungese te trotuareve për këmbësore, për shkak se nuk ka pasur mundësi te ndërtimit te tyre. Ne këto lagje rrugët janë shume te ngushta ne shumicën prej tyre zhvillohet trafiku ne dy kahje dhe e bën shume te vështire edhe te rrezikshëm lëvizjen e këmbësoreve. Këto rruge shfrytëzohen shume sidomos nga nxënësit për te shkuar ne shkolle sepse lëvizja ne këmbë është e vemja mënyrë e lëvizjes për këto nevoja ditore, pasi qe transport urban nuk ka te organizuar brenda qytetit.

Problem tjetër i sigurisë ka te beje edhe me mos rregullimin adekuat te disa kryqezimeve sidomos atyre qe janë te lidhura me rrugët rajonale dhe magjistrale te cilat kalojnë neper komunën e Rahovecit. Edhe sipas raporteve policore mbi numrin e aksidenteve është një numër relativisht i madh, ku shumica e tyre ndodhin pikërisht ne këto kryqëzime me rrugët magjistrale dhe rajonale. Ne vazhdim do t'i japim disa nga pikat me te rrezikshme te cilat nuk i plotësojnë kriteret teknike gjeometrike për funksionimin e tyre..

Rrethrotullimi i hyrje te qytetit, rruga rajonale Xerxe – Malisheve.



Qëllimi i projektimit të rreth rrotullimeve është që në hyrje të udhëkryqit të t'i detyroje automjete që ta zvogëlojnë shpejtësinë në mënyrë që të rritet siguria, në këtë udhëkryq me këto parametra gjeometrik kjo gjë nuk ka ndodhur për faktin se mjetet që lëvizin në drejtimin Malisheve – Xërxë i mundësohet e drejta e kalimit krahasuar me ata të cilët është dashur të kenë të drejte përkatësisht mjetet që lëvizin në rreth rrotullim, dhe pikërisht është kjo edhe arsyeja se pse edhe ndodhin aksidente në këtë udhëkryq, gjithashtu edhe kycja nga qyteti nuk është projektuar si duhet sepse nuk ka dukshmëri të mjaftueshme. automjete që ta zvogëlojnë shpejtësinë në mënyrë që të rritet siguria, në këtë udhëkryq me këto parametra gjeometrik kjo gjë nuk ka ndodhur për faktin se mjetet që lëvizin në drejtimin

Malisheve – Xërxë i mundësohet e drejta e kalimit krahasuar me ata të cilët është dashur të kenë të drejte përkatësisht mjetet që lëvizin në rreth rrotullim, dhe pikërisht është kjo edhe arsyeja se pse edhe ndodhin aksidente në këtë udhëkryq, gjithashtu edhe kycja nga qyteti nuk është projektuar si duhet sepse nuk ka dukshmëri të mjaftueshme.

Kryqëzimi në rrugën magjistrale Prizren – Gjakovë, fshati Xërxë.



Ky është njeri ndër udhëkryqet më të rrezikshme në komunën e Rahovecit, sepse në këtë kryqëzim kemi edhe kalimin e hekurudhës. Dihet se një pjesë e madhe fshatit Xerxe shtrihet në pjesën e poshtme të këtij kryqëzimi ndërsa në afërsi të tij gjendet shkolla fillore, pikërisht në këto pika gjatë vitit shkollor behet edhe më e rrezikshme sepse kërkesa për të kaluar nga njëra anë në tjetrën është shumë e madhe

Kryqëzimi në rrugën magjistrale Prizren – Gjakovë, fshati Krushë e madhe.



Kryqezimi ne rrugen magjistrale Gjakove – Prishtine



Kryqezimi ne rrugen rajonale Rahovec – Krushe e Madhe



Disa rrugë të lagjeve që janë të rrezikshme për zhvillimin e komunikacionit të automjeteve dhe tekmbësoreve.



6.6 Shtrirja dhe kategoria e rrugëve të planifikuara nga niveli qendror

Aktualisht në qytetin e Rahovecit rruga kryesore e cila e përshkon qendrën e qytetit është e vetmja rrugë e cila i plotëson kriteret për qarkullimin e mjeteve të renda, me këtë

nënkuptohet se nuk ka ndonjë alternative tjetër për riorganizimin e qarkullimit në qytet. Lëvizja e mjeteve komerciale në qendër drejtpërsëdrejti ndikon edhe në sigurinë e këmbësoreve kur dihet se rruga në fjalë nuk ka trotuare adekuate, dhe pjesërisht të ndërprera, ku në këto raste lëvizja e këmbësoreve bëhet në shtresën qarkulluese si e përbashkët me të gjitha mjetet tjera.

Në planin zhvillimor dhe rregullativ është parapare që të ndërtohen rrugët transite ku ajo në pjesën veriore tashmë është e trasuar dhe është në ndërtim e sipër, e cila do të lidhje rrugët rajonale R204, R110 dhe R 117. Me këtë segment rrugorë do të mundësohet riorientimi i automjeteve komerciale, që ta shmangin qendrën e qytetit.



Aq më shumë do ta lehtësonte qarkullimin edhe ndërtimi i rrugës transite në pjesën jug-lindore të qytetit, me këtë do të ishte përmbyllur qarkorja e jashtme e qytetit e cila do 30 ta kishte mundësuar një qasje shumë më të shpejtë dhe më të lehtë në qytet. Një pjesë e kësaj rruge është ndërtuar dhe është në ndërtim e sipër krejt çka duhet janë investime për të lidhur këtë. Në fig. me ngjyrë të kuqe është shënuar traseja ekzistuese mirëpo disa parametra gjeometrikë nuk janë shumë të favorshëm për qarkullimin e mjeteve komerciale, andaj se bashku me grupin punues është menduar që të shqyrtohet mundësia e lidhjes së këtyre dy pikave me trase të re, e cila është e drejtë edhe shumë e favorshme për qarkullim.



6.7 Vlerësimi i intensitetit dhe kapacitetit të kryqëzimeve dhe korsive kryesore

Gjate analizës se gjendjes ekzistuese kemi arritur ne përfundim se kemi një numër të konsiderueshme të udhëkryqeve që mund t'i konsiderojmë me rrezikshmëri të lartë, kjo për faktin se ka ndodhur një numër i konsiderueshëm i aksidenteve. Këtu bëjnë pjesë disa kryqëzime me rrugë magjistrale siç janë në fshatin Xerxe, fshatin Krushe e madhe, rrethrotullimi në hyrje të qytetit. Te gjitha këto pika duhet të ri projektohen apo tevendosen masa dhe mënyra të tjera të qarkullimit.





Te gjitha kryqëzimet e lartpërmendura, por edhe ne disa tjera kane nevojë për një analize gjeometrike, dhe funksionale me qëllim të rritjes së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit.

6.8 Modelet e qarkullimit të trafikut

6.8.1 Ri-orientimi i qarkullimit në qytet

Me ndërtimin e këtyre rrugëve transite mundësohet edhe rregullimi apo riorientimi i brendshëm i rrugëve, aktualisht kërkesa për lëvizje nuk është shumë e madhe dhe kapaciteti i rrugëve është në nivel të kënaqshëm, mirëpo për një periudhë afatmesme kërkesa për lëvizje mund të rritet, ndërsa është e pamundur zgjerimi i rrjetit rrugor në qendër të qytetit. Për nga aspekti i sigurisë së këmbësorëve Rahoveci karakterizohet me rrugë shumë të ngushta dhe mungesë të trotuareve, pikërisht për këtë arsye është menduar që të bëhet orientimi i qarkullimit në rrugë njëkahore që të krijohet një hapësirë për lëvizje të sigurte të këmbësorëve.

Me poshtë në fig janë prezantuar disa skenar të mundshëm për orientimin e qarkullimit njëkahore në qytet.



DRAFT



6.9 Linja transportuese ndërkomunale brenda komunes , urbane dhe rurale

6.9.1 Transporti kolektiv (publiko - privat)

Trafiku urban në komunën e Rahovecit përkatësisht në zonën urbane për tash nuk ekziston. Ka të organizuar trafikun urbano – periferik dhe atë ndër urban. Të gjitha itineraret janë të caktuara nga disa rregullore të nxjerra nga kuvendi komunal mirëpo këto janë shumë të vjetra sepse janë nxjerrë në vitin 2001 dhe janë të bazuara në ligjin e vjetër të transportit. Kjo mund të cilësohet edhe një e metë dhe duhet të rishikohet kjo rregullore me qëllim që të përshtatet me ligjin e ri që është në fuqi.

Transporti urbano – periferik organizohet me autobus nga kompani private, ku gjendja e mjeteve ne disa raste nuk është ne nivelin e duhur, linjat kryesisht shfrytëzohen për transportin e nxënësve.

Ndërsa sa i përket linjave ndërurbane ka një qasje te mire dhe shpeshtësia e tyre është ne nivelin e duhur. Komuna ka stacion te autobusëve që me rregullore është parapare qe te gjitha linjat duhet te nisen dhe te përfundojnë ne këtë stacion. Mirëpo një shqetësim tjetër është se operatorët e autobusëve nuk e respektojnë dhe ndalen edhe ne pjesët tjera te qytetit, si për zbritjen e udhëtareve ashtu edhe për marrjen e tyre. Kjo ndodh sidomos ne zonat atraktive ne qendër apo ne afërsi te shkollave. Aktualisht nuk ka vendnadle te shënuar për autobusë brenda qytetit, mirëpo ne vijime duhet qe ta analizojmë nëse është e nevojshme qe te vendosen dhe te krijohet një infrastrukturë adekuate.

6.10 Shfrytëzimi I rrugëve nga makinat, këmbësorët, bicikletat dhe metodat tjera të transportit

6.10.1 Trafiku për këmbësorë

Shtigjet e këmbësorëve janë pothuajse pjesa me rëndësishme e infrastrukturës sidomos për zonat urbane, kur dihet qe shumica e lëvizjeve ditore behet ne këmbë, mirëpo pa l anashkaluar edhe nevojën për rrugët qe i lidhin fshatrat. Ne komunën e Rahovecit nuk është gjendja e mire me trotuare, apo thëne me mire lëvizja ne këmbë nuk është e sigurt ne këtë qytetet. Qyteti ka një terren kodrinor me dendësi shume te madhe te vendbanimeve qe karakterizohen me rruge te ngushta te cilat janë te asfaltuara ne tërësi, ndërsa nuk ka fare trotuare për lëvizjen e këmbësoreve. Sidomos gjate periudhe se dimrit kemi një gjendje shume te rrezikshme për lëvizje te këmbësoreve duke pasur parasysh edhe pjerrtësitë ne këto rruge.

Ne përgjithësi përveç disa rrugëve kryesore ne qendrën e qytetit qe kane trotuare, shumica e lagjeve tjera nuk kane fare. Këtu duhet te përmendim edhe rrugën qe qon ne drejtimin e shkollës se mesme “Xhelal Hajda” rruge e cila është shume e frekuentuar nga nxënësit nuk ka një infrastrukturë adekuate për lëvizje te këmbësoreve. Ne përgjithësi munde te themi se gjendja me trotuare nuk është ne nivelin e duhur si për nga mungesa ashtu edhe mirëmbajtja e duhur.

6.10.2 Trafiku per cikliste

Në qytetin e Rahovecit mungojnë shtigjet për çiklistë deri më tani, duke e marre parasysh gjendjen terrenit dhe hapësirat ne dispozicion për krijimin e shtigjeve është shume e vështire që të krijohen. Në të ardhmen nëse qyteti vazhdon te rritet ne pjesën e rrafshët është mire që të parashihen, dhe të inkorporohet edhe kjo forme e transportit.

6.10.3 Lëvizja e personave me nevoja të veçanta

Komuna e Rahovecit përkatësisht zona urbane nuk ka një infrastrukturë adekuate e cila do te ia mundësonte njerëzve me nevoja te veçanta një qasje te lehte dhe një lëvizje te lire.

Rrugët janë shume te ngushta ne disa pjese te qytetit dhe e kane te pamundur te krijohen hapësira për lëvizje te lire te kësaj kategorie. Mirëpo edhe pjesët e qytetit ku ka trotuare nuk l plotësojnë kriteret, përkatësisht nuk l kane pjerrinat e dhura për tu qasur me lehte ne to.

6.11 Vlerësimi i hapësirave ekzistuese për parkim²²

Qyteti i Rahovecit ka shume pak hapësira publike apo private te cilat mund te shfrytëzohen për parkingje. Ne zonën qendër nuk ka hapësira as mundësi për krijimin e parkingjeve, kjo njëherit është edhe një shqetësim sepse është një hapësire shume e vogël tek rrethrotullimi ne qendër te cilin qytetaret e shfrytëzojnë për parking, i cili e pengon rrjedhën e qarkullimit. Ekzistojnë edhe disa parkingje ne pjesën e poshtme te qytetit afër tregut i cili mund te shfrytëzohet mirëpo, përveç ditëve te tregut shume pak shfrytëzohet nëditët tjera.



6.12 Vlerësimin e nevojave në të ardhmen për një infrastrukturë transportuese²³

6.12.1 Sinjalizimi horizontal dhe vertikal si nevojë në të ardhmen

Te gjitha mangësitë e përmendura me larte për nga aspekti i sigurisë janë lidhura drejtpërsëdrejti edhe me mungesën e sinjalizimit adekuat, niveli i sinjalizimit si atij horizontal

²² Plani I mobiliteti Urban per komunën e Rahovecit 2016-2020

²³ Plani I mobiliteti Urban per komunën e Rahovecit 2016-2020

po ashtu është atij vertikal nuk është ne nivelin e duhur, e behet edhe me i rënde kur dihet se ne vitet e fundit nuk ka pasur kompani te kontraktuar për mirëmbajtjen e tije.

Ne zonën urbane kemi sinjalizim adekuat sidomos ne pjese e qytetit ku janë ndërtuar rrugët e reja, ndërsa ne ato rurale nuk ka fare. Ne zonat rurale ka vetëm disa shenja vertikale STOP, te cilat janë vendosur ne kryqëzime me rrugët kryesore, kurse sinjalizim horizontal nuk ka fare, është bere vetëm njëherë kur është nderuar rruga pastaj nuk është mirëmbajtur fare, apo nuk është përsëritur më.

6.13 Vlerësimi financiar dhe teknik të Komunës për të realizuar infrastrukturën e nevojshme të transportit²⁴

Kapitulli financiar ka të bëjë me analizën e kapaciteteve buxhetore te komunës për periudhën kohore 2016-2020. Ne bazë të të dhënave zyrtare komunale siç është Buxheti Vjetor I Komunës dhe Kornizës Afatmesme te Shpenzimeve 2016-2018, si dhe trendëve relevante ekonomike-financiare. Në vijim janë paraqitur përlogaritjet afat-mesme te trendeve te sipërpërmendura te cilat mund te kenë ndikim ne investimeve të planifikuara dhe mirëmbajtës se nevojshme ne fushën e mobilitetit komunal per periudhën 2016 – 2020.

Për më shumë, projektet e identifikuar në fushën e mobilitet reflektojnë prioritetet e komunës për te njëjtën periudhën (2016-2020), dhe se duke marra parasysh kapacitetin buxhetor të komunës, si dhe trendët ekonomike, mbështetjen me grante nga buxheti qendror, dhe të hyrat vetanake të komunës. Gjithashtu, si burim shtesë financimi janë identifikuar edhe segmenti I donatoreve, si mundësia e bashkë-financimit të projekteve të identifikuar

6.13.1 Struktura e Buxhetit Komunal

Siç u potencua më sipër Buxheti i Komunës së Rahovecit për bazë ka Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH 2015-2018), ndërsa zbërthimi i shpenzimeve është si vijon


Tabela 1:Struktura Buxhetore e Komunës (2016-2018)

Viti	Buxheti komunal	Granti Qeveritar	Te hyrat vetanake	Invertimet Kapitale
2015	11,438,701	10,339,687	1,099,014	3,730,710
2016	11,384,997	10,226,983	1,158,014	3,408,652
2017	11,511,131	10,304,117	1,207,014	3,534,785
2018	11,651,400	10,395,900	1,255,500	3,675,054

Nga grafiku mund te shihet një s’përputhje seriozë ne mes te ardhurave komunale te cilat tregojnë ne vashëri te madhe te buxhetit komunal ne periudhën afatmesme.


Grafiku 1: Struktura e te ardhurave komunale

²⁴ Plani I mobiliteti Urban per komunën e Rahovecit 2016-2020



Nëse behet një krahasim me mes te hyrave vetanake te komunës dhe grantave qeveritare, nga grafiku 2 shihet qarte se grantet qeveritare përbejnë pjesën dërmuese te buxheti me shume se 85% te ardhurave te buxhetit te komunës se Rahovecit.

Grafiku 2: Struktura e te ardhurave komunale




Me qëllim që të shihet më mirë struktura e shpenzimeve komunale, është me rëndësi të veçohen investimet komunale, ku një pjesë të rëndësishme e përbejnë investimet kapitale. Planifikimet e komunës për investime kapitale për vitet 2016- 2018 janë si më poshtë:

Tabela 2: Investimet Kapitale (2016-2018)

Viti	Buxheti Komunal	Investime kapitale
2015	11,438,701	3,730,710
2016	11,384,997	3,408,652
2017	11,511,131	3,534,785
2018	11,651,400	3,675,054


Nëse u referohemi KASH se hartuar nga Komuna e Rahovecit, investimet kapitale planifikohen të shënojnë rritje lehtë, edhe pse deri në 2018 nuk planifikohet mbërrin nivelin e periudhës 2015, kur ato ishin në nivelin më të lartë për komunën.

Grafiku 3: Investimet e planifikuara kapitale



Kur bëhet fjalë për të Hyrat Vetanake, po ashtu KASH e Komunës tregon për një rritje simbolike e cila nuk është ndonjë lëvizje serioze sa i përket financimit të pavarur nga ana e komunës në periudhën 2016- 2018, siç mund shihet edhe nga tabela dhe grafiku i më poshtë.

Grafiku 4: Trendi i të hyrave vetanake



7 INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

7.1 Gjendja ekzistuese e infrastruktures publike dhe sociale

Në Komunën e Rahovecit funksionon Qendra për Punë Sociale (QPS), si institucion profesional i Komunës, e cila përbëhet nga personeli profesional me kualifikim përkatës si nëpunës të shërbimeve sociale, QPS është përgjegjëse për ushtrimin e kompetencave ligjore për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në emër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Në kuadër të QPS-së vepron organi i kujdestarisë që kryen detyrat që kërkojnë nga dispozitat ligjore të aplikueshme. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kryen shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të Komunës përmes aktiviteteve të Qendrës për Punë Sociale.

QPS ka hartuar planin strategjik të zhvillimit të shërbimeve sociale në Komunën e Rahovecit 2016-2019. Në këtë plan janë përcaktuar objektivat kryesor: 1. Fëmijët me aftësi të kufizuara, 2. Personat me sëmundje mendore, 3. Personat të moshuar dhe pa përkujdesje familjare, 4. Avancimi i strehimit familjar dhe 5. Ngritja e resurseve dhe kushteve të punës për ofrimin e shërbimeve sociale në QPS.

Për më tepër, si më poshtë:

7.2 Hyrje

Plani strategjik i Qendrës për Punë Sociale për shërbimet sociale për periudhën 2016 -2019 është plani i parë i hartuar nga QPS-ja krahas Planit Strategjik të DSHMS-së në Komunën e Rahovecit. Ky plan strategjik është në harmoni me Planin nacional për shërbimet sociale. Përkushtimi për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve sociale sipas standardeve minimale të përcaktuara nga MPMS, ka ndikuar që QPS-ja në bashkëpunim me DSHMS-në të merr veprime konkrete për hartimin e këtij plani strategjik për shërbime sociale.

Fushëveprimi i hartimit dhe zbatimit të strategjisë komunale për shërbime sociale është decentralizimi financiar dhe administrativ i shërbimeve sociale që ka qëllim që përmes sistemeve të përforcuara të menaxhimit dhe aftësive të përmirësuara të komunave dhe QPS-ve të ofrojnë shërbime kualitative sociale. Pikësynimi dhe vizioni ynë është që të identifikohen rreziqet të cilat e karakterizojnë Komunën tonë dhe të ofrohen shërbime sociale për ato grupe të cënueshme në afat të përcaktuar në strategjinë komunale.

QPS në bazë të punës dhe praktikës së krijuar, në bashkëpunim me DSHMS-në përveç programit të punës ka konsultuar edhe ofruesit e shërbimeve sociale jo qeveritare në Komunë në mënyrë që të identifikojë zbrazëirat dhe pikat kryesore të nevojës së përmirësimit dhe avancimit të shërbimeve sociale për fëmijë, të rritur dhe familjet në Komunën e Rahovecit. Përveç kësaj, ajo gjatë punës së saj është konsultuar edhe me akterët kryesorë të cilët luajnë rol të rëndësishëm e të cilët kanë kontakt të përhershëm me qytetarët e Komunës sonë. Ky plan strategjik është bazuar në të dhëna konkrete që i posedojnë shërbimet e ndryshme të Komunës se dhe në punën e përditshme që kryen stafi profesional i QPS-së.

7.3 Historiku i Qendrës për Punë Sociale në Rahovec

Komuna e Rahovecit numëron mbi 70.000 banorë, si qendër administrative dhe urbane me 33 fshatra.

Qendra për Punë Sociale në Rahovec është themeluar me 03 maj të vitit 1979, me Vendimin e Kuvendit të Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit për mbrojtjen Sociale dhe të fëmijëve të Komunës së Rahovecit.

Në fillim Qendra ka pasur tre punëtorë, njeri prej të cilëve i kryente punët e ushtruesit të detyrës së drejtorit deri në regjistrimin e Qendrës në Gjykatën Ekonomike në Gjakovë. Në muajin shtator të vitit 1979 Qendra për Punë Sociale pas marrjes të Aktvendimit nga Gjykata Ekonomike në Gjakovë punon me kompetencë të plotë me gjithsej gjashtë punëtorë; drejtori, tre punëtor social, një punëtor administrativ dhe një punëtor financiar.


Veprimtaria e Qendrës për Punë Sociale është mbështetur në Ligjet atëhershme në fuqi, si që ishin Ligji i mbrojtjes sociale i qytetarëve të Kosovës, Ligji mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare, Ligji mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe aktet normative tjera në nivel komunal që ndërlidhen me Ligjet e cekur më lartë.

Qendra për Punë Sociale financohej në bazë të Planit dhe Programit të punës i cili aprovohej nga Kuvendi i Bashkësisë vetëqeverisëse të interesit çdo vit kalendarik, kjo zgjati deri në vitin 1989 ku kompetencat e monitorimit dhe financimit kaluan në Ministrinë e Mirëqenies Sociale në Beograd deri në fund të Luftës në Kosovë. Në periudhën e pas luftës, në vitin 1999, kur filloi edhe kthimi masiv i popullatës të përndjekur si dhe qytetarët që kishin mbijetuar luftën, punëtorët që kishin punuar para lufte u paraqiten në Këshillin Komunal dhe u aktivizuan në aktivitete të ndryshme të shërbimeve sociale me përkrahjen e Qeverisë të Përkohshme dhe UNMIK-ut.

Aktiviteti i punëtorëve mbështetej në sanimin e gjendjes të pasojave të luftës, ndihma qytetarëve në sigurimin e ushqimit dhe veshmbathjes përmes OJQ-ve të ndryshme që funksionin, përmes Kryqit të Kuq, si dhe në ndërtimin e vendbanimeve të shkatërruara dhe të djegura gjatë luftës. Në vitin 2000 me themelimin e Departamentit Administrativ të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në nivel qendror në Prishtinë, menaxhimi i Qendrës bëhet nga Departamenti në fjalë, ku pas sistematizimit të vendeve të punës me konkurs të rregullt bëhet pranimi i punëtorëve.

Me 2 maj të vitit 2000 në Qendër punonin gjithsej 12 punëtorë. Në vitin 2001 në bazë të Vendimit të DMS-së bëhet ristrukturimi në QPS, kështu që tani Qendra i ka tri Shërbime si vijon: Shërbimin Social, Shërbimin e Asistencës Sociale dhe Shërbimin administrativo-financiar.

7.4 Struktura Organizative e QPS-së



7.5 Qëllimi i Planit Strategjik për Shërbime Sociale

- Zbutja e varfërisë duke ofruar shërbime të avancuara personat dhe familjet në nevojë sociale dhe posaçërisht grupet e cënueshme;
- Zhvillimi i standardeve dhe formave alternative/inovative për ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes sociale dhe promovimin e përfshirjes sociale;
- Përmirësimi i kushteve të jetesës për personat të rritur dhe për fëmijë me nevoja të veçanta;
- Përmes zhvillimit dhe avancimit të strehimit familjar krijimi i kushteve të mira për fëmijët pa përkujdesje prindërore;
- Ngritja dhe avancimi i kapaciteteve njerëzore të ofruesve publik dhe ofruesve të licencuar jo-qeveritar të shërbimeve sociale dhe familjare.

7.6 Vizioni dhe Misioni

8.1 Misioni i Qendrës për Punë Sociale është ushtrimi i përgjegjësisë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i mbrojtjes dhe përkujdesjes sociale, andaj misioni ynë është përfshirja e secilit qytetar të Komunës së Rahovecit në secilën kategori sociale për një jetë sociale dhe ekonomike të dinjitetshme dhe ku të gjithë qytetarët në gjendje të nevojës sociale do të pranojnë shërbime të nevojshme duke zbatuar legjislacionin primar dhe sekondar për fushën e shërbimeve sociale.

8.2 Vizioni ynë është zhvillimi, zbatimi politikave sociale, ligjeve dhe standardeve minimale të përcaktuara nga MPMS për ofrimin e shërbimeve sociale. Duke siguruar mbrojtje dhe përfshirje sociale të çdo kategorie të qytetarëve, ku përparësi do të kenë grupet e cënueshme të shoqërisë në Komunën tonë.

7.7 Objektivat kryesor të Planit Strategjik

Për të arritur vizionin e përcaktuar më lartë, në këtë plan strategjik janë përcaktuar pesë (5) objektiva strategjike. Këto objektiva adresojnë nevojat për ndryshim dhe përmirësim të jetës së qytetarit të Komunës së Rahovecit. Këto objektiva strategjike mbulojnë segmente të rëndësishme, dhe përfshijnë:

- Fëmijët me aftësi të kufizuar.
- Personat me sëmundje mendore.
- Personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare.
- Avancimi i strehimit familjar.
- Ngritja e resurseve dhe i kushteve të punës.

7.8 Objektivat Strategjik:

OS 1. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve sociale dhe shëndetësore për fëmijët me aftësi të kufizuar.

OS 2. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve sociale dhe shëndetësore për personat me sëmundje mendore.

OS 3. Ofrimi i shërbimeve ditore dhe në familje për personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare.

OS 4. Zhvillimi i avancimit i strehimit familjar si formë alternative e mbrojtjes së fëmijëve pa përkujdesje prindërore.

OS 5. Ngritja e resurseve teknologjike dhe profesionale dhe përmirësimi i kushteve të punës për ofruesit publik dhe jo qeveritar të shërbimeve sociale.

1.3 Objektivat specifik:

1.3.1 Fëmijët me Aftësi të kufizuar

1. Përmirësimi i kushteve të jetës cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara.
2. Bashkëpunimi me organizatat jo qeveritare me qëllim të përfshirjes dhe integritit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shoqëri.
3. Ngritja e një qendre ditore të kujdesit që do të ofrojë shërbime me cilësi të lartë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

1.3.2 Personat me sëmundje mendore

1. Përmirësimi i kushteve të jetës për personat e rritur të diagnostifikuar me sëmundje mendore përmes ofrimit të shërbimeve kualitative sociale dhe shëndetësore.
2. Bashkëpunimi i Komunës me Qendrën e Shëndetit Mendor regjional për zgjidhjen e problemit të trajtimit adekuat me qëllim të largimit nga rrugët dhe ofrimin e shërbimeve adekuate për personat me sëmundje mendore.
3. Ngritja e qendrës ditore si degë e QSHM-së regjionale në Komunën e Rahovecit.

1.3.3 Personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare.

1. Identifikimi dhe vërtetimi i gjendjes të personave të moshuar dhe ata pa përkujdesje familjare si kategori e cënueshme në shoqëri.
2. Zhvillimi i programeve të mbrojtjes sociale me propozime konkrete për përfshirjen e këtij grupi në objektivat strategjik të QPS-së.
3. Krijimi i kushteve për ngritjen e qendrës ditore për personat e moshuar me qëllim të integritit dhe lehtësimit të kushteve për jetë më të mirë.

1.3.4 Avancimi dhe përhapja e strehimit familjar.


1. Avancimi, zhvillimi dhe identifikimi i familjeve strehuese si formë alternative e mbrojtjes së fëmijëve pa përkujdesje prindore.
2. Bashkëpunimi me organet relevante komunale për sensibilizimin e rëndësisë së zhvillimit të strehimit familjar.
3. Identifikimi, vlerësimi, trajnimi dhe angazhimi i familjeve strehuese kualitative në Komunën tonë.

1.3.5 Përmirësimi i ambientit dhe kushteve të punës për ofruesit e shërbimeve sociale

1. Ngritja e kapaciteteve njerëzore në kuadër të QPS-së për zhvillimin e shërbimeve sociale.
2. Përmirësimi i kushteve të përshtatshme dhe teknologjike për ofruesit e shërbimeve sociale në QPS.
3. Mbështetja profesionale dhe bashkëpunimi me ofruesit jo qeveritar të shërbimeve sociale.

Shtesë 1:

4. Ngritja e objektit të ri të QPS-së sipas standardeve minimale të përcaktuara nga MPS.



Harta 14_Infrastruktura kulturore, Objektet shtetërore dhe Hapësirat rekreuese

7.9 Inventari i ndërtimeve dhe hapësirave për veprimtari publike ekzistuese sic janë ato mjekësore, arsimore, të postës, të administratës publike dhe shërbimeve të tjera të ngjashme

7.9.1 Arsimi²⁵

Arsimimi është themeli i një shoqërie të shëndoshë, i cili garanton perspektivë për të ardhmen shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike në vend. Vitet e '90-ta, ishin të rënda për arsim në gjuhën shqip në Kosovë për arsye të largimit të dhunshëm nga objektet shkollore. Gjatë periudhës 90 - 99, shqiptarët organizojnë sistemin paralel të arsimit në Kosovë, ku në mënyrë mjaft të mirë e ruajtën arsimin nga asimilimi i gjithëmbarshtëm i shoqërisë në Kosovë. Lufta e fundit në Kosovë la pasojë të mëdha në infrastrukturën shkollore. Pas vitit 2000 (pas luftës), institucionet kosovare bënë përpjekje në realizimin e programeve mësimore bashkëkohore. Në vitin 2002, krijuan një model të ri për sistemin arsimor në vend. Struktura e re ofron 5 vite të arsimit fillor, pasuar nga 4 vite të shkollimit të mesëm të ulët dhe 3 apo 4 vite të shkollimit të mesëm të lartë.

Modeli 5+4+3 po zëvendëson strukturën e mëparshme 4+4+4. Me strukturën e re arsimit i obligueshëm është zgjatuar për një vit nga 8 vite sa ishte në 9 vite.

Struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Rahovecit është e organizuar në katër nivele: arsimin parashkollor (fëmijët e moshës 5 - 6 vjeçar), arsimin fillor (klasët I – V), arsimin e mesëm të ulët (klasët VI – IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasët X – XII).

Numri i objekteve shkollore gjithsejtë është 42, duke përfshirë edhe çerdhet dhe shkollat e mesme. Në procesin edukativo-arsimor në të gjitha nivelet e shkollimit janë të angazhuar rreth 837 punëtorë, prej të cilëve janë 726 mësimdhënës. Numri i nxënësve është gjithsej 10833, që do të thotë se kemi një raport prej 15 nxënës /mësimdhënës (edukator).

7.9.1.1 Arsimi fillor, i mesëm i ulët dhe ai i lartë

Çerdhe dhe kopshte – qyteti i Rahovecit posedon dy çerdhe

Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët (i obliguar) –

Në tërë territorin e komunës mësimi fillor dhe i mesëm i ulët zhvillohet në 37 objekte shkollore ku mësimet i ndjekin rreth 7923 nxënës. Mesatarisht rreth 3 m² hapësirë e brendshme shkollore i takojnë një nxënësi në këtë nivel

Me hapësirë shkollore të pamjaftueshme na paraqiten këto vendbanime: Drenoc (1.5 m²/nx.), Hoça e Vogël (0.9 m²), Krusha e Madhe (1.4 m²), Pastasel (1.5 m²), Ratkoc (0.2 m²), Vrajkë /Bratotin (1.8 m²),

Pjesa dërmuese e vendbanimeve mësimin e zhvillojnë në dy ndërrime, ndërsa shkollat që mësimin e zhvillojnë në një ndërrim janë: ShFMU Rudolf Walther paralelja e ndare në Dobidol, Radostes, Kramovikut, Hoça e Madhe, Kaznikut, Mrasorit, Retisë së Ulët, SHML "Ukshin Hoti" nga Krusha e Madhe, paralelja e ndarë e Senocit dhe shkolla në Zoqisht. Sa i përket kualifikimit të mësimdhënësve, mund të thuhet se mesatarisht në të gjitha shkollat fillore të komunës 90% të personelit arsimor janë të kualifikuar dhe 10% të tjerë janë të pa kualifikuar. Raporti nxënës/mësimdhënës në këto hapësira shkollore sillet rreth 14 nxënës mesatarja për 1 mësimdhënës me dallime të theksuara nga njëra shkollë në tjetrën.

²⁵ Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020

Arsimi i mesëm i lartë –


Përfshin tre vite të shkollimit për nxënësit e grup- moshës 15 deri 18 vjeç. Në këtë komunë janë 5 shkolla të mesme: 3 në Rahovec, 1 në Krushë të Madhe dhe 1 në Ratkoc. Në këto shkolla numri i nxënësve që i ndjekin mësimet është 2331 nxënës, me një kuadër të mësimdhënësve prej 146 që janë të angazhuar në procesin edukativo-arsimor. Kualifikimet e personelit arsimor në këto katër shkolla të mesme sillet rreth 97 % të kualifikuar dhe 3 % të pakualifikuar.

Raporti nxënës/mësimdhënës në shkollat e mesme të larta është 16.3. Mësimi zhvillohet në dy ndërrime në një SHML në Rahovec, pra në SHML "Xhelal Hajda-Toni" dhe në atë të Ratkocit, SHML "12 Maji, ndërsa në shkollën e mesme të lartë të Krushës së Madhe "Ukshin Hoti" dhe në SHMLP "Selajdin Mullaabazi-Mici" në Rahovec mësimi zhvillohet në një ndërrim. Në Shkollën e Mesme të Lartë në Ratkoc problem serioz është mospërputhja e orareve të udhëtimit të autobusëve me orarin mësimor në të dyja ndërrimet. Kështu që, është shumë e nevojshme që të bëhet një marrëveshje ndërmjet kompanive të autobusëve dhe institucioneve komunale, DKA-së dhe institucioneve të tjera, që të përshtatet orari i udhëtimit për nxënësit që vijnë në procesin mësimor në këtë shkollë. Përshkak të kësaj, Shkolla e Mesme e Lartë "12 Maji" nuk është në gjendje të mbajë orar të plotë mësimor në të dy ndërrimet, ashtu siç është paraparë me nga 45 minuta orë mësimore dhe me nga 7 orë maksimale në ditë. Drejtoria Komunale e Arsimit vazhdimisht është interesuar të rregullojë çështjen e udhëtimit të nxënësve dhe ka bërë zgjidhje për bartjen e nxënësve që vijnë në mësimet nga fshatrat e largëta. Deri më tani ekzistojnë disa linja bartëse të nxënësve, udhëtimin(bartjen) e të cilëve e financon Drejtoria Komunale e Arsimit.

Në Shkollat e Mesme të Larta të komunës sonë duhet të shikohet mundësia, sipas udhëzimit administrativ të MASHT-it, që në çdo shkollë të ketë roje. (të vendoset tabela me numrin e nxënësve të shkollës së mesme të lartë)

Shkolla	SH.M.L "Xhelal Hajda – Toni" - Rahovec	SHMLP "Selajdin Mullaabazi- Mici" Rahovec	SH.M.Serbe Rahovec	SH.M.L "12 Maji" Ratkoc	SH.M.L "Ukshin Hoti" Krushë e Madhe
Numri i nxënësve	915	454	9	496	457

Harta 3. Rrjeti i shkollave në komunën e Rahovecit



Harta 15_Institucionet Arsimore

7.10 Shëndetësia

Sistemi shëndetësor në Kosovë pas përfundimit të luftës së vitit '99, u ballafaqua me vështirësi të shumta në çështje organizative, infrastrukturë si dhe në përkrahje financiare. OBSH, Banka Botërore, Bashkimi Evropian, zyra Japoneze, Ministria e Shëndetësisë dhe Komuna e Rahovecit, dhe organizatat tjera ndërkombëtare me investime e tyre luajtën rol të rëndësishëm në zhvillimin e sistemit shëndetësor.

Gjatë kësaj periudhe pothuajse të gjitha objektet shëndetësore të dëmtuara gjatë luftës janë rinovuar dhe shumë objekte të reja janë ndërtuar. U ofruan ndihma në pajisje dhe aparatura mjekësore moderne të nevojshme dhe u organizuan trajnime në lëmi të ndryshme të mbrojtjes shëndetësore, me qëllim të ofrimit të shërbimeve kualitative dhe të leverdishme të kujdesit shëndetësor primar.

Angazhimi i strukturave vendore, edhe pse me shumë vështirësi, si dhe përkrahja dhe bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare sot e ngrenë konceptin e mjekësisë familjare në Kosovë, të paktën në pasurimin e njohurive teorike, në nivel të njëjtë me të gjitha vendet e tjera të rajonit. Gjithashtu edhe në Strategjinë shëndetësore të Kosovës 2005-2015, mjekësia familjare është sektor mjaft me rëndësi në zbatimin e synimeve dhe prioritetëve shëndetësorë kryesorë të identifikuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Në komunën e Rahovecit shëndetësia është e organizuar në sektorin publik, ku ofrohen shërbime të nivelit parësor, dhe në sektorin privat i cili ofron shërbime parësore të lëvizshme të specializuara mjekësore.

Në sektorin publik, kujdesi primar shëndetësor është i organizuar në 16 objekte shëndetësore:


- QKMF -1 Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare në qytetin e Rahovecit
- QMF -7 Qendra e Mjekësisë Familjare në: Ratkoc, Bellacerkë (Fortesë), Qifllak, Drenovc, Krushë e Madhe, lagja e Arave dhe Apterush
- AMF -7 Ambulanca të Mjekësisë Familjare në: Lagja e Eperme, Hoqe e Madhe, Zaqishtë, Brestoc, Radostë, Polluzhë dhe Xërxë.
- Qendra për punë sociale.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Rahovec, si bartëse e kujdesit primar, është e vendosur në qytetin e Rahovecit dhe ka gjendje fizike të kënaqshme.

Kjo qendër mbulon me shërbime territorin e Rahovecit dhe fshatrat përreth. Në këto institucion janë të punësuar gjithsej 87 punonjës, 28 mjek dhe 59 infermier - teknik.

Stafi teknik nga Drejtoria e Shëndetësisë

Harta 4. Objektet shëndetësore në komunën e Rahovecit



Harta 16_Institucionet Shëndetësore

8 MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

8.1 Gjendja ekzistuese e mjedisit në komunë, duke evidentuar ndotjet, shtrirjen hapësinore të ndotjeve dhe degradimeve

Njerëzit tani janë në rrezik nga ngjarjet ekstreme gjeofizike – natyrore, siç janë: vërshimet, tërmetet, ortelet, thatësira, zjarret etj. Si rrjedhojë mund të thuhet se kanosja e fatkeqësive të reja, i ka karakteristika të padëshiruara, që mund të kenë efekte tepër të përhapura dhe në të njëjtën kohë vështirë do të neutralizohen.

8.1.1 Ndryshueshmëria e ajrit

Stuhitë - shtrëngatat dhe vetëtimat shkaktohen nga çekuilibrimi atmosferik dhe nga çrregullimet gjatë kombinimit të këtyre rrethanave:

- ajri i ngrohtë i paqëndrueshëm, me të shpejtë rritet në atmosferë ,
- lagështia e mjaftueshme për të krijuar re dhe shi,
- ngritja e rrymave të ajrit në lartësi, të shkaktuara nga ndeshja e dy pjesëve të ujit (uji i ftohtë dhe uji i nxehtë), erërave të detit ose të maleve.

Bubullimat- sjellin shi dhe vetëtimë dhe ky rrebes mund të shndërrohet në shtrëngatë të ashpra me breshër, që shkakton dëme, erëra të mëdha. Shtrëngata konsiderohet e ashpër nëse era arrin ose tejkalon shpejtësinë 100 km/h dhe shkakton reshje të breshrit

Vetëtimat, që shpreh në të gjitha shtrëngatat, mund të godas kudo. Të shkaktuara nga krijimi i joneve në re shtrëngatë, zbrazja e vetëtimës bashkëvepron më së miri në objekte ose në sipërfaqe të Tokës. Ajri, në vijën ku vetëtimat godet, arrin temperaturë më të lartë se 25.000 gradë të Celsit.

Ngrohja dhe ftohja e shpejtë e ajrit afër vijës së goditur shkakton përplasjen e valëve që prodhojnë bubullimë.

Stuhitë, shkaktohen edhe dimrit me sistem të shtypjes së ulët të ajrit. Shtrëngatat godasin zonat relativisht të vogla atmosferike. Mesatarja e shtrëngatës është përafërsisht 25 km (15 milje) në diametër dhe kryesisht zgjat më pak se 30 minuta në lokacion të veçantë.

8.1.1.1 Dëmet e mundshme

Kategoritë e stuhisë e para (minimale)

Shpejtësia e erës 119 - 153 km/h

Nuk ka dëme në ndërtesa. Së pari goditen shtëpitë, mobile, shkurret dhe drunjtë. Ka vërshime në rrugë dhe dëme të tjera.

Kategoria e uraganit e dyta (mesatare)

Shpejtësia e erës 154 – 177 km/h

Dëmtohen kulmi, dyert dhe dritaret. Dëmet të konsiderueshme të shkurreve dhe drurëve. Dëme të shtëpive lëvizëse, shenjave dhe mbrojtësve. Vërshime në rrugë.

Kategoritë e uraganit e treta (të gjëra)

Shpejtësia e erës 178 – 209 km/h

Disa dëme në ndërtesa të vogla. Dëme të shkurreve dhe të drurëve, bien drurët e mëdhenj. Shtëpitë mobile dhe shenjat shkatërrohen. Rrugët bllokohen me rritjen e ujit. Mund të kërkohej evakuimi nga shtëpi të ulëta dhe disa bllokada gjatë breg lumit etj.

8.1.1.2 Masat preventive nga Thatësia

Rekomandimi i disa masave preventive që duhet të merren nga thatësia janë:

- Gjetja e burimeve të reja për ujë të pijes, financuar nga komuna,
- Zgjerimi i ujësjellësit nëpër këto zona,
- Shfrytëzim racional i ujit të pijes nga vet banorët,
- Rregullimi i rrjetit të ujitjes nga ana e Ministrisë së Bujqësisë.

Identifikimi i rrezikut

Rrjeti hidrografisë në territorin e Komunës së Rahovecit është relativisht i mirë. Pasuria është se e përbëjnë disa : burime, puset, burimet rrjedhëse të qëndrueshme.

- Pusët – janë objekte hidrografike të cilat popullata rurale dhe urbane kanë hapur për nevojat e veta.

- Burimet – janë format të rëndësishme hidrografike. Këto, në territorin e komunës janë disa qindra burime periodike dhe të përhershëm.. Këto burime janë kryesisht rrëzë maleve të Shkozës dhe Zatriqit .

Nga këto burime kryesisht përfitojnë ato vendbanime të cilat janë ngritur rrëzë malit të Shkozës, Zatriqit dhe Kaznikut.

Nga 36 vendbanimet që ka Komuna janë 20 prej tyre furnizohen nga hidrosistemi i Radoniqit, kurse 15 vendbanimet nuk kanë furnizim me ujë të pijes nga ky hidrosistemi e sidomos vendbanimet të cilat janë rrëzë maleve të lart cekura . Pra, në këto ndihet thatësia më shumë sidomos në stinën e verës, në muajt qershor - shtator .Me gjithat banorët furnizohen nga disa burime të hapura nga vet ata.

Uji nga këto burime është gjithmonë nën mbi këqyrjen e inspektorit sanitar komunal.

Nga llogaritja del se rreziku është në kufijtë e shkallës së rrezikshmërisë si rrezik i mesëm dhe duhet kushtuar një vëmendje të nevojshme.

8.1.1.3 Ndotja e ujit dhe kushtet hidrometeorologjike

Burimi kryesor i ndotjes së lumenjve në komunë janë ujërat e kanalizimit, si pasojë e sistemit të pakompletuar dhe joadekuat të menaxhimit të tyre

Ku shkaktohen derdhjen e ujërave të zeza pa trajtim paraprak, me një ndikim negativ në cilësinë e ujit si dhe në jetën bimorë dhe shtazore. Pasojat e kësaj ndotje mund të shkojnë edhe më tej duke shkaktuar ndikime negative në tokë dhe në ajër

Kushtet hidrometeorologjike kryesisht janë reshjet atmosferike si p.sh. :

- shiu
- shtrëngatat dhe vetëtimat
- breshëri
- bora
- bryma
- erërat e ashpra
- thatësira etj.

Vlerësimi i rrezikshmërisë nga thatësitë

Profili i Rrezikut
RREZIKU: Thatësirë (Mungesa e ujit të Pijes)

Madhësia e mundshme (Përqindja e komunitetit që mund të goditet): Kritike: 30 deri 40%	
Frekuenca e ndodhjes: Shumë e mundshme: : Mundësia afër 90%, së paku një herë në vit.	Modeli Sezonal: Verë: Korrik – gusht
Zonat që mund të goditen më së shumti: Drenoci, Pataqani i Epërm, Senoci, Pastaseli, Guri i Kuq etj.	
Kohëzgjatja e mundshme : Verë: 30 - 40 ditë.	
Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit): Sistemet ekzistuese të paralajmërimit : Sistemi i Integruar i Paralajmërimit (112), Shërbimet e Zjarrfikës dhe Shpëtimit (93), Departamenti i Menaxhimit të emergjencave, Policia e Kosovës (92)	
A ekziston analiza e dobësive / cenueshmërisë ? Po _____	

KATEGORIA E RREZIKUT	HIDRPOLOGJIKE
LLOJI	FATKEQËSI NATYRORE
RREZIKU	THATËSIA
LOKACIONI:	RAHOVECI, DRENOCI, PATAQANI I EPËRM, SENOCI, NASHPALLA, PASTASELI, GURI I KUQ, OPTERUSHA ETJ.

8.1.1.4 Infrastruktura e ndërtuar për mbrojtje

Infrastruktura e ndërtuar për mbrojtje nga rreziqet hidrometeorologjike në vitet e fundit në territorin e komunës tonë nuk funksionojnë. Paralufte ky sistem ka funksionuar për mbrojtje nga breshëri sidomos në dy pika, ku efekti i mbrojtjes ka qenë evident. Kjo mbrojtje ka qenë kryesisht për mbrojtje nga breshëri. Mirëpo, infrastruktura e ndërtuar për mbrojtje nga vërshime nuk ka. E që për të ardhmen duhet menduar.

8.1.2 Ndotja e tokës ,katastrofat teknikoteknologjike

Duke pasur parasysh faktin se substancat e rrezikshme janë të pranishme në komunitetet anekënd botës, kryesisht në zonat industriale dhe gjatë transportimit nëpërmjet autostradave, hekurudhave dhe kanaleve të ujërave. Aksidentet, duke përfshirë këtu zjarret, eksplozimet dhe rrjedhjet, që e shkaktojnë lirim të këtyre substancave, mund t'i dëmtojnë shumë shëndetin e njeriut, pronën dhe mjedisin e tij.

Ekspozimi i njeriut ndaj substancave të rrezikshme mund të shkaktojë lëndime, madje edhe vdekje, të një numri të madh njerëzish. Ky ekspozim mund të ndodh drejtpërsëdrejti, me anë të ekspozimit të syrit, me kontakt në lëkurë, me inhalim, gjatë kapërdirjes, ose si rezultat i ndotjes së ujit a të dheut, që mund të ndikojnë në prodhimin e ushqimit.

Popullata e rrezikuar në rast aksidenti (ose "publiku potencialisht i goditur") është kryesisht, ose në zonën industriale, ose shumë afër saj, pran rrugëve të transportit, edhe pse popullata mund të goditet edhe me anë të ujit të ndotur ose të prodhimeve ushqimore. Rrallëherë ndodh që popullata e ekspozuar të jetë më larg nga vendi i fatkeqësisë.

Për qëllime të këtij kursi, të lidhur me parandalimin, gatishmërinë dhe përgjigjen ndaj aksidenteve teknologjike, vëmendja përqendrohet tek aksidentet në pajisjet e instaluar të palëvizshme, që përmbajnë substanca të rrezikshme dhe që mund t'i godasin njerëzit, pasurin ose mjedisin edhe pse shumë prej tyre ndodhin gjatë transportit. "Pajisjet e instaluar të palëvizshme", - në kuptim të gjerë, - përkufizohen si uzina ose vende që prodhojnë, përpunojnë, përdorin, trajtojnë, rruajnë ose hedhin substanca të rrezikshme. Kështu, pajisjet e instaluar të palëvizshme përfshijnë uzinat e prodhimit të substancave të rrezikshme dhe vendet e tjera industriale, në të cilat përdoren ose përpunohen substancat e rrezikshme; depot që përmbajnë këto substancash; vendet ku hidhen këto substanca etj.

8.1.2.1 Fatkeqësitë e shkaktuara nga objekt ekonomike

Në kohën kur po jetojmë, kemi një zhvillim të teknikës dhe teknologjisë bashkëkohore-industriale, ndërmjet arritjeve të jashtëzakonshme të shkencës që mundësojnë jetë më të mirë, të sigurt dhe më të shëndoshë dhe vdekjes, e shkatërrimeve të shoqëruara me të ashtuquajturat "rreziqeve të natyrës dhe teknologjisë". Paradoksi, aq më tepër, është i ndërlikuar me faktin se as vetë teknologjia nuk është pa rreziqe dhe kushtimisht solli raste të reja emergjente nga rreziqet e "shkaktuara nga njeriu", që dalin nga dështimi i sistemeve teknologjike. Pra, njerëzit tani janë në rrezik jo vetëm nga ngjarjet ekstreme gjeofizike, por edhe nga shpërthimet fizike, nga lirim i materieve toksike. Sa më shumë duhet të inkurajohet vetëdijesimi lidhur me fatkeqësitë, për shkak se fatkeqësi të reja ndodhin vazhdimisht.

- Proceset teknologjike të shkaktuara nga njeriu me ndikim në ekonomi:
- Aksidentet e transportit
- Shpërthimet dhe zjarret në objekte industriale
- Lirim aksidental i gazrave helmuese
- Avaritë në industri,
- Rrëni i objekteve publike ose i strukturave tjera etj.

Ekzistojnë dy përkufizime në lidhje me fatkeqësitë:

- Fatkeqësi të mëdha ose të papritura
- Ngjarjet e befasishme katastrofike që shkaktojnë dëme të mëdha materiale, humbje dhe shqetësime.

Por ka edhe shumë përkufizime të tjera për fatkeqësinë. Shumica e këtyre përkufizimeve përpiqet t'i pasqyrojnë karakteristikat, si vijon:

Çrregullimet në veprimtari normale. Këto çrregullime, zakonisht janë të rënda, por që mund të jenë edhe të papritura, të befasishme dhe të përhapura kudo;

- Pasojat njerëzore, siç janë: humbjet e jetëve, vuajtjet nga lëndimet dhe pasojat e rënda në shëndet;
- Pasojat në strukturën ekonomike (industri) si: shkatërrimet ose dëmtimet në sistemin e ekonomisë, në ndërtesa, në komunikime, në prodhim e shërbime qenësore.
- Fatkeqësitë, zakonisht, vlerësohen në bazë të përmasave të kriterit të viktimave dhe dëmeve materiale. Ajo që shkakton "dëmtime" kurë nuk është definuar saktësisht. Është e pothuaj, e pamundshme që çdo herë të bëhet vlerësim i saktë i dëmeve në ekonomi. Krahas dëmeve të drejtpërdrejta në pasuri, dëmet e tjera afatgjata (të tërthorta) shpesh herë i tejkalojnë të drejtpërdrejtat.

Nga llogaritja del që rreziku është në kufijtë e mesëm. Atëherë, shkalla e rrezikshmërisë është rrezik i mesëm dhe duhet një Veprim i nevojshëm për intervenim.

Goditja

- Një numër i kufizuar i objekteve të goditura nga mundësia e shpërthimit të zjarrit dhe detonimit,
- Zhvendosje e lokalizuar e 7 familjeve nga 2 ditë deri në një (1) javë,
- Mbështetje personale e mjaftueshme nga niveli lokal,
- Çrregullim i qarkullimit rrugor në magjistralen Xërxë – Fortesë – Rahovec,
- Funksionim normal i komunitetit.

Goditja	Banorët	Familjet	Hendikep	Femra	Meshkuj	Nxënës	Pleq	Të mirat materiale	Infrastruktura kritike	Dëmet ekonomike Kostoja
	3881	25	2	636	662	700	37	Dëmtim i Pompës së derivateve të naftës	Dëmtim i Rrugës Magjistrale. Rahovec-Xërxë	1.300.000 ,00

8.1.3 Përmblytjet

Vlerësimi i rrezikshmërisë nga vërshimet

Zonat që numd të goditen më së shumti: Fshatrat - Fortesë, Sapniq, Krushë e Madhe, Celinë, Çifllak,Dejn,Xerxe,Gexhe,Radoste,Ratkoc dhe pjesa jugore e qytetit të Rahovecit (Nënqyteti), etj.

Vërshimet janë uji i tepërt i shtratit i cili del nga lumi apo përroi dhe derdhja e ujërave të tepërta në fushën e afërt lumore, brigjeve të ulëta. Vërshimet janë rreziku më i shpeshtë i ambientit por edhe i objekteve në ato sipërfaqet e vërshuar. Por, ka raste që ato marin edhe jetën e njerëzve. Arsyeja qëndron në shtrirjen e gjerë gjeografike të lumit – përrrenjve të vërshuar nga përmblytja e derdhjeve të ujit, si rrjedhim i shirave intensive në brigje të ulëta.

Në territorin e komunës sonë, vërshimet janë rreziku më i shpeshtë i ambientit.

Vërshimet, zakonisht shkaktohen nga përmblytja e derdhjeve të ujit, si rrjedhim i shirave intensive, dhe ngushtimit të shtratit të përroit të mbushura me material të ngurtë etj.

Vërshime mund të jenë:

- Vërshimi i lumit,


- Vërshime të shpejta nga përrrenjtë,
- Vërshimi nga lëkundja (shpërthimi) i mundshëm të digës – nivelit të liqenit Radoniqi.

Vërshimet breglumore përfshijnë:

- derdhjet nga shtretërit e lumenjve ose vërshimet e lumenjve,
- vërshimet e shpejta,
- vërshimet lymore,
- vërshimet nga shpërthimi i digës.

Nuk ka shenja shumë të dallueshme ndërmjet vërshimeve të lumenjve, vërshimeve të shpejta, vërshimeve lymore dhe vërshimeve nga çarja e digës.

Shiu, zakonisht, në këto raste ka shtrirje të gjerë dhe është i rreptë. Niveli i vërshimeve mund të jetë i lartë dhe ndikohet nga veçoritë topografike.



Harta 17_Zonat potencialisht të rrezikuara nga vërshimet

8.1.4 Plani i reagimit emergjent

Ekzistojn planet e reagimit emergjent, ku në ato plane janë të përcaktuara në detaje si:

- Prioritetet
 - Operacionet e zbulimit, kërkimit dhe shpëtimit;
 - Operacionet e evakuimit dhe strehimit;
 - Operacionet e pengimit (punët e xhenojës (inzhierike), hapja e kanaleve etj);
 - Operacionet e reagimit (forcimi i digave, urave, hapja e rrugëve);
 - Operacionet e sanimit të gjendjes.

- Fazat
 - Njoftimi i njësive dhe alarmi
 - Ngritja e Qendrave Operative (Q O - ve)
 - Ngritja e gjendjes së gatishmërisë
 - Dërgim i ekipeve për zbulim
 - Shkuarja në vendin e ngjarjes
 - Intervenimet dhe sanim i gjendjes
 - Kthimi në bazë.

8.1.5 Masat preventive nga vërshimet

Si masë preventive për parandalimin e vërshimeve, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim rekomandon këto masa parandaluese afatgjata, afatmesëm dhe afatshkurtër.

Të vazhdohet me pastrimin dhe rregullimin e shtratit të lumit Drini i Bardh nga Kramoviku deri më Krushë të Madhe, si dhe shtratin e disa përrrenjve të cilët janë mbushura me material të ngurtë.

Po ashtu si masë tjetër parandaluese për zvogëlimin e dëmeve nga vërshimet në rrugët e qytetit në Rahovec, është edhe pastrimi i kanalizimit për ujërat atmosferik që shpesh bllokohet dhe paraqet problem gjatë reshjeve të shiut dhe shkrirjes së borës.

Masë tjetër parandaluese është edhe vetëdijesimi i popullatës për mos hedhjen e mbeturinave pran brigjeve të lumit dhe përrrenjve, si dhe ndëshkim i të gjithë atyre që bëjnë hedhjen e mbeturinave larg vendeve të caktuara.

Sipas shënimeve statistikore që kemi për të reshurat e shiut mund të konstatojmë që sasia mesatare vjetore e të reshurave është afër 87,98 mm/m², kurse në sezonin e vegjetacionit (prej muajit të IV – IX)afër 56,17 mm/m², mirëpo kjo është variabile varësish nga viti .

8.1.6 Fatkeqësitë në penda hidroakumuluese

Rrezik real të përmasave më të mëdha për një pjesë të territorit të komunës së Rahovecit paraqet dëmtimi i pendës hidroakumuluese të KRU Gjakove (ish Hidrosistemit Radoniqi). Kjo digë në gjatësi prej L=770m, dhe lartësi 61m.

Matja e parë bëhet në muajin Maj kur baseni është me kapacitet të plotë (456,00 NNm V=117.792.633m³)të ujit dhe në muajin Shtator kur uji arrin nivelin më të ulët si pasojë e shpenzimit më të madh gjatë muajve të verës.

Gjendja momentale e digës bazuar në matjet gjeodezike dhe gjeomekanike tregon se trupi i pendës është në kufijtë e lejuar sipas projekti e gjithësesi edhe deformimet e saj janë në kufijtë e lejuar.

Vet konstrukti i digës së ndërtuar ka përmbajtje të qëndrueshme ndërtimore e cila sipas vlerësimeve të ekspertëve-projektuesve të kësaj dige mund të përballojë lëvizje sizmike të tokës deri në 9 shkallë të Rihterit.

Me dëmtimin e mundshëm të digës së Radoniqit vala vërshuese drejtpërdrejtë rrezikon këto fshatra (me këto karakteristika të dinamikës së përmbajtjeve):

Nr. ren.	Vendbanimi	Distanca nga diga në metra	Koha e arritjes së valës së ujit	Nr. banorëve për evakuim
1	Zhdrellë	1400	1min, 20sek	215 KK Gjakovë
2	Bec	5100	5min, 40 sek	1057 KK Gjakovë
3	Vraniq	8000	10min	233 KK Gjakovë
4	Doblibare	12800	16min, 40sek	780 KK Gjakovë
5	Ratkoc	10000	20min	3791 KK Rahovec
6	Malësi e Vogël (Radost)	16000	32min	2346 KK Rahovec
7	Gexhë	23800	40min	660 KK Rahovec
8	Ura e Fshejtë		49min	
9	Bishtazhin		50min	780 KK Gjakovë

8.1.7 Erozioni dhe sedimentimi

Erozionet janë- ndryshimet e vazhdueshme që pëson sipërfaqja e dheut nga veprimi i ujërave, i akullit dhe i erës. Shembjet e dheut janë – lëvizja teposhtë e vëllimeve të mëdha të materialeve të sipërfaqes nën ndikimin e gravitacionit paraqet një lloj të rëndësishëm të rrezeqeve të ambientit, veçanërisht në terrenit malore por edhe kodrinore. Shembjet e shpejta shkaktojnë humbje njerëzish dhe dëme tjera, kurse shembjet e lehta kanë më pak pasoja në humbje të njerëzve dhe dëmeve tjera materiale. Varësisht nga materiali dominues, këto lëvizje zakonisht mund të ndahen në:

- shembje gurësh
- shembje dheu

Lëvizjet masive mund të nisen nga ndonjë aktivitet sizmik ose vullkanik (ose nga ndonjë dridhje tjetër e fortë) ose nga ndonjë ndodhi atmosferike. Në këtë shkallë, ky rrezik shtrihet në zona ndërveprimi të zhvillimeve të brendshme dhe të jashtme të Tokës.

8.1.8 Rrëshqitjet e tokës

Shprehja shembje përfshin shumicën e lëvizjeve teposhtë të gërmadhave dheu e gurësh, që ndahen nga shtresa e poshtme, si pjesë e fortë e pjerrësisë nga zona e zhvendosur ose nga sipërfaqja e çarë. Lloji i lëvizjes, që mund t'i përfshijë: rënien, rrëshqitjen dhe rrjedhjen, varet shumë nga natyra e mjedisit gjeologjik, duke përfshirë edhe fuqinë e materialit, konfiguracionin e pjerrësisë dhe shtypjen e të çarave të ujit.

Llojet e ndryshme të shembjes lëvizin teposhtë me shtrirje të gjerë të shpejtësisë. Shumë shembje me lëvizje të shpejtë mund të paraqesin rrezik të madh për jetë, sepse ato mund t'i zhbëjnë vendbanimet ose t'i dëmtojnë rrugët shpejt dhe me këtë japin një "mësim" të vogël. Shembjet me lëvizje të lehtë gradualisht mund të shkaktojnë rritje e sasisë së dëmit, por lëvizjet e parashikuara mund të priten.

8.1.9 Orteqet dhe shpatet e pjerrëta

Orteku është grumbull bore që rrëshqet teposhtë maleve. Ortekët po ashtu quhen edhe rrëshqitje bore. Ortekët e borës janë rrjedhim i një "lufte" të pa barabartë ndërmjet trysnisë në një pjerrësi. Orteku paraqitet kur trysnia (e gravitetit), që provon ta shtyjë borën teposhtë, ia kalon fuqisë (nga lidhja e topave të borës) së mbështjellësit të borës. Ortekët shkatërrojnë strukturat e ndërtuara, rrugët, kabllot dhe linjat e komunikimit, kur bora rrëshqet nga lartësitë e mëdha ose duke i groposur ato. Ortekët janë rreziqe kryesore në shumë vise malore.

Faktorët që shkaktojnë ortekun:

- kushtet atmosferike
- temperatura
- pjerrësia e këndit (topografia)
- shtresa e borës
- drejtimi i erës
- bimësia
- gjendja e përgjithshme e grumbullit të borës.

Fuqia e grumbullit të borës është e ndërlidhur me dendësinë e borës dhe me temperaturën e tij. Krahasuar me gjërat tjera të ngurta, shtresa e borës kanë aftësi të rrallë për t'iu përballuar ndryshimeve të mëdha të dendësisë. Kështu, shtresa e depozituar me një dendësi origjinale 100 kg/m^3 mund të dendësohet deri 400 kg/m^2 gjatë dimrit, më së shumti i nevojshëm për peshën e mbishtresave të borës, të tretjes së trysnisë dhe rikristalizimit të akullit. Kur temperaturat rriten dhe kur në grumbull ka ujë të shkrirë, rritet rreziku i lëvizjes së borës.

Frekuenca e ortekut është e ndërlidhur me këndin e pjerrësisë. Ortekët lirohen zakonisht në pjerrësinë në kufirin e zonës malore që rri matanë erës ekzistuese (në pjerrësinë ku nuk fryn era grumbullohet bora që vjen prej drejtimit nga fryn era ose malet). Ortekët fillojnë të lëvizin vetëm në ndonjë pyll mesatarisht të dendur apo të zhveshur. Të gjithë ortekët e ndjekin një shteg të ortekëve, që përmban tri elemente:

- zonën e nisjes, ku fillimisht bora çahet,
- shtegun e ortekut ose rrugën aktuale që e ndjek, dhe
- zonën e zbrazjes, ku bora ngadalësohet dhe ndalet.

Ortekët përbëhen nga dy pjesë: të sipërmen dhe të poshtmen. Në ortek pjesa e sipërme e borës është më e shpejtë sesa pjesa e poshtme, kështu që pjesa e sipërme mbështillet me pjesën e poshtme dhe bëhen edhe vetë pjesë e poshtme e borës, duke e humbur shpejtësinë për shkak të drurëve dhe të pengesave të tjera. Pjesa e poshtme e mëparshme rrotullohet mbi pjesën e sipërme të vjetër dhe bëhet pjesë e sipërme.

Ka raste ku ortekët tentojnë të paraqiten përsëri në të njëjtin vend, prandaj rreziku për rastin tjetër mund të vërehet sipas njohjes së shtigjeve të mëhershme të ortekëve në reliev.

8.1.10 Tërmetet

Energjia sizmike transmetohet në sipërfaqen e tokës nga thellësia në formë dridhjes. Dridhjet shkaktojnë dëme dhe rrënimë të strukturave që përcillen me vdekje dhe lëndime. Dridhjet, gjithashtu, mund të shkaktojnë shembje të dheut, shembje të shkëmbinjve, lëngëzim të tokës dhe dëme të tjera të saj, duke dëmtuar vendbanimet në afërsi, duke shkaktuar zjarre të shumta, aksidente industriale ose në transport dhe duke rrezikuar me vërshime shkatërrimet digave të liqenit.

Tërmeti është një dukuri kur ndodhin dridhje të fuqishme në tokë, kur lirohet energjia e tepërt brenda një kohe të shkurtër, duke shkaktuar tronditje të papritura 15-50 km. nga epiqendra e tërmetit.

8.1.10.1 Karakteristikat seizmologjike të terenit dhe rreziku seizmologjik

Pasi rajoni i komunës së Rahovecit gjendet në qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit ku reliefi është rrafshinë – luginor – kodrinore – malore, nga një tërmet eventual i goditur m'varësisht nga shkalla e goditjes do të jetë edhe me pasoja të ndryshme.

Në bazë të një harte seizmologjike të Kosovës, territori i komunës sonë gjendet në zonën me intensitet maksimal në mes 7^o dhe 8^o (shkallë) të Rihterit.. Tërmeti mes 7^o e 8^o të intensitetit është shkatërrues, do të dëmtonte këto zona: Rahovecin me zonën, luginën e lumit Drini Bardh dhe Malësinë e Zatriqit. Tërmeti i tillë mund të shkaktoj fatkeqësi të mëdha deri te dëmtimi i pendës së liqenit artificial " Radoniqi". Po të ndodh një tërmet i tillë për rajonin e Anadrinis e më gjer, kishte me u shkaktua katastrofë natyrore dmth., një vërshim me dimension të gjerë të paparashikuar në vendbanime e fusha buzë lumit Drini Bardh.

8.1.10.2 Cilësia dhe mjeshtëria

Është e zakonshme të thuhet se ndërtesat që janë ndërtuar mirë do të jenë më të qëndrueshme sesa ato që nuk janë ndërtuar mirë. Përdorimi i materialit të cilësisë së mirë dhe i teknikave të mira të konstruktimit, do të garantonte ndërtesë mirë të ndërtuar, që mund t'u bëj ballë lëkundjeve sesa ajo që është ndërtuar me material më të dobët dhe me murosje shkel e shko. Në rastin e strukturave të ndërtuara me inxhinieri të dobët, mund të ndodhë që strukturat e konstruktura të mos i përmbushin siguritë e kodit përkatës seizmik të ndërtesës.

8.1.10.3 Intensiteti dhe epiqendra

Shkatërrimet dhe dëmtimet do të jenë varësisht nga intensiteti dhe epiqendra e tërmetit në një rajon. Nëse intensiteti i tërmetit është më i madh edhe dëmtimet e objekteve do të jenë më të forta. Por, kjo do të varet edhe nga epiqendra e tërmetit. Nëse vendbanimet do të jenë më afër ose në epiqendrën e tërmetit edhe rrënimet e objekteve do të jenë më të mëdha dhe me pasoja të katastrofave si në jetën e njerëzve dhe në mjetet materiale.

8.1.10.4 Pasojat e termetit në zonat seizmologjike.

Forcat osciluese të shkaktuara nga tërmeti shkaktojnë një seri dëmtime në ndërtesa banimi, ekonomike dhe të infrastrukturës në vendbanime. Presionet rezultojnë me çarje të rralla ose të hapura të elementeve strukturore, që është problem posaçërisht për materialet që nuk kanë elasticitet, siç është betoni.

Pasojat të cilat shkaktohen nga tërmetet janë: zjarret, shembjet e dheut dhe objekteve të banimit e ekonomike, të digave, të lidhjeve të transportit dhe të elementeve infrastrukturore (uji, kanalizimi etj).

8.1.10.5 Epidemiologjia e viktimave të tërmetit

Tërmetet shkaktojnë një numër të gjerë të shkallës së lëndimeve. Një përqindje mjaft e madhe e lëndimeve nuk janë vetëm pasojë e drejtpërdrejtë e shembjes së ndërtesave, por mund të jenë rezultat i fatkeqësive të tjera të shkaktuara nga tërmetet si: rrënja e orendive, rrëzimi i mureve të ulëta dhe materiali tjetër.

Në të gjitha fatkeqësitë, posaçërisht në ato që i shkaktojnë tërmetet, ka viktima. Në përgjithësi këto viktima mund të klasifikohen në tri kategori:

- pa lëndime fizike
- të lënduar
- të vdekur

Për kategorinë e të "të lënduar" duhet të ndërmerren veprime emergjente për t'iu dhënë me kohë ndihma mjekësore, në mënyrë që të rriten gjasat e mbijetesës së tyre. Ky grup i të lënduarve, më tutje mund të ndahet në tri nën-grupet në vijim:

- të lënduar dhe të zënë nën gërmadha
- të lënduar, por jo të zënë nën gërmadha
- të lënduar, por të humbur / që nuk dihet ku janë.

8.1.10.6 Shkaqet tjera natyrore

Rreziqet e natyrës janë ato elemente fizike të ambientit, të dëmshme për njeriun, që shkaktohen nga një forcë e jashtme, ose me fjalë të tjera mundësia e paraqitjes, brenda periudhës kohore specifike në zonën e caktuar, së dukurive të natyrës që mund të shkaktojnë dëme.

Shumica e fatkeqësive të natyrës shkaktojnë pasojat natyrore dhe njerëzore.

Rreziqet më të mëdha të natyrës, që, do të shqyrtohen në këtë modul, janë: zjarret, stuhia, erozionet (shembja e dheut), bora e madhe, dhe ortehtë.

8.1.11 Sipërfaqe të rrezikuara nga zjarri

Zjarret që përhapen shpejt është shprehje e përgjithshme për zjarret e pakontrolluara.

Zjarret e shpejta shfaqen si rezultat i veprimeve të njëkohshme të tre faktorëve themelorë:

- Lënda ndezëse (të gjitha llojet e bimësisë)
- Kushtet atmosferike
- Zanafilla e ndezjes.

Në përgjithësi, temperaturat e larta dhe thatësia që e përcjellin një periudhë aktive të rritjes së bimësisë, i krijojnë kushtet më të mëdha të rreziqeve. Kjo do të thotë se shumica e zonave të rrezikshme janë të prirë të kenë klimë mesdhetare dhe kontinentale.

Meqenëse zjarret e shpejta kryesisht janë rreziqet rurale, gjithmonë shkaktohen dëme në ekosistem. Pas një ndodhie të madhe, drurët e malit dhe ushqimi i kafshëve mund të shkatërrohen, stallat e shtazëve dëmtohen dhe vështirësohet jeta me të madhe për një kohë. Zjarret janë klasifikuar në disa grupe:


- zjarret aksidentale (shpërthimet, aksidentet në trafik)
- zjarret nga pakujdesia (kalimtarët, turistët, lojërat e fëmijëve, depozitë e bërllokut, etj)
- zjarret malore
- zjarret fushore
- zjarret të qëllimta.

Përcaktimi i shkallës së rrezikshmërisë së pyjeve dhe tokave pyjore nga zjarret, bëhet sipas nr. të poenëve të nxjerrë nga kriteret specifik sipas llojeve të drunjtëve të grumbullit pyjor dhe karakteristikave tjera.

NR.	SHKALLA E RREZIKSHMËRISË	NR. I POENËVE
I.	Shumë e madhe	> 480
II.	E madhe	381 – 480
III.	Mesatare	281 – 380
IV.	E VOGËL	< - 280

Legjenda e paraqitjes së grumbullit pyjor sipas llojeve të drunjtëve e që paraqesin shkallën e rrezikshmërisë adekuatë është:

NR	SHKALLA E RREZIKSHMËRISË	NGJYRA NË HARTË
I.	Shumë e madhe	E KUQE
II.	E madhe	E KUQËRREMTË
III.	Mesatare	E VERDHË
IV.	E VOGËL	E GJELBËR



Harta 19_Rrezikshmëria e Vendbanimeve nga Zjarret

8.1.12 Vlerësimi i rrezikshmërisë nga zjarret në objekte banimi dhe zjarre fushore
 Vlerësimi i rrezikshmërisë nga zjarri paraqet një mjet për koordinimin e aktiviteteve dhe nëse shfrytëzohet në mënyrën e duhur do të: shpëtojë jetën e njerëzve dhe pasurinë, rritë ndikimin e kapaciteteve ekzistuese, siguron ngritjen e kapaciteteve dhe burimet shtesë për ndihmë.

Profili i Rrezikut	
Rreziku : Zjarret në sipërfaqe të hapura	
Madhësia e mundshme (Përqindja e komunikimit që mund të goditet):	
Kritike: 12 deri 28%	
Frekuenca e ndodhjes: Shumë e mundshme: Mundësia afër 100%, së paku dy herë në vit.	Modeli Sezonal: Pranverë: Shkurt - Mars Verë: Korrik-gusht-shtator
Zonat që mund të goditen më së shumti: Pyjet në tërë Komunën e Rahovecit, sidomos pyjet që shtrihen në masivin malor: Rahovec, Kaznik, Zatriq, Shkozë, Oplotushe, por edhe në vendet tjera të territorit të komunës, nuk ka zona të sakta ku paraqiten zjarret sepse ato janë natyrore dhe shfaqen mbas kushteve që krijohen për shpërthimin e zjarrit në mjedis.	
Kohëzgjatja e mundshme: Pranverë: 6 orë - 3 ditë Verë: 15 - 30 ditë	
Shpejtësia e mundshme e mësymjes (shuma e mundshme e kohës së paralajmërimit):	
* Paralajmërimi 6 deri 12 orë.	
Sistemet ekzistuese të paralajmërimit: Sistemi i Integruar i Paralajmërimit (112), Shërbimi i Zjarrfikës (93), Policia e Kosovës (92)	
A ekziston analiza e dobësive / cenueshmëris ?	
Po	

Kategoria e rrezikut	Tekniko-teknologjik
Lloji	Fatkeqësi natyrore
Rreziku	Zjarr në sipërfaqe të Hapura
Lokacioni:	Visi malor Shkozë – Zatriq – Kaznik etj.

Në territorin e Komunës së Rahovecit nga viti 2015 e deri 2017 ka pasur rreth **435** raste të shpërthimit të zjarreve, prej tyre një numër janë në objekte banimi dhe objekte tjera ndihmëse, ndërsa raste tjera kanë qenë zjarre malore dhe fushore e intervenime në komunikacion.

Dëmet e shkaktuara nga zjarret nëpër objekte banimi dhe pyje kapin një kosto shumë të lartë.

Goditja	Banorët	Familje	Femra	Meshkuj	Nxënës	Pleqë	Infrastruktura kritike	Objekte të rëndësishme së veçant	Dëmet nga bujqësia dhe blegtoria	Dëmet ekonomike Kostoja
	196	23	101	95	85	18	Dëmtim i instalimit elektrik	Dëmtim i shkollës fillore dhe objekteve	Dëmtim e i florës e faunës dhe kullës	67.000,00

								private		
--	--	--	--	--	--	--	--	---------	--	--

Pasojat

- Dëmet materiale (Dëmtim i shtëpive për shkak zjarreve)
- Degradim i natyrës
- Dëmtim maleve dhe kullosave
- Zjarret nëpër deponi të lëndëve lehtë ndezëse, objekte të rëndësisë së veçantë dhe zjarre fushore

Masat preventive për parandalimin e zjarreve nëpër deponit e karburanteve janë:

-Pajisja me leje pune nga ana e Kuvendit Komunal për të gjitha pompat e derivateve të naftës dhe Gas Butanit, për ata të cilët s'kanë dhe ku lejojnë kushtet ndërtimore dhe i plotësojnë kushtet e caktuara nga Komuna dhe Agjensioni për Menagjimin e Emergjencave (MPB\AME)-ja:

- Kompletimi me pajisje mbrojtëse kundër zjarrit për të gjitha deponit,
- Vendosja e alarmeve të zjarreve,
- Vendosja e hidrantëve,
- Kontrollimi i atesteve të tokëzimeve dhe rrufepritësve, për çdo gjashtë muaj,
- Trajnim i stafit punues nëpër deponi të karburanteve (për zjarrfikës).

Masat parandaluese që rekomandohen për parandalimin e zjarreve nëpër objektet e rëndësisë së veçantë janë:

- Hartim i planit të rrezikshmërisë dhe planit për Mbrojtje dhe Shpëtim,
- Vendosja e pajisjeve për mbrojtje kundër zjarrit, ku hyjnë:
- Vendosja e aparateve për shuarje të zjarrit,
- Vendosja e alarmeve kundër zjarreve,
- Vendosja e hidrantëve, funksionalizimi i atyre që janë ekzistues,
- Vendosja e shkallëve emergjente, etj.

Masat që rekomandohen për parandalimin e zjarreve fushore dhe malore janë:

- Vendosja e hidrantëve aty ku është i shpërndarë rrjeti i ujësjellësit nga KRU Gjakova etj,
- Mos hedhja e mbeturinave nëpër male, sidomos atyre që reflektojnë dritë,
- Pajisja me aparaturë digjitale për vrojtim,
- Koordinim i mirë i punës në mesë të Shërbimit të Zjarrfikje dhe Shpëtim me Agjensionit të pyjeve në komunë , (në sferën e alarmimit dhe reagimit),
- Fushatë për vetëdijesim të popullatës, duke vendosur pano (fotografi) dhe shpërndarë broshura që kanë të bëjnë me vetëdijesimin e opinionit, turistëve e veçmas nxënësve për rëndësinë e pyjeve dhe mbrojtjen e tyre,
- Paralajmërimi i popullatës për vendndodhjen e zjarreve përmes mediave elektronike dhe të shkruara lokale dhe vendosja e shenjave paralajmëruese, etj.

9 ASETET E TRASHËGËMISË NATYRORE, KULTURORE DHE TURISTIKE

9.1 Gjendja ekzistuese e pasurive natyrore, kulturore dhe turistike²⁶

Komuna e Rahovecit së bashku me disa komuna të Kosovës janë të pasura me Lokalitete dhe monumente arkologjike të trashëgimisë natyrore e kulturore.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, respektivisht Departamenti I Trashigëmis Kulturore është institucioni përgjegjës për futjen në mbrojtje të monumenteve në territorin e Kosovës.

Lista e Trashëgimisë Kulturore përpilohet nga ana e Qendrave regjionale për Trashëgëmi Kulturore (QRTK), që janë në varësi të ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Dhe gajtë hulumtimeve të bëra është hasur në dy lista të cilat më pas kurorizohen me listën zyrtare.

Lista e Objektet të Evidentuara

-paraqet listën e monumenteve të evidentuara nga përgjegjësit e QRTK-ve në Kosovë, me rastin e hulumtimit në terren.

Në Komunën e Rahovecit gjenden gjithsej 70 objekte të evidentuara gjatë viteve 2002-2003.

Lista e Monumenteve në mbrojtjen e trashëguar nga periudhat e mëparshme (nga pushteti Jugosllav)

-e cila është bartur direkt në listën e mbrojtjes. Nga kjo listë në Komunën e Rahovecit gjenden 9 lokalitete në kategorinë Trashëgëmi Arkeologjike dhe 1 monument në kategorinë Trashëgëmi Arkitekturore.

Lista e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përkohshme

-paraqet listën zyrtare të miratuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Në këtë listë, në Komunën e Rahovecit gjenden gjithsej 12 lokalitete në kategorinë Trashëgëmi Arkeologjike dhe 17 monumente në kategorinë Trashëgëmi Arkitekturore.

Nga hulumtimet dhe analizat e bëra në terren që janë bërë për 29 monumente që gjenden në Listën e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përkohshme për vitet 2012-2013.

Në listën e fundit të Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përkohshme (2015-2016) në Komunën e Rahovecit janë përfshirë 18 Monumente në kategorinë Trashëgëmi Arkeologjike dhe 20 Monumente në kategorinë Trashëgëmi Arkitekturore, duke e rritur numrin total në 38 Monumente.

Kategoria: Trashëgëmi Arkeologjike

Nënkategoria: Monument/Ansambël

Nr.	Emërtimi	Periudhat	Vendi	Statusi	Nr. Unit në Databazë
19.	Kisha e Shortarisë (Manastiri I Zoçishtës)	Mesjetë	Zoçishtë	494/54	003126
41.	Kisha Bërnjaçë	Mesjetë	Bërnjaçë	553/66	003132

Nënkategoria: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat

Nr.	Emërtimi	Periudhat	Vendi	Statusi	Nr. Unit në Databazë
150.	Kisha varrezore e Shën Nikollës	Mesjetë	Hoçë e Madhe	02-237/58	003/28
151.	Kisha varrezore e Shën Gjonit	Mesjetë	Hoçë e Madhe	02-54/58	003/29

²⁶ Plani Lokal I Trashëgimisë Kulturore 2012-2015 CHwB & Komuna e Rahovecit

152.	Lokiteti Arkeologjik romak në Pozhigë	Romake	Bellacërk	02-460/58	003009
154.	Gërmadhat e Kishës “Shpëtimi i Shenjët”	Mesjetë	Opterushë	558/66	003134
155.	Gërmadhat e Gjytetit	Parahistori, Antikë	Zatriq	998/67	003017
156.	Gërmadhat e kishës së Shën Llukës	Mesjetë	Hoqë e Madhe	199/67	003000
157.	Kështjella	Antikë e Vonë	Gexhë	02-251/68	002995
242.	Varrezë Mesjetare	Mesjetë	Vranjak	Propozuar	003427
243.	Varrezë Mesjetare	Mesjetë	Celinë	Propozuar	003428
244.	Terma-Banjo Romake	Shek.I-IV	Çifllak	Propozuar	003429

Kategoria: Trashëgëmia Arkitekturore
Nënkategoria: Monument/Ansambël

Nr.	Emërtimi	Periudhat	Vendi	Statusi	Nr. Unit në Databazë
417.	Teqja Halveti	Shek. XIX	Rahovec	02-251/68	001774
691.	Kullë-Shtëpi e Qamil Vuçitërnës	Shek. XX	Rahovec	Propozuar	001789
692.	Kulla e Hajrulla Qantës	Shek. XVIII	Rahovec	Propozuar	001791
693.	Kroni i Vjetër	Shek. XVIII	Rahovec	Propozuar	001792
694.	Teqja e Melamive	Shek. XIX	Rahovec	Propozuar	001793
695.	Xhamia e fshatit	Shek. XVIII	Zatriq	Propozuar	001798
696.	Konaku i Manastirit të Deçanit	Shek. XVIII	Hoqë e Madhe	Propozuar	003412
697.	Shtëpia e familjes Spasiq	Shek. XIX	Hoqë e Madhe	Propozuar	003413
698.	Xhamia e fshatit	Shek. XIX	Pastasellë	Propozuar	001083
699.	Kulla e Ismet Cmegës	Shek. XIX-të	Rahovec	Propozuar	003414
700.	Minarja e Xhamisë së fshatit	Shek. XVIII-të	Drenoc	Propozuar	001805
701.	Xhamia e fshatit	Shek. XVIII-të	Xërxë	Propozuar	001816
702.	Ura e Gurit	Shek. XIX-të	Bella Cërk (Fortesë)	Propozuar	003415
703.	Sahat Kulla	Shek. XVIII-të	Rahovec	Propozuar	003414
704.	Xhamia e Kasumit	Shek. XIX-të	Rahovec	Propozuar	001769
705.	Xhamia e Sokolit	Shek. XVIII-të	Rahovec	Propozuar	001772

Nënkategoria: Fusha e konzervimit arkitekturor

Nr.	Emërtimi	Periudhat	Vendi	Statusi	Nr. Unit në Databazë
1181.	Fshati Hoqë e Madhe	-	Fshati Hoqë e Madhe	LZVM	-

Lista e Objekteve Sakrale

Në bazë të dhënave komunale objektet sakrale që janë në vendbanimet e komunës së Rahovecit janë:

Tabela17. Objektet sakrale

Nr	Likacioni	Objekti	Viti i ndertimit	Vërejtje
01	Rahovec	Xhami e vjeter tani e re	1606	Ndertimi i ri 2000-2005
02	Rahovec	Xhami e vjeter tani e re	1720	2006-2008

03	Rahovec	Xhmia e Kasumit	1826	
04	Rahovec	Xhamia e Haxhi Qamil Kasapit	1994/96	
05	Rahovec	Xhamia e Sokolit	1824	
06	Xërxë	Xhami	1797	
07	Fotesë		1810	
08	Krushë e madhe		XIX-XX	
09	Celinë		1919	
10	Hoqë e vogël		1920	
11	Brestovc		1598	2007-2008
12	Apterushë		1860	
13	Reti		1945	
14	Reti e ulët		1947	
15	Drenovc		1710	
16	Pastasel		1820	
17	Zoqishtë		1990	
18	Nagavcë		1997	
19	Malsi e vogël		2004-2005	
20	Ratkovc			
21	Gurakuq			

Nr	Lokacioni	Objekti	Viti i ndertimit
01	Rahovec	Teqe e Melamive Qarshi	XIX
02	Rahovec	Teqe e Helvetive	1732
03	Rahovec	Telqe e Rufai	XX

Nr	Lokacioni	Objekti	Viti i ndertimit
01	Rahovec	Tyrbe	
02	Potoqan i Ulët	Tyrbe	XVIII
03	Polluzhë	Tyrbe	XIX
04	Hoqë e vogël	Tyrbe	
05	Denjë	Tyrbe	
06	Dabidol	Tyrbe	

Nr	Lokacioni	Objekti
01	Rahovec	Kishë - 1
02	Bërnjak	Kishë - 1
03	Hoqë e Madhe	Kishë - 7
04	Zoqishtë	Kishë - 1

9.1.1 Monumentet natyrore²⁷

Llojllojshmëria e monumenteve natyrore të karakterit botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik të Komunës së Rahovecut, si dhe peizazheve të ndryshme natyrore, që kanë përhapje në territorin e komunës konsiderohen vlera të trashëgimisë natyrore.

Në territorin e komunës së Rahovecut shtrihet një pjesë e sipërfaqes së zonës së mbrojtur të Kanjonit të Drinit të Bardhë te Ura e Fshejt, Monument natyror me karakter hidro-

²⁷ Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020

geomorfologjik që është shpallur në vitin 1986, me sipërfaqe 126.5 ha dhe Parku regjional i Mirushes 198.77 ha 1983 Monnument natyre me ujvara te njepasnjëshme


Për shkak të vlerave natyrore janë propozuar për mbrojtje edhe këto monumente të natyrës

1. Kaznik – Trungu I Frasherit (*Francinus excelsior*)
2. Kaznik – Trungu I Shpardhit (*Quercus frainneto*)
3. Drenoc – Trungu I Shpardhit (*Quercus frainneto*)
4. Nagavc – Trungu I Bungut (*Quercus petraea*)
5. Bratotin – Trungu I Qarrit dhe Trungu I Vidhit (*Quercus cerri* & *Ulmus minor*)
Trungu I Shpardhit (*Quercus frainneto*)

Burime të ujit 2 (burime), çerdhe për zogj gjahu 1, Moqalishte 1, Monumente natyrore 1, Varrezat e dëshmorëve/Lapidar 1.

Janë hasur edhe gjurmë të kafshëve të egra të mëdhaja grabitqarë të ariut dhe ujkut, shpezë grabitqarë, drunjë të vjetër, puse të ujit për pije etj.

Harta 17. Tashëgimija kulturore dhe natyrore



Harta 20_ Trashëgimia natyrore dhe kulturore

9.1.2 Parqet kombëtare, sipërfaqet e mbrojtura dhe zonat e vecanta të mbrojtura brenda territorit të komunës

Sa i përket zonave të veçanta të mbrojtura për komunën e Rahovecit duhet respektuar dhe zbatuar: Ligji Nr. 03/L-039 PËR ZONAT E VEÇANTA TË MBROJTURA. Në këtë komunë janë dy zona që kanë karakter të veçantë të mbrojtjes :

1. Manastiri i Zoqishtës, Zoqishtë, dhe
2. Fshati Hoqë e Madhe, Hoqe e Madhe

9.1.2.1 Dispozitat e Veçanta për Fshatin Hoqa e Madhe²⁸

Fshati i Heqës së Madhe, i përshkruar në pikën m) paragrafi 1 i nenit 7 të këtij ligji do të ketë të drejtën, në konsultim me komunën e Rahovecit, që të ushtrojë autoritet të kufizuar mbi aktivitetet nga fusha e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe fetare, dhe nga fusha e planifikimit rural duke respektuar Zonën e saj të Veçantë të Mbrojtur, në përputhje me dispozitat relevante të legjislacionit mbi Vetë-Qeverisjen Lokale dhe parimet e Deklaratës Universale të UNESCO-s mbi Diversitetin Kulturor.

KZM-ja do të lehtësojë konsultime të tilla.

Aplikimi i nenit 6 të këtij ligji për çdo aktivitet të ri në Zonën e Veçantë të Mbrojtur për fshatin e Hoqës së Madhe do të përcaktohet me një Ligj.

Objektet e propozuara nga Drejtoria për kulturë, sport dhe rini

- Sahat Kulla, Rahovec
- Vendi i rënies së dëshmorëve Toni e Mici në Apterushë
- Varrezat e Dëshmorëve në Rahovec
- Përmendorja e Tonit e Micit në Rahovec
- Shtabi i UÇK-së në Drenoc
- Shtabi i UÇK-së njësi "Arti" në Rahovec
- Maja e Shkodranit në Rahovec
- Xhamia e Qarshisë në Rahovec
- Kulla e Meriqëve në Rahovec
- Kroji i Haxhinjve në Rahovec
- Kroji i në Sheshin e Republikës
- Kështjella (kalaja e Durmanit) në Rahovec
- Arti në gur në Zatriq
- Kisha Ortodokse në Rahovec
- Varrezat Bizantine në Reti
- Kulla e Mahmut Pashës dhe varrezat Bizantine në Opterushë
- Ura e Shenjtë në Drini i Bardhë
- Shtëpia muze e Ukshin Hotit në Krushë të Madhe
- Varrezat e Shtavicës
- Bodrumi i Vjetër në Rahovec
- Vendi ku u zhvillua beteja e Gradishit (Gegjë)

²⁸ Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020

- Pika e vrojtimit të UÇK-së “Vlora” në Drenoc
- Vendi i fushëbetejës së UÇK-së në Guri të Kuq
- Fushëbeteja në Bratotin-Ratkoc (12 maj 1998)
- Beteja në Fortesë (18 korrik 1998) në Fortesë
- Shtabi i UÇK në Reti
- Beteja e Kramovikut (1998) në Kramovik

10 VENDBANIMET

10.1 Gjendja ekzistuese dhe shtrirja hapësinore e vendbanimeve

Tipizimi i vendbanimeve sipas madhësisë është njëra ndër metodat më të rëndësishme për të pasqyruar karakteristikat e sistemit popullativ të hapësirës së caktuar si dhe mënyrën dhe cilësinë e jetës në vendbanimet e asaj hapësire, sepse vendbanimi më i madh nënkupton mënyrën e jetës më cilësore në shumë aspekte.

Pikërisht nga kjo arsye vendbanimet kategorizohen sipas madhësisë populatave dhe në bazë të shumë analizave të kësaj problematike përcaktohen pikat strategjike për zhvillim të mëtejshme të komunës apo edhe më gjerë.

Vendbanimet sipas madhësisë demografike në komunën e Rahovecit mund t'i kategorizojmë në:

Vendbanimet e vogla rurale, të mesme rurale, të mëdha rurale dhe vendbanimet e karakterit urban. Vendbanimet sipas madhësisë në komunën e Rahovecit mund t'i kategorizojmë në këto grupe të madhësisë:

- I. Vendbanimet e vogla deri 500 banorë.
- II. Vendbanimet e madhësisë së mesme 500 – 999 banorë
- III. Vendbanimet e madhësisë 1000-1999 banorë.
- IV. Vendbanimet e mëdha rurale 2000-4999 banorë.
- V. Vendbanimet e karakterit urban

Kategorizimi	Nr.	Vendbanimi	Nr.i banoreve
Vendbanime me nr. ban. deri 500 b	01	Sarosh	6
	02	Bërnjak	40
	03	Hoqe e Madhe	124
	04	Kaznik	164
	05	Mrasor	191
	06	Nushpal	220
	07	Retijë e Ulet	234
	08	Bratotin	396
Vendbanime me nr. ban. deri 500-999 b	01	Pataqan I Eperm	533
	02	Zatriq	535
	03	Zoqishtë	659
	04	Gexhë	660
	05	Senoc	687
	06	Petkoviq	731
	07	Nagavc	743
	08	Retijë	771
	09	Dobidol	799

	10	Polluzhë	808
	11	Vrajakë	838
	12	Sapniq	996
Vendbanime me nr. ban. deri 1000-1999 b	01	Pastasellë	1011
	02	Pataqan I poshtem	1077
	03	Kramovik	1125
	04	Hoqe e Vogel	1166
	05	Brestovc	1288
	06	Çifllak	1292
	07	Drenoc	1587
	08	Dejnë	1757
	09	Celinë	1903
	10	Opterushë	1911
Vendbanime me nr. ban. deri 2000-4999 b	01	Bellacerkë	2270
	02	Radostë	2346
	03	Xërxë	3184
	04	Ratkoc	3791
	05	Krushe e Madhe	4473
Vendbanim Urban	01	Rahovec	15892

Në bazë të këtij kategorizimi, , në grupin e vendbanimeve të vogla, me më pak se 500 banorë janë vetëm 8 vendbanime, ku Saroshi ka me se paku banore (9b) e deri te Bratotini me 396b. Pastaj si kategori e dyte ku perfhihen vendbanimet me numer te banoreve nga 500 banore deri 999 baore jane gjithsej 12 vendbanime: Pataqan I Epermme 533banore deri te Sapniq 996 banore.


Si kategori e tret me numë te banorëve nga 1000 banore 1999 banore janë 10 vendbanime: Pastasellë me 1011 banore deri te Opterusha me 1911 banorë.

Kategoria e katert ajo me vendbanime qe kan numer te banoreve nga 2000 banore deri në 4999 banorë jane vetem 5 vendbanime: Bellacerka me 2270 banorë deri te Krusha e Madhe me 4473 banore.

Ndersa si vendbanim me karakter Urban është Rahoveci me 15892 banore.

Vendbanimi Rahovec, si qendër komunale, shtrihet rrëzë shpateve të malit Opterushë, afër rrugëve të rëndësishme që lidhin dy qendrat më të rëndësishme të Kosovës; Prishtinën e Prizrenin dhe më gjerë. Pozita e volitshme e vendbanimit rrëzë kodrinave duhej të ishte atraktive për banim që nga lashtësia.

Harata 5. Vendbanimet sipas madhësisë



Harta 21_Shpërndarja e popullsisë

Në aspektin hapësinor Rahoveci si vendbanim i takon tipit të grumbulluar të vendbanimeve. Ndërsa në aspektin funksional është qendër e rëndësishme për territorin administrativ prej

275.89 km² dhe gravitimin e popullsisë prej 56208 banorë, të shpërndarë në 36 vendbanime.

Zona kadastrale e Rahovecit zë sipërfaqen prej 4894 ha, ndërsa zona e ndërtuar arrin në 255ha, duke mbuluar 5.2% të territorit kadastral, me dendësinë e banimit prej 62.32 b/ha.

Per nga numri i banorëve, madhësia mesatare e vendbanimeve në komunën e Rahovecit është 1561 banorë, ndërsa nëse llogarisim vetëm numrin e popullsisë së vendbanimeve rurale, pa qytetin e Rahovecit, atëherë madhësia mesatare e vendbanimeve për nga numri i popullsisë është 1151 banorë.

Përfaqësimi i disa vendbanimeve të kategorive të mëdha në rrjetin e vendbanimeve ka ndikim të rëndësishëm në organizimin e hapësirës dhe sistemin funksional të vendbanimeve.

10.1.1 Shtrirja hapësinore e vendbanimeve sipas madhësisë


Karakteristikë për komunën e Rahovecit është numri më i madh i vendbanimeve, i grupit të vendbanimeve të mëdha dhe të kategorisë së mesme, ndërsa rreth 20% e territorit (viset kodrinore-malore mbi 600 m) është e banuar më rrallë dhe me vendbanime të vogla.

Në zonën e ulët nën 400 m ka më së shumti vendbanime që i takojnë kategorisë së vendbanimeve të mëdha (2000-5000 banorë) 12 vendbanime, ose 92.3% të kësaj kategorie dhe vendbanimet e kategorisë së mesme (1000-2000 banorë) 8 vendbanime ose 72.7% e kësaj kategorie të vendbanimeve shtrihen në këtë zonë.

Zona kodrinore-malore mbi 600 metra karakterizohet me vendbanime të vogla të kategorisë 500-999 banorë, në të cilën zonë shtrihen vetëm 3 vendbanime: Kazniku, Zatriqi, dhe Drenoci shtrihen në këtë zonë. Pothuajse të gjitha vendbanimet në komunën e Rahovecit kanë pasur rritje nga viti 1991-2010 (përveç vendbanimit Zatriq që ka zvogëlim të numrit të popullsisë, ndërsa disa vendbanime që kanë terren të pa volitshëm kanë rritje të ngadalsuar të popullsisë.

Tabela 6. Struktura e vendbanimeve sipas madhësisë demografike, 1991-2010-2018

Vendbanimet sipas kategorive të madhësisë	Numri i vendbanimeve					
	1991	%	2010	%	2018	%
0-499	7	20	6	16.6	8	22.2
500-999	10	28.6	10	27.8	12	33.3
1000-1999	10	28.6	10	27.8	10	27.7
2000-4999	7	20	8	22.2	5	13.8
Mbi 5000	1	2.8	2	5.6	1	2.7
Gjithsej	35	100	36	100	36	100



Grafiku 14. Ndryshimet në numrin e vendbanimeve sipas madhësisë demografike, 1991-2010-2018

Nga tabela dhe Grafiku vërehen ndryshime shumë të rëndësishme pozitive në strukturën e vendbanimeve nga se vendbanimet e kategorisë së vogël deri në 500 banorë kanë pasur zvogëlim në numër, nga 7 sa ishin në vitin 1991, në 6 në vitin 2010, ndersa ne vitin 2018 rritet në 8.

Vendbanimet e kategorisë 500-999 banorë nuk janë shtuar në numër, nga 10 sa ishin në vitin 1991, mbetën sërish në 10 vendbanime në vitin 2010, por rritet në vitin 2018 në 12.

Gjithashtu edhe vendbanimet e kategorisë 1000-1999 banorë mbetën në numër të njetë, nga 10 sa ishin në vitin 1991, në 10 vendbanime në vitin 2010, dhe 10 në vitin 2018.

Ndërsa, vendbanimet e mëdha të kategorisë 2000-4999 banorë e kanë rritë numrin nga 7 në vitin 1991 në 8 në vitin 2010, dhe në vitin 2018 bie në 5. Dhe në fund, numri i kategorisë së vendbanimeve mbi 5000 banorë është rritë nga 1 sa ishte në vitin 1991, në 2 në vendbanime në vitin 2010 (Rahoveci, Krusha e Madhe), dhe 1 në vitin 2018.

Pra në përgjithësi vërehet një rritje e përgjithshme e numrit të popullsisë pothuaj se në të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit. Ky trend i zhvillimit është brenda rrjedhave normale të zhvillimit demografik bazuar në shkallën pozitive të shtimit natyror të popullsisë.

10.1.2 Karakteri urban/rural

Pothuajse të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit janë formuar në mënyrë spontane. Ndërsa forma e tyre e parregullt është si pasojë e kushteve natyrore në terren, por edhe faktorëve shoqëror-ekonomik dhe historik.

Rahoveci si qendër komunale dhe i vetmi vendbanim i karakterit urban vetëm me një pjesë të vogël mund të konsiderohet me plan. Shikuar në aspektin e strukturës morfologjike-urbanistike, dallohen këta tipa të vendbanimeve:

10.1.3 Tipi i grumbulluar i vendbanimeve²⁹

Strukturën e këtyre vendbanimeve e karakterizon koncentrimi i madh i objekteve ndërtimore, oborreve ekonomike etj, kurse numri më i madh i parcelave për nga madhësia e sipërfaqeve është e vogël. Ky tip i vendbanimeve kryesisht është prezent në zonën e ulët të fushës. Oborret ekonomike janë të madhësive të ndryshme, por zakonisht me sipërfaqe të vogla. Ndërsa ato janë të shfrytëzuara në mënyrë maksimale, qoftë në pjesën e përparme, kah rruga, apo në pjesën e mesme të tyre. Në këto vendbanime është e theksuar çartë zona e ndërtimit që është e ndarë nga zona e punës.

Në bazë të konsultimit të hartave topografike dhe kadastrale, është vlerësuar se shumica e këtyre vendbanimeve kanë pozitë të përshtatshme në raport me zonat e tyre kadastrale dhe janë të lidhura mjaft mirë mes veti si dhe me qendrat tjera të rendit më të lartë.

Te këto vendbanime kohët e fundit vërehet një formë e re e ndërtimit, sidomos përgjatë vijës së asfaltuar të vendbanimit me karakter rendor të objekteve. Kjo ndodh kryesisht për t'u liruar nga dendësia e madhe dhe afrimi në rrugën kryesore. Ky proces mund të quhet transferimi i fshatit nga tipi grumbullor në tip rendor ose zbritja e fshatit në rrugë.

Te këto vendbanime në disa raste vërehet edhe procesi i aglomerimit ose bashkimit të tyre për shkak të zgjerimit dhe afërsisë së tyre, varësisht nga kushtet gjeomorfologjike të terrenit: Brestoc - Hoqë e Vogël - Nagavc-Krushë e Madhe - Celinë, pastaj Xerxë –Gexhë – Radost – Ratkoc – Dejnë - Dabidol, si dhe Drenoc – Senoc - Pastasellë. Për shkak të zgjerimit dhe formës aglomerative në hapësirë këto vendbanime në të ardhmen nuk mund ta ruajnë kuptimin e fshatit.

Lidhur me vendbanimet e tipit të dendur mund të konstatohet se ky tip i vendbanimeve në krahasim me tipin e shpërndarë të fshatit është shumë më i përshtatshëm sepse ato paraqesin mundësitë për përmirësimin e kushteve dhe cilësisë së jetës me pajisje urbane dhe objekte të standardit shoqëror.

10.1.4 Tipi i zgjatur (linear)

Këto vendbanime i takojnë tipit të dendur rendor dhe shtrihen kryesisht në sipërfaqe të rrafshëta dhe përgjatë rrugëve magjistrale ose lokale në zonën e ulët: Drenoc, Senoc, Pastasellë, Brestoc, Hoqë e Vogël, Nagavc, Krushë e Madhe, Celinë, Xerxë, Gexhë, Radost, Ratkoc, Dejnë, Dabidol. Këto vendbanime karakterizohen me parcela të vogla ndërtimore. Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është se kanë tendencë të zgjerimit dhe bashkëngjijës duke krijuar kështu korridore ndërtimore përgjatë rrugës. Një proces i tillë ka marrë hov sidomos kohëve të fundit, përkundër faktit se një trend i tillë në aspektin urbanistik dhe hapësinor është i pavolitshëm, ngase ato i përcjellin një mori problemesh e konfliktesh si dhe paraqesin pengesë në zhvillimin normal të komunikacionit ndër-urban. Një numër i vendbanimeve të tipit linear shtrihen në tokat pjellore me objekte të ndërtuara në dy fronte dhe me rrugën në mes.

Nr.	Zona	Nr. Popullesis	Zona e ndertuar (Ha)	Dendeësia (b/Ha)
Zona e ulët nen 600m				
1	Rahovec	15892	255.38	62.2

²⁹ Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020

2	Bellacerkë	2270	58.09	39.1
3	Bërnjak	40	17.83	2.2
4	Bratotin	396	9.31	42.5
5	Brestovc	1288	36.47	35.3
6	Celinë	1903	53.38	35.7
7	Çifllak - Sarosh	1292	29.03	44.5
8	Dobidol	799	15.48	51.6
9	Dejnë	1757	47.27	37.2
10	Xërxë	3184	82.29	38.7
11	Gexhë	660	19.44	34.0
12	Hoqe e Madhe	124	29.00	4.3
13	Hoqe e Vogel	1166	28.24	41.3
14	Kramovik	1125	28.38	39.6
15	Krushe e Madhe	4473	116.78	38.3
16	Mrasor	191	6.03	31.7
17	Nagavc	743	20.60	36.1
18	Nushpal	220	4.21	52.3
19	Opterushë	1911	45.72	41.8
20	Pastasellë	1011	25.35	39.9
21	Pataqan I Eperm	533	11.81	45.1
22	Pataqan I poshtem	1077	22.93	47.0
23	Petkoviç	731	14.65	49.9
24	Polluzhë	808	19.83	40.7
25	Radostë	2346	58.47	40.1
26	Ratkoc	3791	75.89	50.0
27	Retijë e Ulet	234	10.42	22.5
28	Retijë	771	15.44	49.9
29	Sapniç	996	21.96	45.4
30	Senoc	687	25.35	27.1
31	Vrajkë	838	13.79	60.8
32	Zoqishtë	659	11.32	58.2
Zona Kodrinoro-Malore mbi 600m				
33	Drenoc	1587	40.65	39.0
34	Kaznik	164	3.55	46.2
35	Zatriq	535	7.65	69.9

Në tabelë dy vendbanime janë përfshi në një zona kadastrale


Nga tabela shihet se vendbanimet rurale kanë dendësi mjaft të lartë, sikurse Retija, Bratotini, Brestovci, Vrajkë, Sapniç, Bellacerka, ndërsa Rahoveci si qendër e karakterit urban dallohet për nga dendësia e banimit nga shumë vendbanime të tjera, por megjithatë në këtë vendbanim urban ka vend për rritjen e dendësisë edhe për një shkallë që lejohet me standarde për qendra të nivelit të tillë.

Nga sipërfaqja e përgjithshme e komunës, vetëm 1.3 km², ose 4.6 % e territorit është zonë e ndërtuar e mbuluar nga vendbanimet. Këto dispozita janë parakusht për zhvillim të qëndrueshëm dhe mjaft funksional për komunën e Rahovecit.

10.1.5 Numri i banorëve

Nga të dhënat e fundit të regjistrimit të popullësisë rezulton se numri aktual i popullësisë në komunën e Rahovecit është

Nr	Venbanimi	Meshkuj	Femra	Gjithsej
1	Rahovec	8251	7641	15892
2	Bellacerkë	1141	1129	2270
3	Bërnjak	15	25	40
4	Bratotin	194	202	396
5	Brestovc	645	643	1288
6	Celinë	971	932	1903
7	Çifllak	623	669	1292
8	Dobidol	423	376	799
9	Dejnë	886	871	1757
10	Drenoc	812	775	1587
11	Gexhë	341	319	660
12	Hoqe e Madhe	66	58	124
13	Hoqe e Vogel	584	582	1166
14	Kaznik	82	82	164
15	Kramovik	576	549	1125
16	Krushe e Madhe	2210	2263	4473
17	Mrasor	109	82	191
18	Nagavc	369	374	743
19	Nushpal	111	109	220
20	Opterushë	917	994	1911
21	Pastasellë	459	552	1011
22	Pataqan I Eperm	278	255	533
23	Pataqan I poshtem	566	511	1077
24	Petkoviq	386	345	731
25	Polluzhë	407	401	808
26	Radostë	1202	1144	2346
27	Ratkoc	1916	1875	3791
28	Retijë e Ulet	122	112	234
29	Retijë	356	415	771
30	Sapniq	511	485	996
31	Sarosh	1	5	6
32	Sënoc	346	341	687
33	Vrajakë	397	441	838
34	Xërxë	1653	1531	3184
35	Zatriq	260	275	535
36	Zoqishtë	326	333	659
Totali		28512	27696	56208



10.1.6 Funksionaliteti dhe rrjeti ndërlidhës³⁰

Sistemin e vendbanimeve në komunën e Rahovecit e përbëjnë: 1 qendër urbane, në të cilën gravitojnë 35 vendbanime dhe 7 qendra lokale, në të cilat gravitojnë mesatarisht nga 4 vendbanime pa funksione.

Vendbanimet e komunës së Rahovecit mund t'i klasifikojmë sipas funksioneve themelore në këto tipe:

- vendbanimet rurale primare,
- vendbanimet me qendrën rurale,
- qendra komunale.

Grupit të parë të vendbanimeve, të cilat janë pa funksione, i takojnë ato vendbanime në të cilat jeton popullsia që merret kryesisht me bujqësi, ndërsa funksionet eksetrne në këto vendbanime mungojnë. Këto vendbanime paraqesin tërësinë e objekteve banuese dhe ekonomike të prodhuesve bujqësorë. Shumica e këtyre vendbanimeve janë të vendosura më larg qendrës dhe në viset kodrinore, të cilat janë fshatra tipike bujqësore.

Karakteristikë e këtyre vendbanimeve është shkalla e lartë e autonomisë, transformimi i vogël, si dhe lidhje më e dobët me qendrën kryesore. Këto vendbanime në të ardhmen do t'i



Harta 22_Organizimi funksional në Komunë

përcjellin ndryshimet më të ngadalshme nga se prioritet do të ken vendbanimet qendrore.

Me qëllim të ngritjes së standardit jetësor në këto vendbanime duhet gjetur forma dhe mënyra për të stimulimuluar prodhimtarinë bujqësore, zhvillimin e turizmit rural stimulimin e blegtorisë me organizim dhe teknologji bashkëkohore si dhe me ndryshimin e skemës së organizimit funksional përmes nominimit dhe zhvillimit të qendrave dhe bashkësive rurale. Ngritja e standardit jetësor mund të realizohet me lidhjen e vendbanimeve me ndërtimin e rrugëve nga se rruga është parakusht për ekzistencën e këtyre vendbanimeve, pastaj, pajisjen e këtyre vendbanimeve me funksione të domosdoshme me të cilat do të përmbushin nevojat

³⁰ Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020

e përditshme të popullsisë. Si vendbanime primare janë edhe një numër i fshatrave pranë qytetëse me numër të konsiderueshëm të popullsisë jobujqësore që punojnë në qytet dhe funksionojnë të lidhura me qytetin.

10.1.7 Vendbanimet me qendrën rurale

Janë ato vendbanime të cilat i bashkojnë dy e më tepër fshatra primare në një tërësi shoqërore-ekonomike dhe hapësinore. Në këto vendbanime, përveç funksioneve interne, janë të zhvilluara edhe funksionet e jashtme të cilat u shërbejnë edhe popullsisë së vendbanimeve përreth. Këto vendbanime njëherit paraqesin njësitë polarizuese të zonës në hapësirë. Nga funksionet shoqërore, në këto vendbanime ndodhet bashkësia lokale dhe zyra e vendit, shkolla fillore, ambulanca, shitoret me shumicë e pakicë për furnizimin e popullsisë, ndonjë veprimtari zejtare, etj.

Këto vendbanime paraqesin tip kalimtar nga ato tradicionale-bujqësore, në të përziera, sepse në to jeton një numër i konsiderueshëm i popullsisë jobujqësore.

Një numër i konsiderueshëm i këtyre vendbanimeve ndodhet jo larg qytetit. Ato i karakterizon një shkallë mjaft e lartë e transformimit po edhe degradimit. Numri i këtyre vendbanimeve në komunë arrin në 8, duke përfshi edhe qytetin e Rahovecit, ose 23.5% nga numri i përgjithshëm i vendbanimeve rurale. Vendbanimet me funksione qendrore në komunën e Rahovecit janë: Çifllaku, Drenoci, Hoça e Vogël, Krusha e Madhe, Opterushta, Ratkoci dhe Xerxa. Në këto vendbanime tani janë paraqitur shenjat e semi-urbanizimit si pasojë e veprimit të faktorëve urban, në një anë dhe, prodhimtarisë së modernizuar të bujqësisë në anën tjetër.

Shumica e këtyre vendbanimeve i takojnë kategorisë së vendbanimeve të mesme ose të mëdha (mbi 2000 banorë) Ratkoci, Krusha e Madhe, Drenoci, Opterushta, Xerxa, Hoça e Vogël, ndërsa të kategorisë mesme është vetëm Çifllaku me 1292 banorë. Në këto vendbanime gravitojnë mesatarisht 7166 banorë. Ndërsa, nëse e llogarisim edhe Rahovecin si qendër komunale atëherë në këto qendra gravitojnë mesatarisht 8940 banorë.

Në grupin e vendbanimeve urbane bën pjesë vetëm Rahoveci si qendër komunale në të cilën janë të vendosura funksionet shoqërore-ekonomike që i shërbejnë tërë territorit,

10.1.8 Lloji dhe lartësia mbidetare³¹

Rrjetin e vendbanimeve në komunën e Rahovecit e përbëjnë 36 vendbanime, nga të cilat dallohet qendra komunale dhe 7 qendra tjera lokale, në të cilat qendra gravitojnë 27 vendbanime, prej të cilave vetëm Rahoveci është vendbanim i karakterit urban me 21354 banorë, ose rreth 30% e popullsisë së komunës, ndërsa vendbanimet tjera janë rurale, me numrin e popullsisë rurale prej 50168 banorë ose rreth 70% të popullsisë së komunës.

Tabela 8. Karakteristikat e rrjetit të vendbanimeve dhe dendësia e popullsisë në km²

Nr.	Zona	Nr. Popullesis	Siperfaqe km ²	Banore në 1km ²
Zona e ulët nën 600m				
1	Rahovec	15892	48.9	325
2	Bellacerkë	2270	11.0	206
3	Bërnjak	40	4.5	9

³¹ Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020

4	Bratotin	396	3.1	128
5	Brestovc	1288	5.8	222
6	Celinë	1903	5.7	334
7	Çifllak - Sarosh	1292	4.8	269
8	Dobidol	799	3.5	228
9	Dejnë	1757	6.4	275
10	Xërxë	3184	10.1	315
11	Gexhë	660	3.2	206
12	Hoqe e Madhe	124	13.5	9
13	Hoqe e Vogel	1166	7.0	167
14	Kramovik	1125	10.3	109
15	Krushe e Madhe	4473	10.0	447
16	Mrasor	191	3.2	60
17	Nagavc	743	3.1	240
18	Nushpal	220	0.6	367
19	Opterushë	1911	9.0	212
20	Pastasellë	1011	5.4	187
21	Pataqan I Eperm	533	2.3	232
22	Pataqan I poshtem	1077	5.5	196
23	Petkoviç	731	10.0	73
24	Polluzhë	808	5.7	142
25	Radostë	2346	10.3	228
26	Ratkoc	3791	11.8	321
27	Retijë – Retij e ulët	1005	9.8	103
28	Sapniç	996	4.9	203
29	Senoc	687	4.4	156
30	Vrajakë	838	4.9	171
31	Zoqishtë	659	5.2	127
Zona Kodrinoro-Malore mbi 600m				
32	Drenoc	1587	8.2	194
33	Kaznik	164	8.3	20
34	Zatriq	535	15.2	35

Madhësia mesatare e vendbanimeve është 1650 banorë, ndërsa dendësia mesatare e popullsisë arrin në 192 banorë në km², por me dallime të konsiderueshme, varësisht nga karakteristikat gjeo-morfologjike të terrenit.


Harat 7. Rrjeti i vendbanimeve

Në zonën e ulët nën 400 metra të lartësisë mbidetare me sipërfaqe prej 112.20 km² me numër të banorëve 46290 b, shtrihen 22 vendbanime nga numri i përgjithshëm i vendbanimeve të komunës, me dendësi mesatare prej 412.7 b/km². Kjo njëherit është edhe hapësira me dendësi më të madhe në komunë, 2 herë më e lartë se mesatarja e komunës dhe 10.3 herë më e lartë se në viset kodrinore malore.

Në zonën 400-600m lartësi mbidetare shtrihen gjithsej 11 vendbanime me numër të banorëve 13362b. Kjo zonë ka një sipërfaqe prej 108.44 km² dhe dendësi 123.2b/km².

Në zonën 600-800m lartësi mbidetare shtrihet 1 vendbanim me 167b. Kjo zonë ka një sipërfaqe prej 38.59 km². Dendësia mesatare për këtë zonë është 4.33b/km².

Ndërsa zona me mbi 800m lartësi mbidetare ka një sipërfaqe prej 16.91 km² dhe shtrihet vetëm një vendbanim me 535b, dhe dendësi mesatare 31.63b/km².




Harta 23_Rrjeti i vendbanimeve

Tabela 10 . Dendësia e popullsisë sipas zonave të lartësisë mbidetare në komunë,

Zonat e Komunës	Numri i vendbanimeve	Sipërfaqja e zonës në km ²	Numri i banorëve	Dendësia e popullsisë në km ²
Nën 400m	22	112.2	46290	412.7
400m-600m	11	108.44	13362	123.2
600m-800m	1	38.59	167	4.33
Mbi 800m	1	16.91	535	31.63

Harta 8. Hipsometria e terrenit



Harta 24_Hipsometia e terrenit

Zona kodrinore-malore zë pozitën veriore të komunës, është kryesisht e pazhvilluar ekonomikisht dhe me infrastrukturë pak të zhvilluar.

Zona e ulët fushore ndodhet në jug, me veçori tjera demografike dhe kushte më të volitshme për zhvillim. Këto parametra tregojnë edhe për pozitën e volitshme të territorit të ekspozuar jugut dhe jug-lindjes, që është një komponentë e rëndësishme në planifikimin hapësinor.

Zona e ulët karakterizohet me dendësi të madhe të popullsisë në të cilën dominojnë vendbanimet e kategorisë së mesme dhe të mëdha (shumica e vendbanimeve kanë mbi 2000 banorë). Kjo tërësi hapësinore në kuptimin demografik është më stabile, sepse procesi i

shpërnguljes së popullsisë së këtyre vendbanimeve drejt qendrave urbane është në rrjedhat normale. Në anën tjetër, rritja popullore e vendbanimeve dhe transformimi fizik i tyre është shumë më i shpejtë në krahasim me vendbanimet kodrinore-malore. Për të treguar vlerën e një hapësire, rëndësi të veçantë ka analiza e dendësisë së popullsisë.

11 BANIMI

11.1 Gjendja ekzistuese e banimit dhe modelet e banimit³²

Në komunën e Rahovecit, sipas shënimeve më të reja, të siguruara nga institucionet komunale, jetojnë 56208 banorë në sipërfaqen prej 275.89 km².

Pjesa dërmuese e popullsisë në komunën e Rahovecit jeton në fshat, rreth 70 % e popullsisë. Vetëm 29.8 % e saj jeton në qendrën e vetme urbane të kësaj komune me qendër në Rahovec.

Banimi pothuajse në tërësi është i karakterit individual, pasi që në vet qendrën urbane ka numër të vogël të banesave të karakterit kolektiv, vetëm 13 blloqe banesore me nga pesë kate, që zë vetëm 0.5 ha të sipërfaqes së qytetit, ose rreth 3% të sipërfaqes së përgjithshme të hapësirës së banimit në zonën urbane. Kjo është vetëm 1% e sipërfaqes urbane të Rahovecit.

11.1.1 Numri i njësive të banimit

Numri i përgjithshëm i objekteve të banimit në kuadër të komunës së Rahovecit është 14288, nga e cila shumë, 10146 objekte, ose 71% janë të ndërtuara në zonat rurale, 4142 objekte të banimit, ose 29 % e tyre janë të ndërtuara në zonën urbane.

Në zonën e ulët të fushës vendbanimet zakonisht janë të tipit të grumbulluar, prandaj edhe dendësia e banimit është më e madhe. Në viset kodrinore-malore shumica e tyre janë vendbanime të vogla dhe me dendësi më të vogël të banimit.

Pra, faktorët natyror kanë ndikuar dukshëm në formën dhe dendësinë e vendbanimeve. Te vendbanimet që ndodhen afër qendrës urbane dhe, atyre afër rrugëve, vërehen tendencat e zhvillimit linear, duke i përcjellë vijat komunikative. Për këtë arsye, objektet e banimit dhe ato të bizneseve shtrihen në formë vargore. Kjo arsyetohet edhe me faktin se popullsia vazhdimisht po heq dorë nga bujqësia.

Numri më i madh i objekteve të banimit është ndërtuar në zonën e ulët të fushës, që njëkohësisht është edhe hapësira më e banuar. Për nga cilësia e materialit ndërtimor, sipërfaqes së ndërtuar dhe pajisjes së hapësirës banuese, kjo hapësirë gjithashtu disponon me një fond më cilësor banesor.

11.1.2 Analizë e kushteve të banimit, rekomandimet si dhe përmirësimin e kushteve banimit

Objekte të vjetra banimi ka fare pak sepse materiali i dobët i tyre nuk ka mundur t'i përballojë kohës. Objektet e banimit dhe oborret kanë dallime, varësisht nga vendi i ndërtimit, si: qyteti, vendbanimet pranë qytetit, vendbanimet kodrinore-malore.

Shumica e objekteve të banimit janë të rrethuara me mure, ndërsa në oborre dallohen edhe objektet tjera ekonomike bujqësore.

³² Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020

Deri vonë objektet e banimit ndërtoheshin me material të dobët; qerpiçi dhe druri, që zakonisht forma e objekteve i ngjanë shkronjës L . Në këto dekadat e fundit objektet e banimit kanë ndryshuar tërësisht si në formë ashtu edhe në cilësi. Tani objektet e banimit ndërtohen me një e më shumë kate, që zakonisht kanë kulmet në dy ujëra, ndërsa janë të ndërtuara me material të fortë ndërtimor si; tulla, blloka të pjekur, betoni e hekuri. Kështu që objektet e ndërtuara të banimit në fshat fare pak dallojnë me ato në qytet. Nuk ka ndonjë stil unik të ndërtimit të objekteve të banimit.

Dendësia e banimit brenda zonës së ndërtuar, në vendbanimet rurale, është mjaft e lartë dhe është e përafërt me shumë qytete të vogla të Kosovës dhe këto vlera sillen rreth 50 banorë në ha.

Ndërsa, në qendrën e vetme urbane, në Rahovec, dendësia e banimit arrin në 85 banorë në ha, me mundësi të rritjes në të ardhmen, për të arritë në rreth 100 banorë për ha.

Gjendja e banimit në vendbanimet rurale dhe në vet qytetin e Rahovecit u dëmtua rëndë në luftën e fundit, gjatë së cilës u shkatërruan një numër i madh i objekteve të banimit dhe ekonomike, ndërsa pasojat po evitohen me kalimin e kohës.

Hapësira e banimit në raport me sipërfaqet e ndërtuara është dominante, me rreth 90% në raport me zonën e ndërtuar në nivelin komunal, ndërsa në qytet ajo dominon me rreth 80 %. Kjo tregon se aktivitetet tjera janë në nivel shumë të ulët të zhvillimit, sidomos për qytetin, ndërsa në vendbanimet rurale, përveç objekteve të banimit, janë prezente edhe një numër i konsiderueshëm i objekteve përcjellëse ekonomike.

Numri i anëtarëve për ekonomi familjare lëvizë nga 7.7 anëtarë në vendbanimet rurale, në 6.3 anëtarë në qendrën urbane. Këto parametra tregojnë për një gjendje jo të favorshme të standardit jetësor krahasuar me vendet e zhvilluara në të cilat numri i anëtarëve për ekonomi familjare sillet rreth 2 antarë. Në bazë të këtyre llogaritjeve del se nevojat për banesa në komunën e Rahovecit, krahasuar me vendet e zhvilluara të Evropës, janë shumë të mëdha dhe në bazë të këtyre standardeve numri i banesave së paku duhet dyfishuar.

Sipërfaqja e banimit për banorë është me sa vijon: 18.8 m² për anëtarë në nivel të komunës, 19.5m² për anëtarë në vendbanimet rurale dhe në 17.1 m² për anëtarë në qytet.

Kjo gjendje është e pavolitshme në këto tri nivele.

Në komunën e Rahovecit ka familje me kushte ekonomike që nuk janë në gjendje të kenë shtëpi të përballueshme. Duke i'u referuar të dhënave mbi varfërinë, sipas paragrafit të mësipërm 12,35% e popullsisë jeton me 1 \$ ditë / për person dhe 69,57% e popullsisë jetojnë me 2 \$ ditë /për person. Përveç kësaj 590 familje janë nën asistencë sociale (përafërsisht 37% e popullsisë). Të dhënat e përmendura më sipër tregojnë nevojën për ofrimin e programeve e veçanta të banimit.

12 VENDBANIMET JOFORMALE


12.1 Gjendja ekzistuese dhe shtrirja hapësinore e vendbanimeve joformale

Në komunën e Rahovecit janë identifikuar 10 vendbanime jo formale, një nga të cilat ndodhet në zonën urbane dhe 9 në zonat rurale. Në këto vendbanime jetojnë kryesisht banorë të komunitetit rom, ashkali, egjiptian dhe shqiptar. Karakterizohen me mungesë të infrastrukturës fizike dhe infrastrukturë sociale si dhe kanë ndikim negativ në mjedis.

Sipërfaqja e përgjithshme e Vendbanimeve jo formale në Komunën e Rahovecit është 12.2 ha. Në të gjitha këto vendbanime jetojnë gjithsej 1556, me 293 ekonomi familjare.

Vendbanimet jo formale gjenden në këto vendbanime: Një pjesë e qytetit të Rahovecit, dhe pjesë apo lagje të fshatrave Bellacërk, Xërxë, Gexhë, Radost, Ratkoc, Çifllak, Dabidol dhe dy pjesë të fshatit Drenoc.





Harta 25_ Vendbanimet dhe Vendbanimet joformale


13 SHFRYTËZIMI I TOKËS

13.1 Gjendja ekzistuese e shfrytëzimit të tokës

Bazuar në digjitalizimin e ortofotove dhe dokumenteve tjera, punës në terren, të dhënave që janë siguruar nga shërbimet zyrtare komunale, si dhe llogaritjeve tona, gjithnjë në kontekstin e shfrytëzimit dhe destinimit të sipërfaqeve në nivelin komunal, mund të konkludohet se territori i komunës së Rahovecit zë sipërfaqen prej 27589 hektar, në të cilin territor zhvillohen aktivitete të shumta humane.


Tabela 11. Shfrytëzimi i tokës ne hektar

Kategoria hapësinore	Sipërfaqe në Ha	%
Pyje	7293.24	26.4%
Livadhe	710.25	2.6%
Kullosa	3299.73	12.0%
Sipërfaqe bujqësore	12556.98	45.5%
Zonat e ndërtuara	1239.2	4.5%
Vreshta	2225.61	8.1%
Varreza	67.77	0.2%
Degradime	196.62	0.7%
Totali	27589.4	100.0%



Grafiku 16. Shfrytëzimi i tokës në %

Në këtë territor jetojnë 56208 banorë, të organizuar në një qendër urbane dhe 35 vendbanime rurale që gravitojnë në 7 qendra lokale. Mbi gjysma e numrit të vendbanimeve shtrihen në zonën e rrafshët kurse zgjerimi i tyre bëhet në mënyrë të pakontrolluar, gjithnjë në dëm të sipërfaqeve bujqësore të kategorisë së lartë. Në tabelën e shfrytëzimit të tokës fondin më të madh të sipërfaqeve e zënë ato bujqësore me 46 % të territorit të komunës.



Harta 26_Shfrytëzimi i tokës

Vendin e dytë e zënë sipërfaqet pyjore me 26.2%, ndërsa sipërfaqet tjera kanë fond më të vogël. Sipërfaqet e ndërtuara kanë pjesëmarrje mjaft të vogël, me vetëm 5 % të territorit. Kjo tregon se situata e shfrytëzimit të tokës është dukshëm më e volitshme në krahasim me shumë komuna tjera të Kosovës duke dhënë mundësi të shfrytëzimit sa më racional të hapësirës. Zvogëlimi dhe degradimi i sipërfaqeve bujqësore nga ndërtimet dhe zgjerimi i vendbanimeve, që vazhdimisht mbulojnë sipërfaqe të konsiderueshme bujqësore të cilsi së lartë, është brengë e cila kërkon trajtim adekuat. Andaj plani zhvillimor komunal do të ofroj zgjidhje për shumë qështje duke përfshi edhe mbrojtjen e sipërfaqeve bujqësore si resurs vital për jetën e popullsisë së këtyre hapësirave. Duke llogaritur numrin e banorëve në raport me sipërfaqet bujqësore të kategorisë I -IV, del se për një banorë në komunën e Rahovecit bien vetëm 0.16 hektar, që tregon për një gjendje të pavoritshme andaj kujdesi ndaj tokave bujqësore duhet të jetë prioritet për shoqërinë.

Sipas Sektorit të Pylltarisë në Rahovec kemi një klasifikim më të gjerë të Klasave Menaxhuese në tokat pyjore.

Nr.	Klasat Menaxhuese në tokat pyjore	Sipërfaqja (Ha)	Pjesëmarrja
1	Pyll I pishës njëmoshore në toka të thella	37.1	0.5
2	Pyll cungishte dominuar nga dushku	2.041.4	26.5
3	Pyll cungishte dominuar nga shkoza	2.324.0	30.2
4	Pyll cungishte nga fletore tjerë	195.5	2.5
5	Shkurre të përshtatshme për konvertim në pyll ah, bredhi dhe halorë tjerë	164.1	2.1
6	SHkurre të përshtatshme për konvertim në pyll pishë	340.8	4.4
7	Tokë shkurre jo e përshtatshme për konvertim	241.8	3.1
8	Sipërfaqe bujqësore në përdorim	111.4	1.4
9	Livadhe dhe kullosa	1.504.4	19.6
10	Sipërfaqe me ujë	78.4	1.0
11	Toka shkëmbore pa drunjë	412.3	5.4
12	Sipërfaqe pyjore me produktivitet të ulët me trungje të shpërndara	82.4	1.1
13	Sipërfaqe erozive	0.9	0.0
14	Sipërfaqe tjera të hapura	157.52	2.0
Totali		7.692.52	100.0

Vlenë të cekët se në NJM „Koznik- Zatriq-Rahovec shkozë” janë kushte shumë të mira klimatike për sa i përket produkteve të dyta Pyjore siq janë bimët mjekuese dhe aromatike: *Achillea millefolium* (Herba), *Artemisia vulgaris* (Herba), *Cichorium intybus* (Root), *Malus sylvestris* (Fruit), *Taraxacum officinale* (Leaves) etj.

14 KARATERISTIKAT PEDOLOGJIKE DHE BONITETI

14.1 Karakteristikat pedologjike

Territori i Komunës së Rahovecit ka llojllojshmërinë e dukshme pedologjike e cila pasqyrohet me numër të madh të grupeve të llojeve të tokës, e në përbërjen e saj ka 8 lloje dhe 21

nënloje, në formë të një mozaiku. Me përjashtim të tokave skeletore, tokat tjera janë nga supstratet e bartura. Ato janë formuar pjesërisht nga sedimentet liqenore dhe rrjedhjeve të ujërave.

Prezenca e llojeve të ndryshme të tokave ofron mundësi për zhvillimin e kulturave të shumëllojshme.

Në këtë rast është me rëndësi ndikimi i njeriut në shfrytëzimin e tokës gjë që shpeshherë mund të shprehet negativisht nëse nuk i përshtatet lloji i kulturave llojit të tokës, sepse shfrytëzimi jo racional shkakton erozion dhe shkatërrim të tokave.

Në bazë të hulumtimeve në terren dhe hulumtimeve laboratorike të tokave në Komunën e Rahovecit dallohen këto lloje:

Tokat Aluvijale –

kanë rëndësi të madhe për bujqësi në territorin e komunës së Rahovecit. Ky lloj i tokave është i përqendruar në luginën e lumit Drini i Bardhë. Këto toka janë formuar në teracat lumore të vjetërsisë aluviale. Duke u larguar nga shtrati i lumit këto toka ndryshojnë përbërjen duke i'u shtuar sasia e humusit. Këto toka janë të klasat të I-rë të bonitetit dhe bëjnë pjesë në tokat me produktivitet të lartë bujqësor.

Gjatë vërshimeve dheu bartet me erozion, kështu që këto sipërfaqe duhet sanuar me masa gjegjëse hidroteknike. Në bazë të hulumtimit laboratorik dhe në terren këto toka ndahen në nënlojet të tokave aluviale: rëra, rëra deltinore, rëra argjilore.

Aluvijumi Rënor - këto toka shtrihen përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë, ndërmjet fshatrave Kramovik dhe Gexhë.

Aluvijumi Argjilor - më së shumti është përqendruar në tërë gjatësinë e lumit të Drinit të Bardhë i cili kalon në territorin e komunës.

Tokat Deluviale – kanë pjesëmarrje të vogël në komunën e Rahovecit.

Tokat Deluviale Deltinore - shtrihen rreth këtyre fshatrave: Kaznik, Drenoc, Rahovec dhe Zatriq.

Aluviumi dhe deluvijumi deltinor – këto toka posaçërisht janë të përqendruara në luginat e ngushta të prrojeve, prroskave në pjesët kodrinore të komunës. Sipërfaqet kryesore të kësaj toke janë të përqendruara në ngastra të këtyre fshatrave: Bërnjak – Rahovec, Fortesë – Sapniq, Apterushë – Reti e Ulët.

Tokat livadhore – deltinore - sipërfaqet e tokës livadhore-deltinore shtrihen kryesisht në luginën e Drinit të Bardhë.

Rendëzinat – zënë sipërfaqe të konsiderueshme të komunës dhe posaçërisht në viset kodrinore-malore. Karakteristikë e këtyre tokave është thellësia e vogël e shtesës prej 50 cm dhe e pasur me humus (5 – 15%) ndërsa më së shumti janë të mbuluar me pyje dhe kullosa. Boniteti i këtyre tokave është i klasat të IV dhe VI-të dhe kërkojnë masa të posaçme për mbrojtjen nga erozioni. Redimentet janë të ulëta dhe kërkojnë masa përmirësuese në mënyrë që të mundësojnë një prodhim të sigurtë dhe racional.

Në komunën e Rahovecit janë prezentë edhe këto nënloje të tokave:

- Rendzinë e hinjtë – kafe me supstratet gëlqerorë të butë
- Rendzinë tipike – në supstrate gëlqerore
- Rendzinë e hinjtë – me supstratet gëlqerore
- Rendzinë tipike – mbi serpentine
- Rendzinë e hinjtë – kafe mbi serpentine

- Rendzina tipike dhe e hinjtë-kafe në serpentine

Këto llojet shtrihen ose janë në pjesët veri-perëndimore të komunës, rreth këtyre fshatrave: Drenoc, Zatriq, Kaznik, Guri Kuq, Mrasor e tjerë.

Tokat Smonicë. Ky tip i tokës përfshinë pjesën dërmuese të territorit të komunës së Rahovecit. Këto toka, së bashku me tokat aluvijale, paraqesin, sipërfaqet bujqësore të kësaj komune.

Smonicat e eroduar- Sipërfaqet e këtyre tokave shtrihen në lindje të Rahovecit. Në pjesët kodrinore erozioni ka bartë pjesën më të madhe të tokës humusore. Këto toka janë të thellësisë mesatare dhe të cekta, me përbërje argjilore, me përbërje karbonatike të ndryshuar, me reaksion neutral e të dobëtë alkal, me përmbajtje të zvogëluar të humusit si dhe me përbërje të ndryshuar të formës aktive të fosforit dhe kaliumit. Këto sipërfaqe nuk mund të përdoren për të gjitha kulturat bujqësore. Këto sipërfaqet janë të bonitetit të klasës III-të dhe IV-të. Në territorin e kësaj komune dallohen këto nënloje:

Smonicë e pakarbonizuar -Areali kryesor me Smonicë të pakarbonizuar shtrihet rreth fshatrave: Palluzh, Denjë, Bratotin, Dabidol.

Smonicë në proces të kafenjizuar dhe Smonicë e kafenjizuar- Përfshinë një pjesë të vogël të komunës në veri-perendim, ndërmjet fshatrave Kramavik dhe Guri Kuq te Saroshi e tjerë. Areali kryesor i kësaj toke shtrihet në ngastrat e këtyre fshatrave: Nashpal, Sapniq, Bërnjak, Reti dhe komunën kadastrale të Rahovecit.

Smonicë e lesivuar me pseudoglej -Sipërfaqet kryesore shtrihen në perëndim të territorit të komunës, në lindje të fshatit Dabidol, Denjë, Ratkoc dhe Malsi të Vogël.

Smonicë e eroduar -Në teritorin e kësaj komune paraqiten së bashku me tokat të lesivuara, me proces të kafenjejuar. Sipërfaqet kryesore në këtë nënloj të smonicës të eroduar janë rreth këtyre fshatrave: Pataçan i Epërm, Pataçan i Ulët, Bernjakë, Reti, Nagac, Celinë etj

Tokë e Kuqe mbi formacionet gelqerore - Kompleksi kryesor i këtyre tokave ndodhet në lindje të komunës, rreth fshatrave Apterushë dhe në Zatriq.

Toka e kuqe e cekët mbi formacione gëlqeror -Përfshinë një sipërfaqe të vogël në komunën e Rahovecit dhe ate në veri-lindje të fshatit Apterushë. Toka e kuqe e kafenjizuar mbi formacione të forta -Ky lloj i tokave paraqitet vetëm në Gradishtë te Ura e Shenjtë dhe zë sipërfaqe të vogël. Tokë e kuqëremtë rënore, deltinor mbi sedimentet të kuqërremtë -Ky lloj i tokës është e përqendruar në vetëm disa hektarë në jug-lindje të Rahovecit, rreth fshatit Hoçë e Madhe. Paraqitet në pjesët kodrinore dhe atë në lartësitë mbidetare rreth 500 m. Tokë e kuqe kafe e lesivuar mbi sedimentet e kuqëremtë -Kjo lloj toke është e koncentruar në sipërfaqet e komunës së Rahovecit, rreth fshatit Krushë e Madhe. Tokë e kafenjtit deltinore mbi argjilë liqenore-Kjo lloj toke përfshinë pjesët prej malit të Shkozës dhe duke zbritur kah Drini i Bardhë, posaqërisht përshinë sipërfaqet e konsiderueshme kah jugu dhe jug-lindje e Rahovecit dhe Hoçës së Madhe deri te Fortesa dhe Celina. Lartësia mbidetare e këtyre tokave është rreth 450 m. Shkëmbinjtë ultrabazik -Kjo tokë nuk ka rëndësi të madhe për bujqësi për komunën e Rahovecit. Përshinë sipërfaqe të vogël dhe ate rreth fshatit Drenoc dhe Zatriq. Kjo hapësirë është e mbuluar me pyje dhe kullosa.

Tokë pseudogleje – podzol -Në territorin e komunës së Rahovecit kjo lloj toke përfshinë sipërfaqe të vogël në jug-perendim të komunës dhe ate në fshatin Xërxë.

Tokë pseudogleje – argjilore- Kjo lloj toke përfshinë pjesën më të vogël të komunës dhe ate rreth fshatit Kramovik.

Shkëmbinjtë-Sipërfaqe nën shkëmbijë ka posaçërisht në pjesët kodrinore-malore të komunës, rreth fshatit Koznik dhe Zatriq. Këto janë sipërfaqe joproduktive.³³

Një pasqyrë më e çartë mbi shtrirjen e llojeve të tokave është paraqitur në tabelën në vijim.

Venbanimi	Lloji i tokës (% e sipërfaqes së tërësishme)							
	Tokë Aluviale	Tokë Deluviale	Rendzina	Smonic	Tokë e Kuqe	Argjila Liqenore	Shkëmbij Ultrabazik	Shkëmbij
Rahovec		10	35	40	15			
Bellacërk (Fortesë)	15	40		20		15		
Bërnjak		20	80					
Bratotin			100					
Brestovc	18			15	40	27		
Celinë		20		30		50		
Çifllak	50	50						
Dobidol	30	40		30				
Dejnë	30	40		30				
Drenoc		45	18	12			25	
Gexhë	20	40		30	10			
Hoqe e Madhe				20	30	50		
Hoqe e Vogel								
Kaznik		25	20		18		17	20
Kramovik	10		60	20			10	
Krushe e Madhe	30	40		10	20			
Mrasor	10		80	10				
Nagavc	10			80		10		
Nushpal				100				
Opterushë		20	08	35	15	30		
Pastasellë		30		50	20			
Pataqan I Eperm				100				
Pataqan I poshtem		10		90				
Petkoviq (Guri I kuq)		10	50	40				
Polluzhë				100				
Radostë (Malësia e Vogël)	30	35		35				
Ratkoc	30	20		50				
Retijë e Ulet		20		80				
Retijë		20		80				
Sapniq		10		90				
Senoc		30		50	20			
Vrajakë				100				
Xërxë	20	60					20	
Zatriq			90					10
Zoqishtë		10		35	20	35		

³³ Data GIS consulting Nëntor 2011

Klasa dominuese e kësaj toke në këtë Njësi e përbëjnë Rendizanat substrakt gëlqeror dhe sepertine me prej 22.8%, duke u përcjell nga tokat e kuqe të cekëta dhe kafejuara mbi gurë gëlqeror të forte me pjesëmarrje 30% si dhe tokat e kafejta me pjesëmarrje prej 29%.


Nr.	Emertimi i llojit toke	Pjesemarrja	Sip. Ne Ha
1	Litosol mbi formacione shkembijsh ultrabazik (serpentinët)	0.24	18.17
2	Litosol mbi formacione shkembijsh gëlqeror të thukur	0.53	40.94
3	Aluvium zallore	1.20	92.2
4	Aluvium teltyrore	1.81	139.25
5	Deluvium teltyrore	6.85	526.68
6	Aluvionale-devulionale-telturore	0.33	25.68
7	Toke Livadhe Telturore	0.19	14.97
8	Rendzine e hijt-kafe mbi substrakt gëlqeror të butë	0.65	50.18
9	Rendzine tipike mbi substrakt gëlqeror të fortë	18.90	1.454.14
10	Rendzine e hijt-kafe mbi substrakt gëlqeror të fortë	21.37	1.644.23
11	Rendzine tipike mbi serpentinë	15.45	1.188.52
12	Rendzine e hijt-kafe mbi serpentinë	11.57	889.71
13	Smonicë e pa karbonizuar	1.31	101.1
14	Smonicë në proqes të kafenjzimit	4.82	371.12
15	Smonicë e kafenjzuar	0.38	29.26
16	Smonicë e lesivuar me pseudoglej	0.00	0.26
17	Smonicë e eroduar	0.61	46.77
18	Tokë e kuqe e cekët mbi formacion gëlqerorë të fortë	2.29	175.91
19	Tokë e kuqe mesatarish e thellë mbi formacion gëlqerorë të fortë	1.68	128.92
20	Tokë e kuqrrimt-kafe e lesivuar mbi sendimente të kuqërrimit	2.37	181.97
21	Tokë e kafejnjt argjilore mbi argjile liqeni	1.05	80.55
22	Tokë e kafejnjt mesatarisht e thellë -½ mbi supstrat ultrabazik	3.77	289.67
23	Tokë pedzollake-pseudoglej	0.34	26
24	Pseudoglej argjilore	0.27	20.91
25	Shkëmbijë	2.02	155.41
Totali		100	7.692.52

Klasa dominuese sipas tabelës së mësipërme, janë tokat e tipit Rendzina të cilat marrin pjesë me rreth 68% të sipërfaqes së tërësishme.

14.2 Boniteti

Në bazë të hulumtimeve dhe analizave të bazuara në Atllasin e Hidroekonomisë së Kosovës shkalla e shtrirjes së bonitetit është si vijon :

BONITETI		
Klasa e Bonitetit	Sip ne ha	%
2	3807	13.8
3	17690	64.2
4	1560	5.7
5	485	1.7
6	191.5	0.7
7	3816	13.9
	27589	



Harta 27_Boniteti i tokës

15 KAPACITET INVESTIVE³⁴

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018-2020 (KASH 2018-2020) e paraqitur si dokumenti kryesor mbi bazën e të cilit hartohet Buxheti Vjetor për 2018 për gjithë komunat e Kosovës, po ashtu edhe për Komunen e Rahovecit.

Qëllimi kryesor i KASH-it është që të ofrojë një analizë të bazuar të mjedisit makroekonomik në vend, për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë.

Komuna e Rahovecit për sa i përket investimeve kapitale e bazuar në grante dhe të hyra vetanake do të ketë një zhvillim të tillë të elaboruar më detajisht.

Granti i Përgjithshëm për vitin 2018 dhe parashikimet për 2019-2020

Bazuar në Tabelën që do të paraqesim në vijim, të përgatitur nga Departamenti i Politikave Makroekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar të Ministrisë së Financave në përputhje me LFPL, Komisioni i Granteve në takimin e datës 04 prill 2017 ka aprovuar Grantin e Përgjithshëm për komuna për vitin 2018 në shumë prej 173.6 milion euro.

Nga ky total i përgjithshëm i grantit për të gjitha komunat e Kosovës, vetëm Komuna e Rahovecit do të ketë:

Tabela 7: Granti i Përgjithshëm për vitin 2018 dhe parashikimet për 2019-2020

Komuna	Kriteret për ndarjen e Grantit të Përgjithshëm (sipas LFPL)								Granti i Përgjithshëm për vitin 2018										
	Popullsia		Madhësia gjeografike		Popullsia Pakicë		Komunat me popullsi pakic		Kontigjenca për korrektim të formulës										
	Popullsia	89%	Madhësia gjeografik	6%	Popullsia Pakicë në Komune	3%	Komunat me popullsipakic	2%	Shuma fikse për 14 komuna	Proportionalisht sipas popullsisë për 14 komuna	Gjithëse								
RAHOVECI	56208	3.16%	278	2.55%	944	0.87%	-	0.00%	-	-	-	83,792	4,644,866	253,023	43,369		5,025,049	5,510,848	6,217,556

³⁴ Republika e Kosovës, Ministria e Financave, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018-2020

Projeksionet e të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2018 dhe parashikimet 2019- 2020

Nga të hyrat vetanake të realizuar nëpër vite, nga viti 2014 deri në vitin 2015 kishte një ramje në të hyra, nga 1,011,497.00€ në 969,696.00€.

Ndërsa realizimet e të hyrave vetanake nga viti 2015 kishte një ngritje të vazhdueshme .

Po ashtu edhe planifikimet janë bërë me një rritje, ku planifikimi i vitit 2017 është 1,247,732.00€ , në vitin 2018 është 1,650,027.00€, në vitin 2019 është 1,710,394.00€, ndërsa në vitin 2020 planifikimi i të hyrave vetanake komunale do të jetë 1,770,761.00€.

Tabela 7: Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2018-2020

Nr.	Komuna	Realizimi i THV në vitin 2014	Realizimi i THV në vitin 2015	Realizimi i THV në vitin 2016	Planifikimi për vitin 2017	Planifikimi për vitin 2018	Planifikimi për vitin 2019	Planifikimi për vitin 2020
25.	Rahovecit	1,011,497	969,696	1,009,927	1,247,732	1,650,027	1,710,394	1,770,761

Huamarrja

Fondet e ndara nga huamarrja në MASHT në nën-programet “Administrata qendrore dhe Investimet kapitale në Arsimin Parauniversitar”, në kuadër të projektit “Reforma në arsim” për Komunen e Rahovecit.

Financimet nga huamarrja për vitin 2018 si dhe për vitin 2019, në numrin e shkollave, mallrave dhe shërbimeve, shpenzimet kapitale do të paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 8: Financimi i arsimit nga huamarrja për 2018-2019

Nr.	Komuna	Financimet nga huamarrjet për vitin 2018				Financimet nga huamarrjet për vitin 2019		
		Numri i shkollave për komuna	Mallra dhe Shërbime (min. 60%)	Shpenzime Kapitale (max. 40%)	Total Financimi për vitin 2018	Mallra dhe Shërbime (min. 60%)	Shpenzime Kapitale (max. 40%)	Total Financimi për vitin 2019
19.	Rahovecit	9	30,345	20,230	50,575	17,701	11,801	29,502

Financimi për Këshillin e Hoçës së Madhe për vitin 2018

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-62 për Fshatin Hoçë e Madhe, me planifikimin e buxhetit për vitin 2018 ndahen mjete financiare në shumë prej 22,743 euro,

Përmbledhje e financimit komunal për vitin 2018-2020

Komisioni i Granteve në takimin e datës 04 prill 2017 ka aprovuar grantet qeveritare për financimin e komunave, e në rastin tonë për Komunen e Rahovecit, përfshirë financimin nga huamarrja dhe projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2018.

Tabela 10: Përmbledhje e financimit komunal për vitin 2018-2020

Nr	Komuna	Granti I Përgjithshëm	Granti specifik për Arsimit	Granti specifik për Shëndetësinë	Financimi për Shëndetësinë Sekondare	Financimi për Shërbimet Rezidenciale	Financimi për Keshillin e Hoqës së Madhe	Të hyrat Vetanake Komunale	Huamarrja në Arsimit	Total Financimi Komunal për vitin 2018
25	Rahoveci	5,025,049	5,030,287	1,531,288			22,743	1,650,027	50,575	13,309,970

16 VLERËSIMI I GJENDJE EKZISTUESE NË KOMUNË

Me qëllim të vlerësimi i gjendjes sa më të mirë në komunën e Rahovecit , rezultatet e nxjerra nga SWOT analiza do të analizohen për fusha te caktuara, ashtu sikurse janë nxjerr të dhënat nga Profili Urban.

16.1 GJENDJA SOCIO-DEMOGRAFIKE

SWOT Analiza

PERPARËSIT	DOBËSITË
- Popullsia me moshë mesatare të re - Popullsia me moshë ekonomiksht aktive - Popullsia relativisht mirë e arsimuar, e orientuar drejt vlerave arsimore	- Papunësia e lartë - Shkalla e varfërisë - Shenja të rënies në trendin e rritjes së popullsisë - Aktivitete jo të mjaftueshme socio-kulturore - Migrimi
MUNDËSITË	RREZIQET
- Programe speciale-profesionale për të papunët sipas kërkesave të tregut, - Zgjerimi i edukimit para fillor në të gjitha shkollat fillore - Dërgesat e bashkatdhetareve (remitancat)	- Kriza ekonomike - Dukuritë negative në shoqëri - Largimi i popullsisë ekonomiksht aktive jashtë vendit - Largimi i fuqisë punëtore të kualifikuar jashtë vendit

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA

- Rritja e nivelit të punësimit
- Ulja e varfërisë
- Përfshirja e të rinjve në sferën socio-kulturore

NEVOJAT ZHVILLIMORE

- Përkrahja e të rinjve dhe femrave në zhvillimin e aftësive për punësim
- Adaptimi i kurrikulave arsimore sipas potencialeve zhvillimore lokale
- Vlerësimi i kapaciteteve njerëzore dhe aftësimi sipas kërkesave në tregun e punës
- Përfshirja e të rinjve në zhvillimin e mëtejshëm të organizimit social dhe kulturor

16.2 ZHVILLIMI EKONOMIK

SWOT Analiza

PERPARËSIT	DOBËSITË
- Resurset natyrore për bujqësi dhe blegtori - Komunë tradicionalisht e pasur me ndërmarrje bujqësore, - Traditë shumvjeçare në kultivimin dhe përpunimin e rrushit dhe verës, - Afërsi e Rahovecit/Kosovës me tregun e	- Humbje e vullnetit për vazhdimin e aktivitetit për kultivim të bujqësisë; - Mungesë e mbështetjes së vazhdueshme financiare për fermerët dhe përpunuesit e prodhimeve bujqësore;

Evropës, - Trashëgimi e pasur kulturore dhe arkeologjike.	-
MUNDËSITË	RREZIQET
- Mbështetje financiare në ngritjen e kapaciteteve private përpunuese në bujqësi, industri ushqimore, - Përdorim i metodave të reja shkencore në rritjen e prodhimit të rrëqitjes, - Plasim i sigurtë në tregun Evropian i prodhimeve bujqësore, produkteve ushqimore të gatshme, prodhimeve të rrëqitjes, - Partneriteti publik-privat	- Degradimi i tokës bujqësore, - Mosmbështetje e vazhdueshme në përtëritjen e teknologjisë së vjetëruar, - Mungesa e strategjisë për gjenerimin e investimeve nga burimet e vendit, - Vazhdim i paralizimit të tokës, - Mos trajtimi adekuat mbetjeve që dalin nga Bodrumet e Verarise.

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA

- Promovimi i potencialeve turistike
- Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme
- Stimulimi i prodhimit bujqësor dhe blegtorisë

NEVOJAT ZHVILLIMORE

- Konsolidimi dhe zgjerimi i kapaciteteve lokale bujqësore, vreshtari -verari dhe blegtorale
- Zgjerimi i gamës së prodhimeve dhe promovimi i tyre
- Shqyrtimi i mundësive për zhvillimin e kapaciteteve agro-industriale
- Mbrojtja dhe promovimi i i potencialeve lokale natyrore dhe kulturore, si dhe zhvillimi i kapaciteteve turistike të ndërlidhura
- Zhvillimi dhe konsolidimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

16.3 INFRASTRUKTURAT TEKNIKE DHE SHËRBIMET PËRKATËSE

SWOT Analiza

PERPARËSIT	DOBËSITË
- Lidhje të mira përmes rrugëve magjistrale dhe regionale, si dhe atë të rrjetit hekurudhor, - Qasja e vendbanimeve në infrastrukturë të asfaltuar, - Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit	- Menaxhimi i dobët i linjave të transportit publik në viset rurale - Mungesa e qasjes së vendbanimeve rurale të thella në menaxhim të mbeturinave, - Mosfunksionimi i linjave hekurudhore - Mirëmbajtja jo adekuat e rrugëve - Mosmirëmbajtja e sistemit të kanalizimeve
MUNDËSITË	RREZIQET
- Shtrirje e internetit në të gjitha vendbanimet, aty ku nuk ka. - Ndriçimi i rrugëve në zona të frekuentuara	- Degradimi mjedisit si pasojë e shkarkimit të ujërave të zeza dhe atyre industriale të pa trajtuara paraprakisht,

me popullsi të dendur	- Ndikimet shëndetësore nga cilësia e ujit të puseve
-----------------------	--

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA

- Trajtimi i ujërave të zeza
- Përmirësimi i infrastrukturës energjetike
- Menaxhimi adekuat me mbeturinat

NEVOJAT ZHVILLIMORE

- Përfshirja e të gjitha vendbanimeve me shërbimin e rregullt për menaxhimin e mbeturinave,
- Përfshirja e të gjitha vendbanimeve në system e ujit të pijshëm
-

16.4 INFRASTRUKTURA RRUGORE DHE TRANSPORTI

SWOT Analiza

PERPARËSIT	DOBËSITË
- Lidhje e mira rrugore lokale - Pozita e mirë gjeografike - Rekonstruimi dhe mirëmbajtja e rrjetit rrugor, -	- Mungesa e shtigjeve/korsive për qarkullim jomotorik, - Ndërtimet afër rrugëve regjionale dhe lokale jashtë rregullave ndërtimore, - Sistemi i dobët i sinjalizimit, -
MUNDËSITË	RREZIQET
- Përmirësimi i shërbimeve të transportit publik, - Zhvillimi i rrjetit të transportit të jo motorizuar,	- Kufizimi i sigurisë në trafik nga ndërtimet afër rrugëve, - Siguri e pamjaftueshme në komunikacionin rrugor, - Ndotja e mjedisit nga transporti i motorizuar

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA

- Përmirësimi i sigurisë në trafik
- Krijimi kushteve për qarkullim jomotorik
- Përmirësimi i rrjetit të transportit publik
- Zgjidhje e çështjes së parkimit në qendrën komunale

NEVOJAT ZHVILLIMORE

- Kompletimi i rrjetit të infrastrukturës me elementet që mundësojnë qarkullim për të gjithë

pjesëmarrësit në komunikacion, duke përfshirë edhe qarkullimin jomotorik

- Sinjalizimi si nevojë për rritjen e sigurisë në trafik rrugor
- Kompletimi/konsolidimi i rrjetit rrugor në të gjitha lagjet e vendbanimeve rurale

16.5 SHËRBIMET SOCIALE DHE PUBLIKE

SWOT Analiza

PERPARËSIT	DOBËSITË
- Funksionimi i qendres për punë sociale - Ofrimi i shërbimeve sociale sipas standardeve minimale të përcaktuara nga MPMS - Infrastruktura e mirë shëndetësore - Stafi i mjaftueshëm dhe profesional në QPS - Ofrimi i shërbimeve shëndetësore primare 24 orë	- Mungesë e kuadrit mjekësor në disa QMF dhe AMF - Mungesa e hapësirës së nevojshme të Objektit ekzistues të QPS - Mungesa e shtëpisë për qëndrim ditë të moshuarve - Mungesa e qendrës për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme QFAKP - Mungesa e grantit specifik për Shërbimet Sociale
MUNDËSITË	RREZIQET
- Mundësitë për programet e trajnimit për stafin shëndetësor, - Ndërtimi i Objektit të ri të QPS - Sigurimi i fondeve nga niveli qendror dhe donatorët për zhvillim të infrastrukturës teknike dhe profesionale - Hapja e një njësie të qendrës së Shëndetit Mendor -	- Përkujdesja e kufizuar shëndetësore në disa pjesë rurale në mungesë të kuadrit profesional shëndetësor, - Mungesa e grantit specifik për Shërbimet Sociale, rrezikon zbatimin e veprimeve ligjore për disa kategori të ndieshme sipas standardeve minimale. -

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA

- Zgjerimi i rrjetit të hapësirave publike dhe mirëmbajtja e tyre
- Ofrimi i shërbimeve cilësore shëndetësore dhe shërbimeve sociale
- Zhvillimi i aktiviteteve dhe orientimi i të rinjve drejt sportit, rekreacionit dhe kulturës

NEVOJAT ZHVILLIMORE

- Sigurimi i stafit profesional shëndetësor dhe shërbimeve adekuate shëndetësore nëpër të gjitha vendbanimet,
- Zgjerimi i mëtejshëm i aktiviteteve kulturore,
- Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës sportive,
- Zgjerimi i rrjetit të hapësirave publike duke i shfrytëzuar potencialet në qendrën komunale dhe pjesët rurale

16.6 INSTITUCIONET ARSIMORE

SWOT Analiza

PERPARËSITË	DOBËSITË
- Kuadri i kualifikuar arsimor - Trajnimet kurrikulare për stafin mësimor - Bashkëpunimin profesional ndërkomunal	- Mungesa e rrjetit të institucioneve parashkollore, - Infrastruktura jo e mirë e objekteve shkollore - Zhvillimi i mesimit në dy nderrime në shumicën e shkollave,
MUNDËSITË	RREZIQET
- Mundësitë për programet e trajnimit për stafin arsimor, - Sigurimi i fondeve nga niveli qendror dhe donatorët për zhvillim të infrastrukturës teknike dhe profesionale në sistemin arsimor	- Siguria e duhur në shkollë - Zvoglimi i numrit të nxënësve nëpër shkollë (Braktisja, migrimi, rënia e lindshmërisë) -

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA

- Arritja e cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në arsim,
- Zgjerimi i rrjetit të objekteve sportive dhe rekreacionit në hapësirat shkollore
- Ofrimi i shërbimeve cilësore pedagogjike dhe psikologjike nëpër shkollë
- Ofrimi i mundësive të qasjes së nxënësve me kohë në hapësirat shkollore
-

NEVOJAT ZHVILLIMORE

- Sigurimi i arsimit adekuat për të gjitha moshat shkollore nëpër të gjitha vendbanimet,
- Ndërtimi i objekteve shkollore, për mësim në një ndërrim,
- Zgjerimi i mëtejshmë i aktiviteteve arsimore dhe kulturore,
- Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës sportive nëpër shkollë
- Aplikimi i masave të efikasitetit të energjisë
- Pajisja e shkollave me laboratore dhe kabinete
-

16.7 MJEDISI

SWOT Analiza

PERPARËSIT	DOBËSITË
- Toka bujqësore për kulturën e vreshtarisë, pemtarisë, - Cilësia e ajrit - Burimet natyrore - Cilësia e tokës bujqësore - Trashëgimi natyror, - Zvoglimi i deponive ilegale	- Degradim i shtretërve të lumenjve - Shfrytëzimi i pa kontrolluar i inerteve, - Deponitë joformale të mbeturinave, - Shkarkimi i ujërave të zeza të patrajtuara, - Ngrohja individuale me thengjill dhe dru e objekteve, në mungesë të ngrohjes qendrore në pjesën urbane, - Mbrojtja jo e mirë nga vërshimet dhe erozioni - Ndërrim destinimi i tokave bujqësore në ato ndërtimore
MUNDËSITË	RREZIQET
- Shfrytëzim i qendrueshëm i tokave bujqësore, - Largimi i deponive ilegale - Promovimi i vlerave mjedisore, - Masat anti-erozion, - Peizazhe të përshtatshme për pushim dhe rekreacion (ura e Fshejt dhe Kanjoni i Mirushes) - Favorizimi i vreshtarisë, perimtarisë dhe pemëtarisë - Vetëdijësi i qytetarëve për mbrojtje të mjedisore	- Degradimi i tokave bujqësore përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë - Ndikimi negativ në biodiversitet, - Demtimi i pyjeve nga faktori njeri - Rreziku nga vërshimet, - Përhapja e epidemive për mungesë të sistemit të kanalizimit qendror fekal, të ujërave të zeza dhe mbeturinave. - Prania aktuale dhe zgjerimi i vendbanimeve në zona me ekspozim të lartë ndaj fatkeqësive sizmike.

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA

- Trajtimi i ujërave të zeza,
- Mbrojtja e pyjeve dhe tokës bujqësore
- Mbrojtja nga fatkeqësit natyrore.
- Ndarja e ujërave atmosferike me ato fekale

NEVOJAT ZHVILLIMORE

- Zgjerimi i rrjetit të hapësirave publike duke i shfrytëzuar potencialet në qendrën komunale dhe pjesët rurale
- Pastrimi dhe rregullimi i brezave dhe shtretërve të lumenjve me qëllim të sigurimit të rrjedhjes dhe shmangies së vërshimeve
- Trajtimi i ujërave të zeza, dhe atmosferike
- Pastrimi i lumenjeve
- Ndarja e mbeturinave në burim
- Pastrimi dhe rregullimi i brezave dhe shtretërve të lumenjve me qëllim të sigurimit të rrjedhjes dhe shmangies së vërshimeve

16.8 EMERGJENCAT

SWOT Analiza

PERPARËSIT	DOBËSITË
- Përgaditja dhe angazhimi maksimal i Drejtorise për Mbrojtje dhe Shpëtim për përballje me situata emergjente - Plnet e hartuara si mase preventive në raste të reagimit në situata e emergjente -	- Shtrirja e vendbanimeve përgjat lumenjeve -
MUNDËSITË	RREZIQET
- Infrastruktura për mbrojtje nga rreziqet hidrometeorologjike	- Vendbanime të rrethuara se paku ne tri anë me sipërfaqe pyjore, si rrezikshmeri e zjerreve të pa kontrolluara - Seizmologjia e shkallës 7^o dhe 8^o të Rihterit, në Komunën e Rahovecit -

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA

- Mbrojtja nga vërshimet
- Mbrojtja nga zjarret malore-fushore
- Mbrojtja e pyjeve
- Mbrojtja nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësit tjera.

NEVOJAT ZHVILLIMORE

- Pastrimi i lumenjëve dhe prrockave
- Paisja e të gjitha vendbanimeve me Hidrante

16.9 TRASHËGIMIA

SWOT Analiza

PERPARËSIT	DOBËSITË
- Resuset natyrore, kulturore - Diversiteti dhe toleranca fetare - Lokalitet i pasur me trashëgimi arkitektonike: Arkitekture e vecant e banimit, objektet fetare, urat. - Lokalitet i pasur Arkeologjik: Arti në gure, festivali i rrushit, festivali folklorik	- Mungesa e politikave zhvillimore për shfrytëzimin e resurseve - Degradimi dhe shkatërrimi i monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, - Zhdukja e Artizanateve - Niveli i ulët i vetëdijes së njerëzve për vlerat e trashëgimis kulturore, sidomos gjeneratat e reja,
MUNDËSITË	RREZIQET
- Zhvillimi i rrjetit për turizëm kulturor me komunat përreth - Ngritja e kapaciteteve njerëzore për trashëgimin kulturore	- Gjendja e rëndë ekonomike - Ndërtimet e egra në zonat e vecanta dhe zhvillimet e pakontrolluara - Mos respektimi i ligjeve për mbrojtje të

- Përkushtimi i qeverise lokale për ruajtje të trashëgimis kulturore - Muaji dhjetor “Festivali i rakise dhe verës” - Zhvillimi i agroturizmit - Adoptimi i shtëpive për bujtina dhe zhvillimi i turizmit fshatar.	- trashëgimis kulturore - Zhdukja graduale e monumenteve nga mungesa e perkujdesjes institucionale - Fatkeqësit natyrore. -
---	--

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA

- Mbrojtja e trashëgimisë natyrore
- Mbrojtja e trashëgimisë kulturore
- Promovimi i vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

NEVOJAT ZHVILLIMORE

- Ngritja e vetëdijes dhe arsimimi për trashëgimin kulturore
- Subvencionet e grupeve që ushtrojnë veprimtari tradicionale
- Promovimi dhe forcimi i brendit të Rahovecit në Kosovë dhe rajon
- Integrimi i zonës së vecant të mbrojtur të Hoqës së Madhe, në zhvillimin e turizmit.

16.10 VENDBANIMET

SWOT Analiza

PERPARËSIT

- Lidhja e mirë e vendbanimeve me qendrën komunale
- Shpërndarje relativisht e mirë e shërbimeve shkollore dhe shëndetësore
- Ekzistimi i vendbanimeve me pozitë të përshtatshme për organizim të subqendrës

DOBËSITË

- Dendësia e ulët e ndërtimit
- Përqendrimi i shërbimeve administrative në qendrën komunale
- Niveli i pamjaftueshëm i shtrirjes së infrastrukturës teknike në zonat rurale (ujësjellës, kanalizim)
- Zgjerimi i ndërtimit në tokë bujqësore

MUNDËSITË

- Hartimi i planeve hapësinore
- Krijimi i subqendrave të zhvillimit të vendbanimeve në raport me qendrën e Rahovecit.

RREZIQET

- Vazhdimi i trendit të zgjerimit të vendbanimeve pa kritere
- Humbja e tokës bujqësore
- Kapacitetet e pashfrytëzuara sipasojë e migrimit rural-urban

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA

- Ndalimi i zhvillimeve të pakontrolluara hapësinore
- Ofrimi i kushteve më të mira të planifikuara brenda zonave të ndërtuara
- Zhvillimi i vendbanimeve me dendësi adekuate

- Menaxhimi i migrimit rural-urban

NEVOJAT ZHVILLIMORE

- Përforcimi i mëtejshëm i karakterit shumëfunksional të qendrës komunale
- Konsolidimi i strukturës së ndërtuar të vendbanimeve tjera brenda zonave aktuale të ndërtuara, duke e ruajtur karakterin e tyre lokal
- Ofrimi i shërbimeve adekuate sociale dhe publike në të gjitha vendbanimet rurale

16.11 BANIMI

SWOT Analiza

PERPARËSIT	DOBËSITË
- Njësi relativisht të reja të banimit - Numër i konsiderueshëm i njësive të banimit - Pjesa dërmuese e njësive të banimit në pronësi private	- Mungesa e politikave të banimit, - Mungesa e banimit të përballueshëm financiarisht - Ndërtimet pa leje - Shërbimet në distancë të madhe si pasojë e vendbanimeve të shpërndara - Niveli i pamjaftueshëm i qasjes në infrastrukturë teknike (ujësjellës, kanalizim)
MUNDËSITË	RREZIQET
- Hartimi i politikave të banimit - Zhvillimi i banimit me dendësi adekuate - Përmirësimi i cilësisë së banimit përmes masave adekuate mjedisore	- Cënimi i cilësisë së banimit jashtë konditave të planifikimit - Rrezikimi i qasjes adekuate në infrastrukturën teknike funksionale

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA

- Sigurimi i banimit financiarisht të përballueshëm
- Ndalimi i zhvillimeve të pakontrolluara/paligjshme të banimit
- Përmirësimi i kushteve të banimit dhe ofrimi i shërbimeve adekuate
- Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera

NEVOJAT ZHVILLIMORE

- Vlerësimi i kapaciteteve ekzistuese të banimit dhe nevojave për banim
- Sigurimi i banimit adekuat për kategoritë në nevojë, të përcjellë edhe me masa konkrete për integrim social dhe aftësim për punë
- Monitorimi dhe menaxhimi i vazhdueshëm i zhvillimit hapësinor të banimit
- Ofrimi i shërbimeve adekuate publike dhe sociale që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të banimit

17 VIZIONI PËR TË ARDHMEN E KOMUNËS, QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

Plani Hapësinor i Kosovës (PHK) është dokument i cili jep orientimet dhe përcakton shtrirjen hapësinore të zhvillimeve në të ardhmen (deri në vitin 2020) në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. PHK shërben edhe si udhëzues në hartimin e planeve zhvillimore komunale.

Me qëllim të paraqitjes së kaheve të zhvillimeve hapësinore, duke marrë parasysh edhe karakteristikat gjeografike, natyrore, veprimtaritë socio- ekonomike etj, PHK identifikon katër zona të cilave u janë dhënë ngjyrat dhe emrat në bazë të tipareve karakteristike të zonës.

- Thesari i Kosovës „Zona e gjelbër” zonë industriale, shërbyese tregtare, agroindustriale me qendër kryesore Mitrovicën.
- Porti i Kosovës „Zona e kaltërt ” zonë administrative, arsimore, shërbyese, tregtare, agroindustriale, turistike me qendër kryesore Prishtinën
- Kopshtet e Kosovës „Zona e portokalltë” zonë kulturo-turistike, agro-industriale dhe shërbyese tregtare. Qendrat kryesore: i, Peja.
- Urat e Kosovës, „Zonat e verdha”


Karakteristikat për zonën e verdhë

Kjo hapësirë zë pjesën jugperëndimore të Kosovës dhe përbëhet nga komunat: Deçani, Rahoveci, Malisheva dhe Gjakovën si qendër më e madhe komunale. Kjo zonë shtrihet në pjesën e mesme të rrafshit të Dukagjinit të rrethuar me male, lartësi mbidetare prej 365m – 2656m, klimë të mesme kontinentale me ndikim të dobësuar të klimës mesdhetare, kohëzgjatje të vegjetacionit 200-250 ditë, rrjetë të pasur hidrografik, trashëgimi natyrore dhe kulturore, tokë bujqësore të kualitetit të lartë, kullosa, livadhe, traditë në kultivim të pemëve e vreshtave, bletarisë e shpezëtarisë, e dalluar për kultivimin e zejeve tradicionale.

Rahoveci si komunë i takon zonës së verdhë.

Vizioni për Zonën e Verdhë:

Urë e zhvillimit të lidhjeve të Kosovës me rajonin, rrjet funksional i qyteteve të fuqishme dhe fshatrave dinamike, atraktive për të jetuar dhe punuar në to. Duke shfrytëzuar kapacitetet e infrastrukturës, pozitën gjeografike dhe pasuritë e shumta natyrore, kulturore dhe humane, të zhvillohet në një hapësirë të qëndrueshme ekonomike agroindustriale, tregtare, shërbyese dhe turistike.



Strategjia e zhvillimit hapësinor – Hapësira e verdhë

Qëllimet e përgjithshme për zonën e verdhë:

- Zhvillimi i rrjetit të vendbanimeve, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, me rritje të kualitetit të jetesës së qytetarëve, punësimit, barazisë sociale.
- Mbështetje ZHEL për ZHEK – shfrytëzimi i përparësive konkurruese,
- Zhvillimi i lidhjeve efikase brendaurbane, ndërurbane me 6 hapësirat e tjera dhe më gjërë në rajon përmes rrjetit të zhvilluar të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, ajrore dhe TIK).
- Përkrahja e zhvillimeve për arsim bashkëkohor e përkrahës të kërkesave të tregut
- Ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore, turizmit kulturor e rekreativ,
- Zhvillim të lidhjeve tregtare e shërbyese ndërkufitare me Shqipërinë,
- Aeroporti civil i Gjakovës si mundësi për zhvillim ekonomik
- Zhvillimi i shërbimeve tregtare, agroindustriale dhe turistike, me intensifikim të politikave për mbrojtje dhe rimëkëmbje të mjedisit.

Përparësitë, mangësitë dhe mundësitë e zhvillimit të ardhshëm të hapësirës së verdhë

Përparësitë dhe mundësitë	Mangësitë
• Burimet njerëzore, moshë e re e popullsisë (55% nën 26 vjet)	• Nivel i ulët i decentralizimit fiskal komunal,
• Vetëdije kolektive e lartë,	• Mungesa e vetiniciativës,
• Përvoja në udhëheqje,	• Vonesa e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore nga AKM,

• Pozita e mirë gjeografike, zonë kufitare,	• Migrimi i popullatës – posaçërisht të moshës së re,
• Shndërrimi dhe shfrytëzimi i aeroportit ushtarak të Gjakovës në atë civil,	• Ndërmarrjet e mëdha industriale në pronësi shoqërore jo aktive
• Tradita në kultivimin e zejeve tradicionale	• Degradim i konsiderueshëm i resurseve natyrore (shfrytëzimi i rërës dhe prerja e pyjeve),
• Përvoja në industri	• Mungesa e kooperimit socio-kulturor
• Sektori joqeveritar dhe diasporë e fortë dhe përkrahëse e zhvillimeve,	
• Sipërfaqet e punueshme dhe nën ujë,	
• Resurset natyrore dhe kulturore për zhvillimin e turizmit,	
• Zhvillimi i tregtisë, shërbimeve,	
• Zhvillimi i eko-bujqësisë,	
• Kooperimi me qytete tjera brenda dhe jashtë Kosovës,	
• Hapja e shkollave profesionale,	
• Shfrytëzimi i TIK në shërbime,	
• Zhvillimi i sektorit të shëndetësisë	

Konfliktet dhe sinergjitë në skenarin e zhvillimit të Hapësirës së Verdhë:

Konfliktet:

- Shtrirja e vendbanimeve me tokën bujqësore,
- Zhvillimi i industrisë ndërtimore me degradimin e lumenjve dhe pyjeve,
- Zhvillimi i zonës së aeroportit me tokën bujqësore,

Sinergjitë:

- Zhvillimi i turizmit kulturor, rekreativ, tradicional fshatar me ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë natyrore e kulturore,

Zonat hapësinore me interes të veçantë për Kosovën

- Aeroporti i Gjakovës,
- Kanjoni i Drinit të Bardhë me Urën e Fshejtë,
- Parku rajonal i Mirushës,
- Miniera e kromit në Devë,
- Liqeni akumulues - Radoniqi
- Manastiri i Deçanit,
- Çarshia e Madhe - Gjakovë,
- Kullat e Dukagjinit,
- Kalimet kufitare (Prush e Morinë).

17.1 Vizioni

Vizioni për zhvillimin e ardhshëm të komunës së Rahovecit shprehë qëllimet afatgjata të synuara për tu arritur, të përcaktuara përmes procesit pjesëmarrës të palëve të interesit dhe analizave shumë-sektoriale, duke u nisur nga gjendja aktuale, sfidat e identifikuara, nevojat për zhvillim, si dhe potencialet lokale.

Gjatë përshkrimit dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese – profilit komunal, janë grumbulluar dhe analizuar të dhëna të shumta për fusha të ndryshme. Në bazë të këtij vlerësimi janë identifikuar edhe sfidat kryesore të komunës.

Faza e dytë e planit parasheh zgjidhjen e problemeve dhe konflikteve hapësinore me të cilat përballet komuna e Rahovecit.

Vizioni, parimet dhe caqet, përfshijnë parashikimet e favorshme të zhvillimeve të ardhme në fusha të ndryshme si:

- Ekonomike
- Infrastruktura teknike
- Infrastruktura e transportit
- infrastruktura publike dhe sociale
- Mjedisit dhe sipërfaqet me rrezikshmëri
- Asetet e trashëgimisë natyrore
- Vendbanimet
- Banimi
- Vendbanimet joformale
- Shfrytëzimi i tokës

Komponentat këto sipas udhëzimit administrative për PZHK dhe programit të hartimit të PZHK të komunes së Rahovecit

Përmes kësaj deklarate prezantohet zhvillimi i ardhshëm i komunës në formë të përmbledhur si në vijim:

Rahoveci komune lidere në mbrojtje të trashëgimisë kulturore e natyrore si dhe zhvillim të hovshëm në bujqësi, ndërmarrësi dhe arsim,.

Përmes këtij vizioni, njëkohësisht ofrohen zgjidhje për sfidat e identifikuar në fazën e parë.

Vizioni për Komunën e Rahovecit parasheh zhvillime konkrete dhe të realizueshme si:

- Zhvillim të hovshëm në gjithë sektorët e bujqësisë
- Avancim të administratës publike
- Rënie të vazhdueshme në shkallën e papunësisë dhe varfërisë
- Ngritje të nivelit në arsim dhe shëndetësi
- Zhvillim të vendbanimeve dhe ndertime me plan
- Mbrojtjen e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore
- Ekonomi të zhvilluar
- Infrastruktura e planifikuar bashkëkohore

17.2 Qëllimet dhe objektivat zhvillimore

Përcaktimi i qëllimeve për fusha përkatëse paraqet hapin e mëtejshëm dhe më specifik drejt arritjes së vizionit, gjithmonë duke i pasur parasysh çështjet e identifikuar, nevojat dhe kërkesat, si dhe potencialet mundshme në dispozicion.

Për secilin qëllim janë përcaktuar edhe objektivat përkatëse, si elemente më specifike, të matshme dhe të arritshme, në mënyrë që të jepet një kornizë më konkrete për zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal të Rahovecit.

QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi 1 –Përmirësimi i mirëqenies sociale

Objektivat

- Zhvillimi i aftësive për punësim, me fokusim te femrat dhe të rinjtë
- Zhvillimi i programeve për punësim,
- Sigurimi i punës sezonale
- Zhvillimi i skemave të përkrahjes financiare dhe sociale për kategoritë në nevojë,
- Përkrahje të bizneseve të vogla dhe të mesme

Qëllimi 2 – Përmirësimi i nivelit të shërbimeve shëndetësore

Objektivat

- Përmirësimi i infrastrukturës fizike në shërbimet shëndetësore
- Përmirësimi i infrastrukturës teknike në objektet shëndetësore
- Krijimi i kushteve për edukim të vazhduar të personelit profesional në shëndetësi

Qëllimi 3 – Përmirësimi i nivelit të arsimit

Objektivat

- Investime në përmirësimin e kushteve infrastrukturore të shkollave në funksion të rritjes së cilësisë në arsim dhe ndërtimin e shkollave të reja.
- Nga shtatori I viti 2018-2019 do të bëhet funksionalizimi i plotë dhe i përhershëm i organeve drejtuese të shkollave dhe këshillave drejtues të shkollave.
- Ofrimi I shërbimeve profesionale pedagogjike dhe psikologjike, dhe trajnimeve profesionale të mësimeve të mësimdhënësve.
- Sigurimi i edukimit parashkollor , sipas nevojave të identifikuara
- Sigurimi i qasjes në arsim për të gjitha moshat shkollore
- Kompletimi i infrastrukturës shkollore , sipas nevojave të indetifikuara

Qëllimi 4 – Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të ndërtesave të kulturës

Objektivat

- Funksionalizimi i ndërtesave ekzistuese të kulturës
- Shfrytëzimi kontinual i ndërtesave të kulturës
- Shfrytëzimi i infrastrukturës ekzistuese në zonat rurale për zhvillimin e ngjarjeve kulturore – shkollat, hapësirat publike

Qëllimi 5 – Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës për sport dhe rekreacion

Objektivat

- Funksionalizimi i objekteve ekzistuese sportive
- Shfrytëzimi kontinual i objekteve sportive

Qëllimi 6 – Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të hapësirave publike

Objektivat

- Përmirësimi i hapësirave ekzistuese publike
- Krijimi i hapësirave të reja publike
- Mirmbajtja e hapësirave publike

Qëllimi 7 – Ofrimi i banimit të qëndrueshëm

Objektivat

- Ofrimi zgjidhjeve të qëndrueshme të banimit për familjet në nevojë

Qëllimi 8 – Rritja e densitetit në qendrën komunale

Objektivat

- Konsolidimi i lagjeve të qendrës komunale
- Konsolidimi i qendrës dhe përmbajtjeve shumëfunksionale

Qëllimi 9 – Zhvillimi i vendbanimeve në mënyrë kompakte

Objektivat

- Konsolidimi i lagjeve të vendbanimeve duke e ruajtur karakterin
- Lidhje funksionale me qendrën urbane
- Formimi i qendrave të reja sekondare
- Zgjidhje për ndërtimet ilegale dhe vendbanimeve joformale

Qëllimi 10 - Zhvillimi i bujqësisë, blegtorisë, vreshtarise dhe kapaciteteve përpunuese

Objektivat

- Konsolidimi dhe rritja e kapaciteteve bujqësore
- Zhvillimi i bujqësisë dhe prodhimeve bujqësore
- Stimulimi i pemëtarisë
- Zhvillimi i prodhimtarisë vreshtare dhe plasim i sigurtë në tregun Evropian dhe më gjërë

Qëllimi 11 – Zhvillimi i kapaciteteve turistike

Objektivat

- Shfrytëzimi i qëndrueshëm i potencialeve natyrore dhe kulturore
- Zhvillimi i turizmit rural,
- Zhvillimi i kapaciteteve shërbyese dhe hoteliere,
- Zhvillimi i turizmit bazuar në resurse të trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore,

Qëllimi 12 – Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe industrisë së lehtë

Objektivat

- Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme sipas kërkesave në tregun vendor dhe regional
- Bashkëpunimi ndër-sektorial në nivel komunal dhe ndër-komunal

Qëllimi 13 – Zhvillimi i transportit dhe infrastrukturës së mobilitetit

Objektivat

- Përmirësimi i qarkullimit në qendrën komunale
- Kompletimi i rrjetit të rrjetit rrugor në zonat rurale
- Rrugë të asfaltuara të kualitetit të lartë dhe qasje për të gjithë banorët
- Rritja e shfrytëzimit të transportit publik
- Sigurimi i kushteve për qarkullim jo-motorik
- Përmirësimi i sigurisë së qarkullimit

Qëllimi 14 - Menaxhimi adekuat me ujëra

Objektivat

- Sigurimi i burimeve të mjaftueshme të ujit për nevojat e banimit dhe të zhvillimit
- Ofrimi i sistemeve funksionale të ujësjellësit për të gjitha vendbanimet
- Ofrimi i sistemeve funksionale të kanalizimit për të gjitha vendbanimet
- Trajtimi i ujërave të zeza
- Zhvillimi i sistemit për menaxhimin e ujërave atmosferik

Qëllimi 15 – Menaxhim adekuat i mbeturinave

Objektivat

- Parandalimi dhe largimi i mbeturinave në trupat ujor dhe mjedise tjera si deponi ilegale
- Mbulimi i të gjitha vendbanimeve me shërbimin e mbledhjes së mbeturinave

Qëllimi 16 – Mbrojtja e mjedisit

Objektivat

- Parandalimi i shkarkimit të ujërave të zeza dhe industriale në Lumenj si dhe ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave të zeza
- Reduktimi i ndotjes së ajrit
- Mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i tokës bujqësore
- Mbrojtja e pyjeve dhe ripyllëzimi
- Rregullimi i shtretërve të lumenjve për parandalimin e vërshimeve
- Shfrytëzimi racional i zhavorrit dhe gurthyesve për një zhvillim të qëndrueshëm
- Zvogëlimi i impakteve negative nga kafshë

Qëllimi 17 – Mbrojtja nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësit tjera

Objektivat

- Mbrojtja nga zjarret
- Reduktimi i zonave të rrezikuara nga vërshimet

Qëllimi 18 – Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore, natyrore

Objektivat

- Mbrojtja e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe peizazhit
- Mbrojtja e vlerave të trashëgimisë kulturore
- Promovimi i vlerave të trashëgimisë lokale

PRIORITETET STRATEGJIKE

- ❖ Avancim të administratës publike
- ❖ Krijimi i parqeve të reja dhe hapësirave për parking
- ❖ Zhvillimi i bujqësisë
- ❖ Zhvillimi i prodhimtarisë vreshtare dhe plasim i sigurtë në tregun Evropian dhe më gjërë
- ❖ Mbrojtje e mjedisit dhe shfrytëzim racional
- ❖ Planifikimi i me shum se nje kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza
- ❖ Infrastruktura e planifikuar bashkëkohore si në zonën urbane ashtu edhe ne zonat rurale.
- ❖ Zhvillim të vendbanimeve , trajtim të vendbanimeve joformale si dhe ndertimeve me plan
- ❖ Ngritje të nivelit në arsim dhe shëndetësi,
- ❖ Rënie të vazhdueshme në shkallën e papunësisë dhe varfërisë
- ❖ Zhvillimi i turizmit bazuar në resurse të trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore

18 KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR TË KOMUNËS

Duke u bazuar ne ligjin për *Planifikimit Hapesinor (ligji nr. 04/l-174)* si dhe me konkretisht *Udhëzim Administrativ MMPH nr. 11.2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin zbatimin dhe monitorimin e planit zhvillimor komunal*, faza e trete e planit permbane kornizen e zhvillimit hapesinor.

Ne kete faze te planit shprehen parashikimet zhvillimore per territorin e komunes se Rahovecit. Ndersa, njekohesisht percaktohet edhe koncepti hapesinor i strategjive per implementim, planet e veprimit dhe te vendimmarrjes.

Korniza e zhvillimit hapesinor ne Komunen e Rahovecit permban:

-Strukturen dhe lokacionin hapesinor per zhvillimin dhe organizimin e ardhshem, ku do te adresohen ceshtjet si:

- Zhvillimi ekonomik, turizmin, rekreacionin, tregtine dhe veprimtarite tjera ekonomike.
- Infrastrukturen – transportin komunal, komunikimet.
- Popullsine, banimin, vendbanimet, ceshtjet sociale, trashegimia.
- Mjedisin, trashegimine natyrore dhe resurset, peizazhet etj.
- Zonat urbane ekzistuese dhe te propozuara per te ardhmen dhe zonave tjera jashte zones urbane.
- Projektet strategjike ose zonave te vecanta te cilat vec jane aprovuar ne Planin Hapesinor te Kosoves.
- Vleresimi i ndikimit socio-ekonomik dhe mjedisor i kornizes se propozuar.

18.1 Konceptet kryesore të zhvillimit hapësinor

Ne Komunen e Rahovecit, ne baze te kushteve fiziko-geografike, dallohen dy teresi kryesore hapesinore qe dallohen per kah morfologjia e terrenit dhe faktoret tjere natyror, ndersa ne baze te ketyre faktorve kushtezohet edhe niveli zhvillimor ne hapesire. Pra, dallohet hapesira e rrafshet me toke bujqesore te cilesise se larte dhe hapesira kodrinoremalore me pyje e kullosa.

Hapesira kodrinore-malore, ne anen veriore te komunes, paraqet ambient te

pershtatshem per pushim dhe rekreacion si dhe aktivitete tjera me karakter ekonomik, si blegtori, etj.

Hapesira veriore e komunes dallohet me karakteristika tjera natyrore dhe te aktiviteve, dendesi te vogel banimi, rrjet te dobet te infrastruktures lokale si dhe ambient te qete dhe te paster. Mbrojtja, zhvillimi dhe shfrytezimi i resurseve natyrore dhe potencialeve te kesaj zone mundeson hapjen e perspektives per zhvillimin e komunes, me theks te vecante ne turizem.

Zona Fushore , pjesa jugor e komunes ofron mundesi te mira per sektorin e agrikultures, zhvillimin e bizneseve, vendbanimeve dhe infrastruktures moderne. Vlerat e kesaj teresie hapasinore i' a shton lumi Drini me disa dege te tija qe kalon ne anen jugore.

Zona fushore paraqet perspektive te mire per zhvillimin e aktiviteve te ndryshme ekonomike, ku dominon agrobiznesi si dhe aktivitetet e tjera tregtare, industriale dhe sherbyese.

Kjo zone, karakterizohet me zhvillim te gjithmbarshem te llojit te perzier, me perqendrim te madh te popullsisë, aktivitete tregtare-industriale te cilat qendrojnë ngushte te lidhura edhe me zhvillimin e komunikacionit e transportit, si dhe zhvillimit te pergjithshem te bujqesise, por njekohesisht edhe me ndikime te theksuara mjedisore.

Qyteti i Rahovecit ofron mundesi per zhvillimin e bizneseve te vogla dhe te mesme. Ndersa ne zonat rurale propozohet ofrim i sherbimeve dhe infrastruktures me qellim te permiresimit te kushteve dhe cilesise se jetes. Kjo do te reflektohet ne ngritjen e standardit jetesor te popullsisë dhe hapjen e mundesive te reja per zhvillim ne fshat.

Ne kete rast, rendesi te vecante ka percaktimi i pikave me te pershtatshme dhe te favorshme per ofrimin e sherbimeve, ndersa kjo do te reflektohet ne koncentrimin e popullsisë e jo ne dezintegrim te saj. Me formimin e disa qendrave sekondare dhe lokale do te zvogeloheshin distancat mes banimit dhe sherbimeve.

18.2 Skenarët e zhvillimit hapësinor


Ne baze te analizes se gjendjes ekzistuese – profilit, ofrohen edhe skenaret e mundshem te zhvillimit hapësinor, sipas kriterëve dhe standardeve te planifikimit, (sociale, ekonomike, koncentrimit, fuqise gravituese te qendrave, pozites, infrastruktures, produktivitetit te tokave etj) qe do te vleresohen si alternative e zhvillimit dhe organizimit te ardhshem te komunes,

18.2.1 Skenari i zhvillimit monocentrik

Me këtë skenar , qendra urbane zhvillohet si e vecant, gjithnje e me teper ne raport me rrethinën, ndersa vendbanimet rurale edhe me tej ngecin ne zhvillimin ekonomik dhe social. Veprimtarite ekonomike koncentrohen kryesisht ne qytet dhe ne disa vendbanime tjera me te medha, ndersa Zona urbane dhe vendbanimet tjera shtrihen kryesisht pergjate korridoreve te rendesishme rrugore.

Tokat bujqesore te cilesise se larte vazhdimisht mbulohen dhe humbin nga ndertimet e pakontrolluara.

Zonat rurale vazhdon ti percjell edhe me tej ne niveli i ulet i zhvillimit ekonomik dhe me infrastrukture te zhvilluar te dobet. Niveli i sherbimeve mbetet i ulet per shkak te lidhjeve te dobeta me qendren kryesore. Qendrat lokale mbesin te dezintegruara ne sistemin urban. Vendbanimet rurale stagnojnë dukshem ne te gjitha aspektet e zhvillimit.



Përparësitë:

- Bizneset do të zhvillohen në mënyre spontane.

Dobësitë:


- Centralizimi i institucioneve,
- Lidhje e dobët e vendbanimeve rurale me zonen urbane,
- Qasja e dobët e fshatrave në infrastrukturen sociale,
- Fluksi i shtuar i migrimit të popullsisë nga zonat rurale drejt qytetit,
- Zhvillim i pakontrolluar i vendbanimeve në tokat bujqesore,
- Zhvillim i pakontrolluar i ndertimeve në zonen urbane,
- Veshtërsi në percjelljen e trendeve të urbanizimit në zonen urbane nga zgjerimi i pakontrolluar,
- Humbje e kontaktit dhe lidhjeve me peizazhet e bukura malore,
- Humbje e mbështetjes së shfrytëzimit të pasurive natyrore në viset malore.

Konkluzion: Bazuar në trendet bashkohore të zhvillimeve dhe vlerësimin e perparësive dhe dobësive, ky skenar nuk është i favorshëm për tu aplikuar.

18.2.2 Skenari i zhvillimit linear

Koncepti linear i zhvillimit në këtë rast percjell kryesisht linjat ose korridoret rrugore, por edhe të disa rrugëve të rëndësishme lokale që lidhin vendbanimet mes veti.

Zhvillimet pergjate rrugëve marrin karakter linear me te theksuar, por kane edhe nje lloj kombinimi linear – koncentrik, duke mos lene anash edhe zhvillimet lineare pergjate rrjetit brenda vendbanimeve. Kjo forme e zhvillimit linear ka te beje me shtrirjen gjate sore te vendbanimeve, aktivitetete ekonomike-sherbyese, perqendrimin te popullsisë etj.



Përparësitë:

- Qasje e mire ne infrastrukture rrugore,
- Zhvillimi i zonave rurale pergjate korridoreve.

Dobësitë:

- Disa zona te komunes mbeten te pazhvilluara, jasht shtrirjes lineare,
- Zhvillimi i dobët i qendres urbane,
- Zhvillimi i vendbanimeve pergjate rruges,
- Zënia e tokës bujqësore,
- Shpenzime te larta per kycje ne infrastrukture,
- Rritje e distancave ndaj sherbimeve,
- Rrezikim i banoreve nga zhvillimi komunikacionit,

Konkluzion: Ky skenar nuk eshte i favorshem per tu aplikuar dhe nuk eshte i pe rshtatshem sepse krijon shume probleme duke rritur shkallen e investimeve, rrezikon sigurine e banoreve, ndikon drejtperdrejt ne keqesimin e mjedisit jetesore te banoreve, rrite koston e transportit, etj.

18.2.3 Skenari policentrik

Skenari I trete, ai policentrik ofron mundesi me te mira dhe me bashkekohore per zhvillim te me tejme te komunes. Koncepti i zhvillimit te ardhshem i komunes eshte koncepti i qendrueshem. Ky koncept per qellim kryesore ka zhvillimin e tere hapesires komunale, bazuar ne shfrytezimin racional te te gjitha mundesive dhe resurseve lokale, si dhe ne ruajtjen e vlerave mjedisore per gjenerata te ardhshme.

Zhvillimi policentrik ka per qellim shperndarjen e aktiviteteve brenda vendbanimit ose disa vendbanimeve, ndertimin, rehabilitimin dhe pajisjen me infrastrukture te nevojshme, qasje ne transport, qasje te mire ne sherbime sociale dhe krijimin e kushteve te favorshme per pune dhe rekreacion ne te gjitha vendbanimet.

Gjithashtu ka per qellim qe stagenimi i zhvillimeve ne vendbanimet malore te nderpritet permes ofrimit te infrastruktures elementare dhe shfrytezimit te resurseve lokale per zhvillim te metutjeshem.


Zhvillimi i qendrueshem eshte model i shfrytezimi te resurseve qe ka te beje jo vetem me plotesimin e nevojave te tanishme por edhe per gjeneratat e ardhshme. Me fjale te tjera, zhvillimi i qendrueshem tenton ti kenaq nevojat apo kerkesat e tanishme, duke mos rrezikuar mundesite dhe perspektiven e gjeneratave qe vijne.

Permes ketij koncepti do te realizohen zhvillime te deshiruara ne fushat, si:

- Administrate efikase dhe te decentralizuar
- Infrastrukture adekuate me qasje te mire
- Ekonomi te zhvilluar dhe te balancuar
- Mbrojtje efikase e tokes bujqesore dhe zhvillim i bujqesise ne zonat malore
- Vendbanime kompakte dhe funksionale
- Mjedis te paster dhe atraktiv

Efektet konkrete te ketij skenari jane:

- Zhvillim i balancuar ne mes qytetit dhe zonave rurale te komunes
- Qendrat sekondare; Operushë, Krushe e Madhe, Xerxe, Ratkoc, Drenoc dhe Cifllak zhvillohen vazhdimisht,
- Ato duhet te sigurojne toke te mjaftueshme per banim, industri te lehte dhe tregti,
- Ne vendbanimet me funksione qendrore duhet te vendosen sherbimet kryesore publike: administrata publike, shkollat dhe qendrat shendetesore,
- Qendrat duhet te ofrojne sherbime dhe produkte te nevojshme per perdorim afatshkurter dhe afatmesem,
- Qendrat sekondare do te jene nyje te rrjetit te infrastruktures rrugore lokale.
- Qendrat sekondare dhe lokale u ofrojne te gjitha vendbanimeve tjera sherbime institucionale, infrastrukture teknike dhe sociale,
- Zonat rurale fitojne perspektiva zhvillimore ne baze te qendrave sekondare dhe resurseve natyrore qe disponojne,
- Fluksi i largimit te banoreve nga fshatrat do te zvogelohet ose edhe nderpritet,
- Zonat e rrafsheta zhvillojne bujqesine moderne, ndersa ne viset kodrinoremalore zhvillohet blegtoia dhe turizmi,



Përparësitë:

- Avancim dhe zhvillim i qendrave sekondare,
- Zhvillim ekonomik i zonave rurale,
- Zvogelim i distancave brenda vendbanimeve,
- Lidhje e mire e vendbanimeve me qendrën urbane,
- Shperndarje e volitshme e institucioneve dhe e infrastruktures teknike dhe sociale,
- Koncentrim i burimeve permes qendrave sekondare
- Zhvillim kompakt dhe dendesim i ndertimeve,
- Ruajtja e tokes bujqesore,

Dobësitë:

- Zonat urbane dhe qendrat sekondare ndiejne nevojë për plane rregulluese,
- Ngadalesim i zhvillimit të qytetit nga se vjen në shprehje ndarja e mjeteve në menyre të barabarte.

Konkluzion: Në bazë të vlerësimeve dhe nevojave për zhvillim të komunes, rezultoi se ky skenar konsiderohet i favorshëm për zhvillim të metejmë.

18.3 Skenari i përcatuar për zhvillimit hapësinor

Skenari i Zhvillimit Hapësinor për Komunën e Rahovecit, i bazuar në Planin Hapësinor të Kosovës, (Korniza e Zhvillimit Hapësinor), Vizionin për të ardhmen e Rahovecit, parasheh si zonë të zhvilluar bujqësore, me theks të veçantë në Vreshtari dhe perimtari që merr rolin udhëheqës në industrinë përpunuese të Vererave dhe Perimeve duke respektuar standardet për mjedis, zhvillim të agrobiznesit, tregtisë e industrisë shërbyese, rritjen e kualitetit të jetës, punësimit dhe barazisë sociale, përmes qeverive lokale aktive, transparente dhe efikase.

Me qëllim të arritjes së një zhvillimi gjithëpërfshirës të Rahovecit si dhe zhvillimit të konceptet të mundshme - zhvillimi monocentrik, zhvillimin linear si dhe zhvillimi policentrik, qatë shqyrtimit dhe krahasimit të këtyre opsioneve është bërë edhe shkrimi i elementeve pozitive të secilës në një koncept të vetëm që parasheh një zhvillim të qëndrueshëm të Rahovecit, i cili i përfshinë dimensionet ekonomike, sociale dhe hapësinore.

Rrjeti i vendbanimeve dhe hierarkia brenda tij në Qender Urbane si dhe në 6 Sub-Qendra, që do të jenë bartës të zhvillimit, në varësi të potencialeve dhe rolit që e merr secili vendbanim në zhvillim ekonomik, social dhe ofrim të shërbimeve.



Ndërlidhja e Qendres Urbane me Sub-qendrat krijon koridore potenciale të zhvillimit të bizneseve përgjat akseve të rrugëve regjionale si: Rahovec – Xërxë – Gjakovë (R 110); Rahovec – Krush e Madhe (R 204), si dhe lidhja rrugore e Sub-qendrave: Krush e Madhe – Xërxë – Ratkoc – Çifllak (R 111).

Rahoveci si qendër komunale, si zonë urbane bashkë me vendbanimin e afert Bernjakë, do të ofrojnë shërbime sociale dhe publike të nivelit komunal, ndërsa do të mbështesë edhe zhvillimin ekonomik komunal.

Duke e pasur parasysh dendësinë e ulët të banimit në zonën Qender, zhvillimin hapësinor të saj do të jetë e nevojshme që të bëhet konsolidimi i pjesëve periferike dhe kompaktësimi i pjesëve qendrore, drejt zhvillimit të -mëtejme të karakterit urban.

Ndërkaq Sub-Qendrat së bashku me fshatrat në menyren e planifikuar të organizimit, përbëjnë rrjetin bartës të zhvillimit rural. Me qëllim të ofrimit të zhvillimit të qëndrueshëm, fshatrat do të jenë të mbështetura me shërbime të kompletuara publike e sociale, si dhe infrastrukturë adekuate të forcimit dhe zhvillimit të mëtejme në sektorin e bujqësisë, e në vecanti në Vreshtari dhe Perimtari e Pemtari.

Në aspekt të zhvillimit hapësinor parashihet konsolidimi i strukturave të ndërtuara, deri në pikën ku karakteri i fshatit nuk ndryshohet dukshëm. Zgjerimet e mëtejme në toka bujqësore do të kontrollohet deri në atë masë që lejon kushtet dhe trendet zhvillimore, apo edhe riorientimi në kahje të kundërt kufirit ndërtimor me sipërfaqet bujqësore.



DRAFT